Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

DORACAK

I NËPUNËSVE ADMINISTRATIVË LIDHUR ME ZBATIMIN E LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Shkup, 2020

Botuesi:
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së
www.azgj.gov.mk

Autorë:

Prof. dr. Xhevat Lloshi (gjuhëtar, mësimdhënës në Universitetin e Tiranës, në pension)

Prof. dr. Ajten Hajdari – Qamili (mësimdhënëse në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" – Shkup, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare)

Prof. dr. Izer Maksuti (mësimdhënës në Universitetin "Ukshin Hoti" - Prizren dhe në Universitetin e Tetovës, në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane.)

Prof. dr. Asllan Hamiti (mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" – Shkup, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare)

Prof. dr. Bashkim Selmani (mësimdhënës në Universitetin e Tetovës)

Prof. dr. Jusuf Zejneli (mësimdhënës në Universitetin e Tetovës)

Prof. dr. Zeqirija Ibrahimi (punonjës shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup)

Dr. Ismail Hamiti (udhëheqës i Sektorit të përkthimit në Kuvendin e RMV-së)

Mr. Xhemi Hajredini (publicist, ndihmësudhëheqës i Sektorit për veprimtari publike, në Komunën e Strugës)

PËRMBAJTJA

Parathënie

PJESA E PARË

Jusuf Zejneli

HARTIMI I LEGJISLACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Zeqirija Ibrahimi

PLANIFIKIMI GJUHËSOR NË MAQEDONINË E VERIUT

Izer Maksuti

POLITIKAT GJUHËSORE EUROPIANE

Xhevat Lloshi

LEKSIKU SHOQËROR E POLITIK

Xhemi Hajredini

KOMUNIKIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE ME QYTETARËT

PJESA E DYTË

Ajten Hajdari – Qamili / Asllan Hamiti / Bashkim Selmani / Ismail Hamiti

1. KOMUNIKIMI SHKRIMOR ADMINISTRATIV:
   1.1 Lutja
   1.2 Kërkesa
   1.3 Njoftimi
   1.4 Procesverbali
   1.5 Ftesa
   1.6 Kontrata
   1.7 Ankesa
2. ADMINISTRATORËT PUBLIKË
3. PËRDORIMI NË GJYKATË
   3.1. Vendosja dhe vendimet gjyqësore në procedurën (kontestuese)
4. DREJTIMI DHE MENAXHIMI

5. MENAXHIMI I ARKIVAVE PUBLIKE
6. FINANCAT PUBLIKE
7. STEMAT DHE SHENJAT IDENTIFIKUESE (LOGOT)
8. VULAT
9. TABELAT DHE MBISHKRIMET

PARATHËNIE

Paraprakisht e shoh të udhës që t'i them disa fjalë rreth këtij doracaku që e kemi në duar, i cili është përpiluar enkas për nevojat e nëpunësve administrativë lidhur me zbatimin praktik të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Qëllimi i vetëm është që ata t'i orientojë sa më mirë në thelbin e tij dhe njëkohësisht t'ua lehtësojë komunikimin në gjuhët zyrtare si një e drejtë themelore në jetën e përgjithshme institucionale. Duke u nisur nga kjo, mund të thuhet se çdo gjë që është përfshirë brenda tij, është mbështetur kryekëput në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, ku përcaktohet fare qartë se cilat janë gjuhët zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, cila është e drejta individuale e nëpunësve për të komunikuar me anë të tyre, cilat janë detyrimet që duhet t'i kryejnë ata etj.

E gjithë kjo, në radhë të parë është vendosur në një kontekst më të gjerë historik e politik, si një proces i gjatë me plot sfida e vështirësi, për të arritur deri në miratimin e ligjit të ri që e ngre gjuhën shqipe në rrafshin e përdorimit zyrtar. Kështu, jepet një pasqyrë e plotë lidhur me hartimin e legjislacionit, me planifikimin gjuhësor, me politikat gjuhësore europiane etj. Dhe në këtë kontekst si rrjedhojë e domosdoshme shfaqet edhe miratimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, me të cilin tejkalohen shumë mëdyshje e paragjykime dhe sigurisht hapet edhe rruga e komunikimit institucional në gjuhën amtare.

Ky doracak i udhëzon konkretisht dhe ua sqaron mirë nëpunësve administrativë, i orienton me shumë saktësi drejt së drejtës ligjore, krijon ndërgjegjësim për shfrytëzimin praktik të saj. Prandaj brenda tij janë dhënë të gjitha format e nevojshme që u nevojiten atyre në rrafshin e komunikimit administrativ: si shkruhet një lutje, një kërkesë, një njoftim, një procesverbal, një ftesë, një kontratë, një ankesë etj. Krahas këtyre, në mënyrë të veçantë janë dhënë sqarime edhe për përdorimin zyrtar të gjuhëve në gjykata, në udhëheqje, menaxhim, financa etj.

Duke marrë parasysh këtë përmbajtje kaq të gjerë, mund të themi se ky doracak do të shërbejë si një ndihmë shumë konkrete për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Uroj dhe shpresoj të bëhet doracaku kryesor në punën e përditshme të nëpunësve administrativë.

Prof. dr. Ylber SELA

Drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së

PJESA E PARË

Jusuf Zejneli

1. HARTIMI I LEGJISLACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Organizimi i pushtetit shtetëror dhe miratimi i ligjeve

Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet me sistem parlamentar të qeverisjes, sovraniteti i së cilës buron nga qytetarët, realizohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, në raste të caktuara, edhe përmes referendumit. Akti më i lartë juridik sipas të cilit organizohet dhe funksionon i tërë sistemi juridik-politik në vend, është kushtetuta, në harmoni me të cilën janë ligjet që rregullojnë raportet shoqërore në të gjitha sferat. Në kuadër të vlerave themelore të rendit kushtetues bëjnë pjesë edhe: ndarja e pushtetit shtetëror në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (kuvendi, qeveria, gjykatat), liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, qytetarit, sundimi i ligjit, pluralizmi politik, zgjedhjet e lira, mbrojtja juridike e pronësisë dhe vetëqeverisjes lokale. Kushtetuta përcakton se qytetarët janë të barabartë për nga liritë dhe të drejtat, pavarësisht nga përkatësia nacionale, sociale, gjinore, racore, e ngjyrës së lëkurës, e bindjes politike etj. Institucionet kryesore të sistemit juridik janë: kuvendi, qeveria dhe kryetari i shtetit.

Shtylla kryesore e demokracisë parlamentare është Kuvendi, andaj pikërisht veprimtaria e tij duhet të jetë gjithmonë baza, shtylla e palëkundur edhe e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, duke e bazuar këtë çështje si në procedurën e miratimit të ligjeve, ashtu edhe në zbatimin e tyre dhe në krijimin e kushteve përkatëse për zbatimin e plotë. Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës, ai është njëdhomësh. Kompetencat e tij realizohen sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, rregulloren dhe ligjin e tij. Çështje të veçanta për funksionimin e kuvendit rregullohen me Ligjin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Deputeti i përfaqëson qytetarët dhe në kuvend vendos sipas bindjes së vet. Deputetët zgjidhen me votim të fshehtë në zgjedhjet e përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira. Kryetari i kuvendit e përfaqëson atë, kujdeset për zbatimin e rregullores së punës, ushtron punë të tjera të përcaktuara me kushtetutë dhe me rregulloren e punës së kuvendit. Kryetari i shpall zgjedhjet për deputetë dhe për kryetarin e republikës. Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, ndërsa më së paku me një të tretën nga numri i përgjithshëm i deputetëve, nëse me kushtetutë nuk është parashikuar shumicë e veçantë. Seancat e kuvendit janë publike. Deputeti, krahas punës së rregullt në seancat e kuvendit dhe në trupat punuese, realizon edhe takime me qytetarët, organizatat joqeveritare, sindikatat, shoqatat e qytetarëve, organizatat ndërkombëtare, si dhe merret me aktivitete të tjera që varen nga kuvendi. Në ushtrimin e funksionit të deputetit, shërbimi i kuvendit i siguron ndihmë profesionale dhe administrative. Gjithashtu, organet e vetëqeverisjes lokale u sigurojnë ndihmë në ushtrimin e funksionit të tyre, u sigurojnë hapësirë dhe kushte pune për takime me qytetarët nga njësia e tij zgjedhore. Në kuadrin e realizimit të këtyre përcaktimeve, rol të veçantë ka edhe përdorimi i gjuhëve.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e miraton dhe ndryshon Kushtetutën, miraton ligje, realizon interpretimin autentik të ligjeve, miraton buxhetin e republikës, miraton planin hapësinor të saj, ratifikon marrëveshje ndërkombëtare, miraton vendime për aderim në aleanca ose bashkësi me shtete të tjera dhe dalje prej tyre, shpall referendum, vendos për rezervat e republikës, themelon këshilla, zgjedh Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, zgjedh gjykatës të Gjykatës Kushtetuese, bën zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin edhe të bartësve të tjerë të funksioneve publike e funksioneve të tjera të përcaktuara me kushtetutë dhe ligj. Ai, gjithashtu bën kontroll politik dhe mbikëqyrje mbi qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike, të cilët janë përgjegjës para kuvendit, gjithashtu ushtron punë të tjera të përcaktuara me kushtetutë. Për ushtrimin e punëve nga kompetenca e tij miraton edhe vendime, deklarata, rezoluta, rekomandime dhe konkluzione. Kuvendi, si bartës i pushtetit ligjvënës, ligjet i miraton në seancë; të drejtën për të propozuar miratimin e një ligji e ka çdo deputet, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe së paku 10.000 zgjedhës (propozues të autorizuar) dhe iniciativë për miratimin e ligjit, propozuesit të autorizuar mund t'i propozojë çdo qytetar, grup qytetarësh, institucione dhe shoqata. Në harmoni me rregulloren, procedura ligjvënëse zhvillohet me tri lexime: leximi i parë, leximi i dytë dhe leximi i tretë. Ligjet shpallen me dekret, të cilat i nënshkruan Presidenti i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit. Nëse Presidenti i Republikës vendos të mos e nënshkruajë dekretin për shpallje të ligjit, atëherë kuvendi përsëri e shqyrton ligjin në fazën e leximit të tretë, në afat prej 30 ditësh nga miratimi i ligjit dhe nëse e miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, Presidenti i Republikës është i detyruar që ta nënshkruajë dekretin. Presidenti është i detyruar ta nënshkruajë dekretin edhe për shpalljen e ligjeve që janë miratuar me dy të tretën e shumicës parlamentare. Para se të hyjnë në fuqi, ligjet botohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Ligjet botohen më së voni në afat prej shtatë ditësh nga miratimi i tyre.

Kompetencat e Kuvendit

Lidhur me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, kuvendi duhet të përqendrohet kryesisht në këto shtylla kryesore:

- Komunikimin, përdorimin dhe zbatimin e tij në të gjitha procedurat e qytetarëve para organit më të lartë ligjvënës, siç është Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Njëri nga detyrimet e deputetëve është edhe komunikimi i vazhdueshëm, i përhershëm me qytetarët apo me votuesit, andaj në kuadër të këtij procesi ata duhet të jenë transparentë me qytetarët, me qëllim të realizimit të kërkesave të tyre, ngase pikërisht legjitimiteti i tyre buron nga qytetarët;
- Në punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha dhe alfabeti i saj të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Deputeti, funksionari i zgjedhur, i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në seancën e kuvendit dhe në mbledhjet e trupave punues flet edhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Nisur nga fakti se seancat e kuvendit dhe

mbledhjet e trupave punuese janë publike, ndërsa votuesi dhe qytetari mund ta ndjekë punën e tyre, shihet nevoja e përdorimit të gjuhës shqipe edhe në këtë drejtim. Në këtë mënyrë votuesi përcjell punën e deputetit, konstaton sa është aktiv në artikulimin e kërkesave të tij dhe krijon qëndrimin se sa deputeti i mbron interesat e tij dhe të qytetarëve në tërësi dhe, njëkohësisht, përcjell aspektin e zbatimit të programit, të cilin deputeti e ka shpallur gjatë fushatës parazgjedhore;

- Deputeti që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kur kryeson seancën e kuvendit ose mbledhjet e trupave punuese, ato i kryeson në atë gjuhë;
- Deputeti, funksionari i zgjedhur, i emëruar që flet një gjuhë të ndryshme nga ajo maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, materialet i pranon, i dorëzon edhe në gjuhën dhe alfabetin e tij, që të shërbejnë në seancën e kuvendit ose në mbledhjen e trupave punuese. Trupat punuese (grupet parlamentare) kanë ndikim të veçantë në fazat e miratimit të ligjeve, kështu që përgatitja e materialeve edhe në gjuhën shqipe i mundëson deputetit të jetë më profesional në këtë sferë;
- Stenogramet nga seancat e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nga mbledhjet e trupave punues, si dhe materialet dhe dokumentet e tjera lëshohen dhe ruhen në gjuhën maqedonase, alfabetin e saj dhe në gjuhën e alfabetin e saj që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo përbën edhe një veprim transparent në informimin e opinionit publik me punën dhe fushëveprimin e tij. Në këtë mënyrë edhe komunikimi dhe njoftimi i medieve është në nivel më të avancuar, përderisa ata njoftojnë publikun për fushëveprimin e tij të tërësishëm;
- Të gjitha ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, publikohen në gjuhën maqedonase, me alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj. Për arsye se ligjet vlejnë për të gjithë qytetarët, publikimi edhe në gjuhën shqipe mundëson që qytetari të njihet në mënyrë të drejtpërdrejt me ligjet në fuqi dhe në këtë mënyrë do të ketë më pak mundësi të jetë i diskriminuar gjatë realizimit të të drejtave të tij. Kjo çështje, kërkon nga "Gazeta Zyrtare" e RMV-së, të sigurojë lekturim profesional të secilit ligj, akt ose dokument i cili publikohet në të. Njëkohësisht ky përcaktim përbën një mekanizëm plotësues në forcimin e shtetit ligjor.

Si veçori e përdorimit të gjuhës shqipe në kuvend, mbetet edhe përdorimi i drejtë, me qëllim që të gjitha dokumentet, materialet, sidomos ligjet, të jenë të përshtatura në mënyrë profesionale në gjuhën shqipe, me qëllim që të mos ketë vështirësi në zbatimin praktik të tyre.

Përcjellja e zbatimit praktik të ligjit dhe arritja e qëllimeve të miratimit të tij

1. Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me qëllimin e zbatimit të ligjit përkatës dhe realizimin e qëllimeve të tij është themeluar Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, institucion ky që është kompetent për standardizimin dhe përdorimin e barabartë të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetit të saj me trupat ndihmëse për mbështetjen e institucioneve. Përcaktimet e ligjit dhe standardet e agjencisë vlejnë për të gjitha institucionet e sistemit juridik-politik në vend, si edhe për kuvendin. Aktualisht, agjencia përkatëse është aktive në realizimin e kompetencave, fushëveprimit dhe përcaktimeve të saj, duke koordinuar veprimtarinë me të gjitha institucionet relevante brenda sistemit juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në këtë drejtim, rol të veçantë ka edhe publikimi i raporteve të punës së kësaj agjencie, duke zbatuar parimin e transparencës në fushëveprimin e këtij institucioni relevant brenda shtetit.

2. Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve

Kryesisht angazhohet për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe dispozitave kushtetuese nga kjo sferë, punët inspektuese lidhur me zbatimin e përcaktimeve përkatëse nga të gjitha institucionet kompetente. Veprimtaria e Inspektoratit rregullohet me ligj të veçantë, i cili përcakton organizimin, kompetencat dhe realizimin e procedurës së mbikëqyrjes dhe inspektimit. Në vazhdimësi mbetet sfidë organizimi, konsolidimi i tij me kuadro profesionale, në mënyrë që të mund t'i realizojë detyrimet ligjore.

Raporti me institucionet e tjera të sistemit juridik

Krahas rolit të veçantë që ka Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve dhe Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve, rol të rëndësishëm në këtë proces ka edhe kuvendi, si institucioni më i lartë juridik-ligjvënës brenda vendit, nisur nga fakti se ai zgjedh qeverinë dhe organet e tjera, andaj edhe e kontrollon punën e tyre. Në këtë drejtim duhet të ecin mënyra dhe procesi i debateve parlamentare. Gjatë kontrollit të punës së qeverisë, deputetët duhet të kujdesen se sa qeveria në tërësi, dhe secila ministri në veçanti, e zbaton Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Mbështetur në faktin se kuvendi është shtylla kryesore e demokracisë, përdorimi i drejtë i gjuhëve zyrtare do të mundësojë që ky institucion të ushtrojë funksionet e tij themelore, siç është ai ligjvënës, zgjedhor dhe kontrollues në mënyrën më efikase. Krijimi i mundësisë që votuesi apo qytetari të përcjellë punën e tij, mundëson njëkohësisht edhe nxitjen e debateve më profesionale nga ana e deputetëve. Duke e ditur se veprimtaria e tij ndiqet drejtpërdrejt nga qytetari, roli i deputetëve do të jetë më efikas edhe në ushtrimin e kontrollit ndaj pushtetit ekzekutiv apo qeverisë. Nga ana tjetër, pa sistem kontrolli dhe përgjegjësie nuk mund të kemi transparencë e profesionalizëm në zbatimin e plotë të ligjeve nga pushteti ekzekutiv.

2. PLANIFIKIMI GJUHËSOR NË MAQEDONINË E VERIUT

Në kuadër të gjuhësisë është zhvilluar një disiplinë e veçantë gjuhësore – gjuhësia e zbatuar (*Applied Linguistics*), që merret me studimin e përdorimit të gjuhës në shoqëri, e cila i identifikon problemet reale gjuhësore në të dhe që ofron zgjidhje për to. Ajo është një fushë ndërdisiplinore e gjuhësisë, që – përveç të tjerash – merret edhe me planifikimin e gjuhësor ose me politikat gjuhësore.

Në të vërtetë, planifikimi gjuhësor nuk është vetëm çështje gjuhësore, por më shumë është një çështje se si një shoqëri ose një shtet e organizon përdorimin e gjuhëve, çfarë përcakton si gjuhë standarde, çfarë përcakton si gjuhë *lingua franca*, e cila në atë shtet është kodi i vetëm i komunikimit (gjuha në të cilën komunikon shteti), një *lingua communis*, pra një gjuhë me të cilën komunikon një bashkësi e caktuar. Diku si parim për përcaktimin e gjuhës standarde merret gjuha e popullit shumicë, diku për bazë merret nacionalizmi, diku shteti, diku zhvillimi arsimor e kulturor në gjuhën përkatëse etj. Bie fjala, për maqedonasit përcaktimi i gjuhës standarde të tyre u bë me formimin e shtetit federal të Maqedonisë më 1944, në mbledhjen e parë të KAÇKM-së (Kuvendit Antifashist për Çlirimin Kombëtar të Maqedonisë – maqedonisht: ASNOM), ndërsa për shqiptarët e Jugosllavisë – sipas Janet Byron-it – *"nacionalizmi u bë faktor në planifikimin gjuhësor të shqiptarëve pas përzgjedhjes së normës"*. Kjo dëshmon se Maqedonisë gjuha i ka shërbyer në ndërtimin e shtetit, ndërsa shqiptarëve në ish-Jugosllavi u ka shërbyer për ruajtjen e kohezionit etnik në Ballkan, duke jetuar në shtete të veçanta.

Modelet e planifikimit gjuhësor

Europa është një kontinent në të cilin, sipas Ranko Bugarskit, fliten 100-200 gjuhë e dialekte, ndërsa sipas Miquel Siguan-it, diku afër 50 gjuhë. Dallimet e këtyre numrave janë varësisht nga ajo se çfarë nënkuptohet me Europë dhe varësisht nga ajo se si i trajtojmë disa gjuhë ose dialekte. Ndërkaq, kur flasim për Bashkimin Europian, aty janë 24 gjuhë zyrtare, por vetëm tri janë gjuhë të administratës së BE-së: anglishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja, gjithsesi me prirje që anglishtja të mbetet gjuhë e vetme e komunikimit zyrtar procedural në BE.

Në gjithë këtë larushi të gjuhëve në Europë, studiuesit e politikave gjuhësore janë përpjekur t'i karakterizojnë tipat e planifikimit gjuhësor. Kështu, Miquel Siguan-i, të cilin e përmendëm edhe më sipër, kur flet për modelet e planifikimit të gjuhëve në shtetet europiane, ato i ndan në pesë tipa:

1) Shtetet njëgjuhëshe – si Franca dhe Portugalia, të cilat në shtetin e tyre e njohin vetëm një gjuhë standarde, pavarësisht se mund të ketë edhe etni e gjuhë të tjera;
2) Shtetet që i pranojnë gjuhët e pakicave – si Britania e Madhe për gjuhën e Uellsit dhe Holanda për gjuhën frize. Në ato shtete ku pranohet vetëm një gjuhë nacionale standarde, njihet edhe prania e pakicave dhe shtetet angazhohen për mbrojtjen e gjuhës së tyre. Nga vendet ballkanike në këtë grup mund ta vendosim edhe Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Kroacinë, Serbinë;

3) Shtetet me autonomi gjuhësore – janë ato shtete ku kemi organizim shtetëror me rajone autonome, si Spanja, ku shteti i njeh si zyrtare të gjitha gjuhët e atyre rajoneve autonome;
4) Shtetet me federalizëm gjuhësor – si Belgjika dhe Zvicra, ku tërësitë gjeografike, pa marrë parasysh a janë kantone ose njësi të tjera, kanë gjuhët e tyre zyrtare dhe shteti i njeh ato si të tilla;
5) Shtetet me shumëgjuhësi të institucionalizuar – si Luksemburgu, Irlanda, por edhe Finlanda. Në rajonin tonë e tillë është Kosova. Në këto shtete pranohen dy e më shumë gjuhë si të barabarta në gjithë territorin e vendit.

Nga kjo mund të përfundojmë se, në bazë të këtij modeli të planifikimit gjuhësor, Maqedonia e Veriut bën pjesë në grupin e shteteve njëgjuhëshe që kujdesen për gjuhën e pakicave. Në fakt, Maqedonia e Veriut këtë gjendje e ka trashëguar nga ish-Jugosllavia, ku zyrtare ishin serbokroatishtja, sllovenishtja dhe maqedonishtja. Kështu, edhe pse shqiptarët në ish-Jugosllavi ishin sa sllovenët (8 %) dhe më shumë se maqedonasit (6 %), në mungesë të një njësie të barabartë federale (republikë), ata nuk e gëzuan të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës. E, ndërsa Jugosllavia kishte federalizëm gjuhësor dhe kujdes ndaj gjuhës së pakicave (shqipes, hungarishtes, turqishtes, vllahishtes etj.), shtetet që dolën prej saj ndoqën modele të shteteve njëgjuhëshe, gjithnjë duke e ruajtur karakterin njëetnik të shteteve, siç do ta përshkruajmë më poshtë në kushtetutat përkatëse. Pra, tani kur ato janë shtete të pavarura, në këto shtete vazhdon të mbizotërojë ideja romantike e trinitetit *gjuha-kombi-shteti*, sipas së cilës secili komb duhet ta ketë gjuhën dhe shtetin që i përket vetëm atij.

Dhe, kur kemi arritur në këtë pikë, duhet të konstatojmë se, ashtu si në ish-Jugosllavi, shqiptarët vazhduan të trajtohen si pakicë edhe në Maqedoni e, rrjedhimisht, edhe gjuha shqipe si gjuhë e pakicës. Ndërkaq kjo e implikon çështjen se çfarë paraqet pakica, si e perceptojnë veten shqiptarët, si trajtohen në dokumentet zyrtare të shtetit dhe si trajtohet gjuha në pajtim me këto dokumente? Sipas Kombeve të Bashkuara, në një përkufizim të ofruar në vitin 1977 nga Francesco Capotorti, raportues special i Nënkomisionit të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave, *minoritet* është: *"Një grup numerikisht inferior ndaj pjesës tjetër të popullsisë së një shteti, i cili është në pozita dominuese, ndërsa anëtarët e minoritetit – duke qenë shtetas të shtetit përkatës – kanë karakteristika etnike, fetare ose gjuhësore të ndryshme nga ato të pjesës tjetër të popullsisë..."*. Kështu, nëse kombin shqiptar dhe gjuhën shqipe e shohim në prizmin e pakicës kombëtare, duke iu referuar konventave ndërkombëtare të OKB-së dhe BE-së për pakicat kombëtare dhe për gjuhët e pakicave kombëtare, i bie që shqiptarët në Maqedoninë e Veriut të jenë të privilegjuar dhe gjuha shqipe aty të jetë mjaft e avancuar. Por, problemi themelor qëndron në faktin se shqiptarët nuk e perceptojnë veten si pakicë, por si: 1) komb autokton në Maqedoninë e Veriut; 2) komb shtetformues i Maqedonisë së Veriut; 3) së paku ¼ e shtetit, ndërsa 4) për pakica kombëtare i konsiderojnë romët, turqit, serbët, vllehtë etj. Këtu lind kundërshtia. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, mbase, më shumë do të pranonin të trajtohen me konventat për popujt indigjenë (sado që ato u referohen popujve si indianët e Amerikës ose aborigjenët e Australisë), gjithnjë duke kërkuar të trajtohen si popull autokton, sesa të trajtohen me konventat e pakicave, kjo sepse – përveç të tjerash – gjuha e pakicës është e kufizuar. Sipas Janet Byron-it, gjuha e pakicës nuk mbizotëron në të gjitha fushat e përdorimit të gjuhës, folësit e një gjuhe të pakicës janë të detyruar të jenë dygjuhësh, dhe gjuha e pakicës është e varur nga gjuha e shumicës etj., siç ndodh

edhe me shqipen në Maqedoninë e Veriut.

Maqedonia e Veriut dhe politika gjuhësore

Çështja e statusit të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, përveçse çështje linguistike, është edhe çështje politike e juridike.

Duke marrë për bazë planifikimin gjuhësor dhe politikat gjuhësore, mendojmë se mund ta shpjegojmë edhe gjendjen e gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, statusin e saj juridik, nivelin e përdorimit të saj, mënyrën e rregullimit të përdorimit të saj, problemet e përdorimit e kështu me radhë.

Maqedonia është njësi e veçantë juridike që nga viti 1944, deri më 1991 ishte njësi e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ndërsa nga viti 1991 është shtet i pavarur. Në mbledhjen e KAÇKM-së (*Kuvendi Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Maqedonisë)* të mbajtur më 2 gusht 1944 në Manastirin e Shën Prohorit të Pçinjës, kur u vunë themelet e shtetësisë së Maqedonisë, mes disa dokumenteve të miratuara, në raport me përdorimin e gjuhëve, në nenin 1 të *Vendimit të Kuvendit Antifashist të Çlirimit Popullor të Maqedonisë për vendosjen e gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare në shtetin maqedonas* u vendos që: *"Në shtetin maqedonas si gjuhë zyrtare vendoset gjuha popullore maqedonase"*. Pas kësaj, më 3 maj 1945, me propozim të Komisionit të Gjuhës, Qeveria Popullore e Maqedonisë Federative e vendosi pranimin e alfabetit maqedonas, ndërsa më 7 qershor 1945 e miratoi edhe drejtshkrimin e gjuhës maqedonase.

Këtu u vendos edhe korniza e politikës gjuhësore në shtetin e ri të Maqedonisë. Ndonëse juridikisht formulimi në *Vendimin e Kuvendit Antifashist...* dhe në *Deklaratën* e KAÇKM-së *për të drejtat themelore të qytetarit...* të gjithë qytetarët viheshin në pozitë të barabartë dhe nuk krijohej asnjë shkallëzim/hierarki, në vendimin për gjuhën, në mënyrë konkrete dhe të saktë u vendos që në Maqedoni si gjuhë zyrtare (kod i vetëm i komunikimit ose si gjuhë me të cilën komunikon shteti) të ishte maqedonishtja. Këtu zë fill politika gjuhësore e Maqedonisë së Veriut, që – sipas shqiptarëve në këtë shtet – vazhdon të krijojë probleme edhe sot.

Kur jemi këtu, duhet të konkludojmë se janë dy pika të rëndësishme në çështjen e gjuhës që e determinojnë përdorimin e shqipes në Maqedoninë e Veriut: e para ka të bëjë me faktin se kush është kombi bartës i sovranitetit në Maqedoninë e Veriut dhe, e dyta, cila është gjuha zyrtare e përcaktuar në kushtetutën dhe ligjet e vendit. Sipas prof. Kambovskit, me dokumentet e prodhuara në Mbledhjen e Parë të KAÇKM-së *"Maqedonia është përcaktuar si shtet i kombit maqedonas dhe i të gjithë qytetarëve të saj që jetojnë në të*". Madje, prof. Kambovski e përcakton edhe modelin mbi të cilin u krijua Maqedonia. Ai thotë se: *"... procesi i krijimit të saj u bë duke marrë për bazë njërin nga dy modelet e paraqitjes dhe zhvillimit të kombeve bashkëkohore europiane: shtet-gjuhë-komb ose gjuhë-komb-shtet"*. Që të jemi më të saktë, i bie të themi se te kombi maqedonas dhe shteti i Maqedonisë ka shërbyer modeli i parë, ndërsa shqiptarët janë komb që kanë buruar nga gjuha, për të arritur deri te shteti. Sidoqoftë, vetë përcaktimi i këtij modeli të ndërtimit të Maqedonisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e ka përcaktuar edhe çështjen e gjuhës zyrtare si kod i vetëm i komunikimit. Në terma të studimit të politikës gjuhësore, Maqedonia që këtu është përcaktuar si shtet njëgjuhësh, siç është Franca ose Portugalia, ose si shtet njëgjuhësh që i njeh dhe i pranon gjuhët e pakicave. Maqedonasit e kanë perceptuar Maqedoninë si shtet *"të kombit maqedonas"* (dhe *"të tjerëve")* dhe gjuhën maqedonase si gjuhë e vetme zyrtare e shtetit, si *"mjet koheziv i shtetit"*, Më poshtë do sjellim edhe trajtimet e tjera në dokumentet juridike pas

themelimit të Maqedonisë si shtet federativ në kuadër të ish-Jugosllavisë, ku maqedonishtja, po ashtu, ishte njëra nga gjuhët zyrtare të ish- RSFJ-së.

Duke iu referuar Kushtetutës së Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë të vitit 1946 (neni 2), që e njihte edhe Maqedoninë si njësi të barabartë të federatës, pra si Republika Popullore e Maqedonisë, maqedonasit u pranuan si komb në kuadër të Jugosllavisë, duke iu njohur shteti federativ i Maqedonisë i tipit *shtet-komb-gjuhë*.

Në vitin 1963, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (me emër të ndryshuar) e miratoi kushtetutën e re, në të cilën përsëri (në nenin 2) e rikonfirmonte Maqedoninë si njësi të barabartë të federatës jugosllave, ndërsa në nenin 131, në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare thuhej: *"Ligjet federale dhe aktet e tjera të përgjithshme të organeve federale botohen në fletën zyrtare të federatës në tekste autentike në gjuhët e popujve të Jugosllavisë, serbokroatisht, përkatësisht kroatoserbisht, sllovenisht dhe maqedonisht"*. Sipas kësaj, kombi/shteti maqedonas mbetet njësi e barabartë e federatës, ndërsa maqedonishtja mbetet gjuhë zyrtare në kuadër të Jugosllavisë. Kjo do të konfirmohej edhe në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë të vitit 1963. Kështu, në lidhje me gjuhën, në nenin 61 thuhej: *"Puna në të gjitha organet shtetërore, në organet e vetëqeverisjes shoqërore dhe në organizatat që kryejnë punë me interes publik, bëhet në gjuhën maqedonase"*. Më tej në këtë nen, si dhe në nene të tjera të kësaj kushtetute, përshkruhet se ku mund të përdoret gjuha e kombësive, që nënkupton përdorimin e saj në arsim, në jetën kulturore, në disa procedura gjyqësore, në organizatat e punës, në komuna etj., gjithnjë pranë gjuhës maqedonase.

Ndonëse në ish-Jugosllavi Kushtetuta e vitit 1974 njihej si kushtetuta që e liberalizoi RSFJ-në, edhe ajo e ruajti shtetin njëetnik maqedonas dhe primatin e gjuhës maqedonase. Kështu edhe në të Maqedonia vetëm konfirmohej si shtet i këtillë. Në nenin 173 të kësaj kushtetute, për çështjen e gjuhëve, thuhet: *"Puna në organet shtetërore, në organet e qeverisjes së organizatave dhe bashkësive që kryejnë punë me interes publik, kryhet në gjuhën maqedonase"*. Edhe këtu përsëritet qëndrimi se *"Maqedonia është shtet kombëtar i kombit maqedonas"* dhe se *"gjuha maqedonase është gjuha e shtetit"*. Nga kjo rridhte që shqiptarët dhe turqit ishin pakica kombëtare (atëherë quheshin *kombësi* – që përbënte një term i cili e nënkuptonte një komunitet me status më të ulët se *kombi*) dhe gjuha e tyre trajtohej si e tillë: *"Secilit i garantohet e drejta e procedurës gjyqësore para gjykatës ose organeve të tjera shtetërore, organizatave dhe bashkësive që në kryerjen e autorizimeve publike vendosin për të drejtat dhe detyrimet e njerëzve punëtorë, ta përdorin gjuhën e tyre dhe në atë procedurë të njoftohen me faktet në gjuhën e tyre"*.

Kushtetuta e Maqedonisë kishte pësuar ndryshime edhe më 15 korrik 1981 (Gazeta Zyrtare e RSM-së nr. 25/1981) dhe më 7 shkurt 1986 (Gazeta Zyrtare nr. 3/1986), por tema e gjuhës kishte mbetur njësoj. Ndërkaq, më 14 prill 1989 (Gazeta Zyrtare nr. 16/1989) me pikën 1 të amendamentit XLIII u ndryshua neni 1 i Kushtetutës së vitit 1974 dhe aty do të shkruhej: *"Në Republikën Socialiste të Maqedonisë në përdorim zyrtar dhe publik është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik"*, ndërsa me alinenë 2 të amendamentit XLIII ndryshojnë edhe pikat 1 dhe 3 të nenin 178 të Kushtetutës së vitit 1974 dhe tani shqiptarët e turqit nuk do të përmenden fare: *"Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë ta përdorin lirshëm gjuhën dhe shkrimin e tyre dhe ta zhvillojnë kulturën e tyre dhe të themelojnë organizata"*. Pra, pasi maqedonasve u garantohet sovraniteti mbi shtetin dhe pasi që maqedonishtja vuloset si gjuhë zyrtare dhe kod i vetëm i komunikimit të shtetit, "pjesëtarët e kombësive" (shqiptarët, turqit, romët, vllehtë

boshnjakët etj.) vendosen në rendin e qytetarëve pakicë, të cilëve u takojnë të drejtat e pakicave kombëtare (sipas terminologjisë së sotme të BE-së: *minoriteteve*), si mësimi në gjuhën amtare në shkolla fillore dhe të mesme dhe realizimi i identitetit kulturor (amendamentet XLIII dhe XLIV).

Ndryshime të kushtetutës bëhen edhe më 20 shtator 1990 dhe më 7 korrik 1991, por këto pika mbeten të njëjta. Pastaj, më 17 nëntor 1991, pra pas Referendumit për Pavarësi të Maqedonisë nga Jugosllavia (8 shtator 1991), u miratua kushtetuta e re pluraliste (Gazeta Zyrtare 52/1991), të cilën partitë politike shqiptare (Partia e Prosperitetit Demokratik dhe Partia Demokratike Popullore) nuk e votuan. Aty, në nenin 7 thuhej: *"Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik"* dhe *"Në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në të cilat si shumicë jetojnë pjesëtarë të kombësive, në përdorim zyrtar, përveç gjuhës maqedonase dhe shkrimit cirilik, janë edhe gjuha dhe shkrimi i kombësisë siç është përcaktuar me ligj"*.

Kërkesa për barazi etnike dhe gjuhësore e shqiptarëve me maqedonasit, që gjithnjë haste në rezistencë nga shteti, do të kulmojë me konfliktin e vitit 2001, që do të sjellë Marrëveshjen e Ohrit (13 gusht 2001), e cila do t'i përfshijë edhe ndryshimet kushtetuese në frymën e shtetit shumetnik, të miratuar më 16 nëntor 2001 (Gazeta Zyrtare 91/2001). Aty, në raport me gjuhën, me ndryshimet kushtetues në amendamentin V, do të thuhej: *"Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik."*; *"Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç është përcaktuar me këtë nen."* Siç mund të vërehet, në pjesën e gjuhës, qëndrimi është edhe më i qartë – *"gjuha e vetme zyrtare si kod i vetëm i komunikimit në shtet mbetet maqedonishtja"*, ndërsa gjuhët *"mbi 20%"* (askund nuk përmendet gjuha shqipe, që të ruhet identiteti "një shtet-një komb-një gjuhë"), pasi janë ndarë nga "gjuha e vetme zyrtare – kodi i vetëm i komunikimit", shpjegohet se si dhe sa mund të përdoren. Ndërkaq, në pjesën e poshtme të shpjegimit të përdorimit, kjo lë të nënkuptohet se gjuhët "mbi 20%" përdoren vetëm pranë maqedonishtes, që i bie se ato janë gjuhë të përkthyera (dhe, se kodi i vetëm i komunikimit mbetet maqedonishtja) dhe se më shumë kanë të bëjnë me përdorimin e tyre në pushtetin lokal ose lihet të përcaktohen me ligj. E, kur këto amendamente u përfshinë në ligj, doli se *"gjuha mbi 20%"* në asnjë rast nuk ishte e barabartë me maqedonishten, në disa institucione të pushtetit qendror ishte gjuhë e përkthyer, madje me status të gjuhës së përkthyer ishte edhe në pushtetin lokal. Kështu, Ligji për Përdorimin e Gjuhës Maqedonase (Gazeta Zyrtare 5/98), bashkë me ndryshimet që e kanë avancuar përdorimin e saj, përcaktuan se statusi i maqedonishtes mbetet i paprekshëm si gjuhë e vetme zyrtare në gjithë territorin dhe si gjuhë në të cilën duhej të komunikonte shteti. Ndërkaq gjuha shqipe mbeti të interpretohej në ligjin për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20 % e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale (Gazeta Zyrtare 101/2008), që ka pësuar ndryshime avancimi më 2011 (Gazeta Zyrtare 100/2011).

Përpjekja e fundit për avancimin e përdorimit të gjuhës shqipe është bërë më 11 janar 2018, kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Ndonëse ky ligj nuk e ka barazuar shqipen me maqedonishten (ka bërë emërtimin në kllapa "gjuha shqipe", ndërsa në tekst akoma mbetet "gjuha të cilën e flasin 20 % e qytetarëve"), ai e ka zgjeruar përdorimin e saj zyrtar në organe të pushtetit presidencial, ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, lokal, si edhe në komunikim

ndërkombëtar, në ushtri, në polici dhe në monedha, por edhe në veprimtari të tjera (i mbikëqyrur për herë të parë nga institucionet për mbrojtjen e gjuhës). Por, edhe në këtë ligj mbetet formulimi *"pranë gjuhës maqedonase"*, që nënkupton se statusi i maqedonishtes ka mbetur *"kodi i vetëm i komunikimit të shtetit"*, sipas asaj që është projektuar në KAÇKM dhe që vazhdon, ndërsa shqipja mbetet gjuhë e përkthyer.

Ajo që ka ardhur si risi me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve është themelimi i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (vijon paradoksi që mos të emërtohet Agjencia e Zbatimit të Gjuhës Shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut), si dhe themelimi i Inspektoratit për Përdorimin e Gjuhëve (ligji është në procedurë). Roli i agjencisë është ta ndihmojë përdorimin zyrtar të shqipes në bazë të këtij ligji, ndërsa inspektoratit do t'i duhet të kujdeset për (mos)respektimin e ligjit.

Projektimi i zgjidhjes

Pasi kemi bërë këtë përshkrim kronologjik të dokumenteve që e kanë rregulluar edhe çështjen e gjuhëve në Maqedoninë e Veriut, lirisht mund të konstatojmë se arsyeja që gjuha shqipe nuk ka mundësi të barazohet me maqedonishten ose të ketë status të gjuhës së dytë zyrtare është se shteti i Maqedonisë së Veriut vazhdon ta ruajë trinitetin *"shteti-kombi-gjuha"*, që nënkupton se Maqedonia e Veriut është shtet i kombit maqedonas, në të cilin flitet gjuha maqedonase, ndërsa shqiptarët në të, herë janë trajtuar si *kombësi*, herë si *pakicë*, herë si *bashkësi etnike*, që me terminologjinë e re i bie të jenë *minoritet*. Kjo e ka determinuar edhe përdorimin e gjuhës shqipe, e cila – juridikisht i bie të jetë në statusin e gjuhës turke, rome, serbe e vllahe, sepse edhe shqiptarët janë në kategorinë e njëjtë të qytetarëve të Maqedonisë. Për shkak të përpjekjeve politike dhe kulturore-arsimore, që kanë bërë shqiptarët, gjuha shqipe ka arritur të përparojë në zbatim, por gjithnjë duke mos i lëkundur tri shtyllat kryesore të shtetndërtimit të saj "shtet-komb-gjuhë" dhe duke mbetur në kuadrin e të drejtave të pakicave. Pra, i gjithë problemi i betejës së shqiptarëve për gjuhë paraqitet në perceptimin e ndryshëm të shtetit: shqiptarët e shohin veten si komb shtetformues dhe, nëse jo të barabartë me maqedonasit, së paku si kombi i dytë shumicë, ndërsa maqedonasit dhe vetë shteti i sheh shqiptarët si "një nga minoritetet".

Nga kjo mund të konstatojmë se problemi themelor i Maqedonisë së Veriut, në këtë aspekt, është statusi i kombit shqiptar në këtë shtet, sepse kjo e implikon edhe statusin e përdorimit të gjuhës shqipe. Nëse shqiptarët trajtohen si minoritet, edhe zbatimi i gjuhës së tyre do të bëhet në kuadër të të drejtave të minoriteteve. Andaj, në këtë aspekt, shteti i Maqedonisë së Veriut, sot madje mburret, se një minoriteti i ka dhënë aq shumë hapësirë në përdorimin e gjuhës. Megjithatë, kjo i ka lënë shqiptarët të pakënaqur, sepse ata – meqë nuk vetëperceptohen si minoritet – e ndjejnë se janë të diskriminuar në të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës. Për këtë arsye mund të konstatojmë se ky avancim i deritanishëm i pjesshëm i gjuhës shqipe ka prodhuar një shtet gati hibrid: ekziston një shtet njëetnik dhe njëgjuhësh me disa pakica, dhe ekziston një pakicë që dallohet për nga të drejtat e arritura (pra, jo për nga statusi në kushtetutë). Pra, kushtetuta i trajton shqiptarët njësoj si pakicat e tjera, ndërsa me ligje bëhet zgjerimi i të drejtave të tyre.

Prandaj, nëse synohet të zgjidhet kjo asimetri, do të duhet që së pari të zgjidhet statusi i shqiptarëve si komb në Maqedoninë e Veriut; ata ose duhet të jenë të barabartë

me kombin maqedonas, si bartës të sovranitetit të shtetit – bashkëpronarë historikë dhe politikë të shtetit, ose duhet të gëzojnë një status special (sui generis) – një nivel më poshtë se kombi shumicë maqedonas, por edhe një nivel më lart se pakicat e tjera në vend. Kjo do ta nënkuptonte edhe statusin e gjuhës dhe të drejtat e tjera.

Sipas asaj që paraqitëm më sipër, i bie që Maqedonia e Veriut – si vend aspirant për BE – nga shteti njëgjuhësh, që njeh gjuhët e pakicave, do të duhet të kalojë në një institucionalizim gjuhësor. Si model i përafërt i tillë është Kosova, ku gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare në nivel nacional, ndërsa gjuhët e pakicave janë zyrtare në nivel lokal. (Po theksojmë se serbët në Kosovë, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, janë vetëm 1.5 %.) Një model tjetër i mirë është edhe Finlanda, ku suedishtja, edhe pse është gjuhë që e flasin vetëm 5 % e popullatës, gëzon statusin e gjuhës nacionale zyrtare të Finlandës (atje jetojnë 93.4 % finlandezë dhe pak më shumë se 5.6 % suedezë). Natyrisht, që të arrihet kjo, kërkohet më shumë mirëbesim dhe më shumë kohezion shoqëror.

Nisur nga kjo, sipas nesh, që të zgjidhet ky ngërç, Maqedonia e Veriut do të duhet të bëjë ndërhyrje në kushtetutë, për ta korrigjuar statusin e shqiptarëve në të e pastaj të hartojë një politikë tjetër të gjuhëve ose një planifikim tjetër gjuhësor, duke krijuar një institucionalizim gjuhësor, me miratimin e një ligji të vetëm për përdorimin e gjuhëve, ku do të përcaktohej përdorimi i gjuhës së kombit shumicë (maqedonishtes), i gjuhës së kombit të dytë shumicë (shqipes) dhe i gjuhëve të pakicave (turqishtes, serbishtes, vllahishtes, boshnjakishtes, gjuhës rome). Kjo do të zgjidhte një problem të gjatë, do ta shtensionontе shtetin, do të krijonte më shumë mirëbesim mes qytetarëve dhe ndaj institucioneve, si dhe do të mundësonte integrimin dhe përfshirjen e shqiptarëve në kuadër të shtetit.

* Poshtëshënimet dhe burimet janë hequr për shkak të natyrës së doracakut.

Izer Maksuti

3. POLITIKAT GJUHËSORE EUROPIANE

Qëllimi i këtij shkrimi, për natyrën e këtij botimi, është që në pika të shkurtra të sqarojë domethënien e nocionit *politikë gjuhësore* dhe *planifikim gjuhësor*, funksionin dhe fushat e veprimit të politikës gjuhësore, si dhe modelet e politikave gjuhësore europiane.

Ç'është politika gjuhësore?

Gjuha është objekt hulumtimi jo vetëm i gjuhësisë, por edhe i disa disiplinave të tjera shkencore. Gjuhët janë mjeti kryesor i komunikimit shoqëror në mes individëve të veçantë, grupeve dhe popujve të ndryshëm.

Objekti i politikës gjuhësore ka të bëjë me shumë fusha, por ndër qëllimet kyç është planifikimi gjuhësor, përhapja e gjuhës dhe politika ndaj pakicave gjuhësore, si dhe politika e gjuhëve të huaja. Dihet që, si çdo disiplinë shkencore, edhe kjo fushë relativisht e re e sociolinguistikës, i ka specifikat e veta terminologjike. E shohim të nevojshme që fillimisht t'i sqarojmë këto dy nocione, për njohjen më të lehtë të kësaj problematike.

Në leksikonin e gjuhësisë të Bußmann-it, gjejmë përkufizimin më të qartë për këtë term: "***Politikë gjuhësore*** *– masa politike, veçmas në shtetet shumëgjuhëshe, që kanë për qëllim përdorimin, zhvillimin dhe zbatimin e gjuhëve të veçanta si p. sh.: njohja e gjuhëve zyrtare dhe e gjuhëve të punës në organizata ndërkombëtare ose rregullore për mësimin e gjuhës së nënës te grupet e migrantëve (p. sh.: spanjishtja në SHBA, turqishtja në Gjermani), si dhe mësimi i gjuhëve të huaja dhe mësimi në disa gjuhë ...",* (Bußmann, Hadumod 2008, f. 658).

Po në këtë burim nocioni *planifikim gjuhësor* përkufizohet si në vijim: *"**Planifikim gjuhësor** – masa sociolinguistike, përkatësisht politike për zgjidhjen e problemeve të komunikimit. Sipas HAUGEN-it (1966) dallohen dy lloje kryesore: a) "Planifikimi i statusit" që përcakton funksionin dhe aftësinë e disa gjuhëve në shtetet, përkatësisht bashkësitë gjuhësore multilinguale, vendos bazat për zgjedhjen e gjuhës nacionale, zhvillon strategji për ringjallje, ose kundër kanosjes së vdekjes së gjuhëve; b) "Planifikimi i korpusit", këtu bëhet fjalë, para së gjithash, për zhvillimin e normave të standardit gjuhësor, konventave dhe sistemeve ortografike, ose për zhvillimin e leksikut të një gjuhe, p. sh. për zhvillimin e leksikut të specializuar ose terminologjik"* (Bußmann, Hadumod 2008, f. 657).

Shpesh nocioni i planifikimit gjuhësor përdoret si mbiterm, si një instrument i "politikës me gjuhën". Politika(t) gjuhësore dhe planifikimi gjuhësor gjithsesi janë të ndërlidhura ngushtë. Politika gjuhësore ka të bëjë me ndërhyrje konkrete të shtetit në përdorimin e gjuhës. Ajo përmes legjislacionit gjuhësor krijon një kornizë ligjore për planifikim gjuhësor. Pra, në qendër të politikës gjuhësore është planifikimi i gjuhës. Planifikimi gjuhësor historikisht për një shtet kombëtar ka pasur një rëndësi të veçantë për zhvillimin e gjuhës kombëtare.

Hulumtimi i planifikimit gjuhësor është zhvilluar në dy drejtime: *planifikim i*

korpusit të gjuhës dhe *planifikim i statusit të gjuhës*. Planifikimi i prestigjit të gjuhës, sikurse politika gjuhësore ndërlidhet me statusin ligjor, politik dhe shoqëror të gjuhës, p. sh.: gjuhë kombëtare, gjuhë zyrtare, gjuhë pune, gjuhë rajonale apo pakicë e njohur me ligj, gjuhë e institucioneve shtetërore, gjuhë e arsimit, shkencës etj.

Nëpërmjet miratimit të ligjeve politika gjuhësore krijon kornizën ligjore për planifikim gjuhësor. Planifikimi i prestigjit të gjuhës ka të bëjë me rregullimin shtetëror të përdorimit të gjuhëve dhe nuk ka pikëprerje me planifikimin e korpusit gjuhësor, i cili ka të bëjë me strukturën dhe formën e gjuhës: leksikun, ortografinë ose mjetet stilistike të një gjuhe. Sipas Janich-it *planifikimi i korpusit gjuhësor* ka të bëjë, para së gjithash, me: përpunimin e gjuhës: zhvillimin e fushave të përdorimit dhe zgjerimin e fushave të veprimit dhe të mjeteve gjuhësore, kodifikimin e gjuhës: përcaktimi i normës gjuhësore, p. sh. gramatika, fjalorë etj.; kultivimin/lëvrimin e gjuhës: përmes kritikës gjuhësore, këshillave gjuhësore, ballafaqimit me ndikimin e fjalëve të huaja (krh. Janich, N. 2005, f. 17-19). Nocioni i politikës gjuhësore është i lidhur ngushtë me gjuhët kombëtare. Ato, sikurse shtetet kombëtare, parë nga këndvështrimi historik janë një fenomen i ri. Gjuhët kombëtare shihen si simbol i identitetit dhe bashkimit të çdo kombi. Njëkohësisht gjuhët kombëtare kanë statusin e gjuhës zyrtare, për këtë arsye gjuhët kombëtare duhet të jenë gjuhë standarde me qëllim që, përherë të kemi (të paktën me shkrim, zyrtarisht) komunikim gjuhësor të njësuar, ndërmjet pjesëtarëve të një bashkësie të njëjtë gjuhësore. Planifikimi i statusit të gjuhës, para së gjithash, ka të bëjë me funksionin, prestigjin dhe statusin e gjuhës.

Funksioni i politikës gjuhësore

Gjuhët në shoqëri kanë disa funksione: gjuha si kriter për përcaktimin e një grupi etnik dhe social; gjuha si politikum (mjet i politikës); gjuha si medie, objekt dhe element drejtues i politikës etj.

Nëpërmjet politikës gjuhësore në një vend shumëgjuhësh rregullohet raporti i gjuhëve të ndryshme në mes tyre. Rregullimi mund të shkojë në drejtim të mbështetjes së gjuhëve pakicë ose edhe në shtypjen dhe diskriminimin e një bashkësie gjuhësore.

Shteti përmes legjislacionit gjuhësor: ligjeve, rregulloreve, rekomandimeve etj., përcakton kulturën gjuhësore të një vendi. Ndikimi i politikave gjuhësore është gjithkund i pranishëm: te filmat (me titra apo sinkronizim), udhëzimet e përdorimeve të prodhimeve e pajisjeve të ndryshme, prania e madhe e fjalëve të huaja, sidomos sot të anglicizmave, formulimet e duhura gjuhësore, përdorimi korrekt gjuhësor, tabelat e vendeve dhe mbishkrimet në dy e më shumë gjuhë, e drejta e përdorimit të gjuhëve të pakicave dhe emigrantëve etj. (krh. De Cillia, R./Wodak, R. 2006, f. 15-17).

Sa më i madh të jetë potenciali komunikues i një gjuhe, aq më e fortë është jo vetëm lidhja e folësve të saj me atë gjuhë, pra besnikëria ndaj saj, me këtë edhe me kulturën e ndërlidhur me atë gjuhë.

Politika gjuhësore, si dhe planifikimi gjuhësor duhen të kenë pretendim moral, bazuar në të drejtat e njeriut, për të mos favorizuar dhe diskriminuar palën tjetër. Politika gjuhësore nuk është diçka konstante, por mund të ndryshojë sikurse tjetërsohet realiteti shoqëror.

Politika gjuhësore europiane

Politika gjuhësore europiane ndahet në dy fusha: njëra që vlen për tërë kontinentin e Europës, e cila shtrihet nga Atlantiku deri në Ural, dhe tjetra, politika gjuhësore e Bashkimit Europian, vlen vetëm për vendet anëtare të këtij unioni.

Harald Haarmann-i në parim dallon "*politikën gjuhësore europiane*" të Bashkimit Europian prej "*Politikës gjuhësore në Europë*", që vlen për gjithë Europën, pasi kemi dallime të organizimit politik në mes shteteve të Europës, në lindje dhe perëndim, dhe dallime politiko-shoqërore.

Bashkimi Europian prej shumë vitesh mundohet të krijojë politika optimale gjuhësore të cilat përjashtojnë pabarazinë e diskriminimin dhe kanë për qëllim të mbështesin diversitetin gjuhësor dhe kulturor të Europës. Ndër qëllimet kryesore të planifikimit gjuhësor europian janë mbrojtja e shumëllojshmërisë gjuhësore dhe mbështetja aktive e mësimit të gjuhëve për të forcuar njohjen e gjuhëve në BE, pasi kjo u ofron atyre mundësi të tjera punësimi dhe në përgjithësi përmirëson gjendjen ekonomike dhe politike të shoqërisë.

E veçanta e politikës gjuhësore të BE-së është që secili vend bën politikën e vet gjuhësore dhe Brukseli, përkatësisht Strasburgu kanë vetëm një rol këshillues. BE-ja zhvilloi konceptin e shumëgjuhësisë europiane, si përgjigje ndaj mbrojtjes me këmbëngulje të çdo gjuhë kombëtare nga shtetet nacionale.

Politika e përhapjes së gjuhëve është pjesë e politikave gjuhësore të BE-së, e cila parimisht bazohet në ruajtjen dhe përhapjen e potencialit komunikues të gjuhëve zyrtare të saj.

Një ndër arsyet kyç të mbrojtjes së gjuhëve nga BE-ja është ndërlidhja e ngushtë e tyre me kulturën dhe identitetin europian. Kultura dhe identiteti ruhen përmes gjuhës. Në shoqërinë e sotme gjuha përbën elementin bazë për çdo kulturë përkatëse.

Komisioni Europian për të zbatuar me sukses dy qëllimet kryesore të politikës gjuhësore europiane: shumëgjuhësinë dhe mbështetjen e identiteteve kulturore dhe integrimit social, ka planin që çdo qytetar i BE-së, krahas gjuhës së tij amtare të zotërojë së paku edhe dy gjuhë të tjera (krh. Eurobarometer, Europeans and their Languages 2006, f. 17).

Cilat fusha luajnë rol për politikën gjuhësore?

Fushat në vijim janë të rëndësisë së veçantë për vendimet e politikës gjuhësore: arsimi, administrata, mediet, politika, kultura, feja, fusha e drejtësisë, simbolet e shtetit, mjekësia, ekonomia, shkenca etj. Sidomos fusha e arsimit është më e ndjeshme dhe e rëndësishme për politikën gjuhësore, pasi shkollimi në gjuhën e nënës është vendimtar për ruajtjen dhe mbështetjen e identitetit kulturor dhe gjuhësor. Përdorimi i gjuhës amtare është i domosdoshëm për të ruajtur vazhdimësinë e kulturës së bashkësisë gjuhësore. Për këtë arsye masat e politikës gjuhësore në sistemin arsimor janë bazë e politikës shoqërore e orientuar në gjuhë, pasi sektori i arsimit është më i ndjeshëm. Po të kemi politikat e duhura gjuhësore në arsim, kjo ndikon pozitivisht në ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore të një pakice. Në të kundërtën, nëse kemi diskriminim në fushë të arsimit, duke favorizuar dominimin e gjuhës zyrtare, kjo ka pasoja të pakthyeshme për ekzistencën e një pakice (krh. Haarmann, H. 1988, f. 1669).

Në përgjithësi janë tri fusha të politikës gjuhësore europiane në të cilat BE-ja ka më shumë ndikim: E para ka të bëjë me rregullimin ligjor se cilat janë gjuhët zyrtare dhe gjuhët e punës së BE-së, si dhe me përcaktimin e përdorimit të gjuhëve të BE-së përbrenda institucioneve dhe komunikimit të institucioneve me jashtë. Me rëndësi është zgjedhja e gjuhës zyrtare ose gjuhës së punës që do të përdoret në institucionet e BE-së. Çështja e gjuhëve është rregulluar me dokument që në vitin 1958, i vetmi dokument deri më sot për çështjen e gjuhës në BE. Kjo listë e gjuhëve aktualizohet pas çdo zgjerimi të BE-së. Përveç kësaj, aty përcaktohet komunikimi që zhvillohet në mes vendeve anëtare të BE-së si dhe marrëveshjet, ligjet dhe gazetat zyrtare hartohen në të gjitha gjuhët e BE-së. Që nga viti 2015 Bashkimi Europian ka 28 vende anëtare dhe 24 gjuhë zyrtare (shih: Gjuhët zyrtare të BE-së, https://europa.eu/european-union/about-eu/eu-languages). Në fillim të themelimit kishte vetëm gjashtë vende anëtare: Franca, Gjermania, Italia, Belgjika, Luksemburgu dhe Holanda; si dhe katër gjuhë zyrtare: frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja dhe holandishtja. Në shikim të parë numri i madh i gjuhëve zyrtare është problematik për t'u zbatuar. Nga askush, as nga politikanët e as nga nëpunësit e BE-së, nuk mund të pritet që t'i zotërojnë të gjitha gjuhët zyrtare. Ka dekada që kjo gjendje kritikohet, prandaj nga studiues të njohur, sociolinguistë të shquar janë bërë propozime të ndryshme se si mund të zgjidhet ky problem, mbase duke reduktuar këtë numër të madh të gjuhëve. Çështja e gjuhëve zyrtare, me gjithë kritikat dhe propozimet e shumta, kurrë nuk është hapur brenda BE-së. Kjo mbetet një temë tepër e ndjeshme edhe pse ka shembuj të tjerë, se si organizata më të mëdha ndërkombëtare e kanë zgjidhur këtë çështje. Për shembull OKB-ja me 193 shtete anëtare ka vetëm gjashtë gjuhë zyrtare: anglishten, arabishten, frëngjishten, kinezishten, rusishten dhe spanjishten. Edhe OSCE me 57 vende anëtare përdor gjashtë gjuhë zyrtare: anglishten, frëngjishten, gjermanishten, italishten, rusishten dhe spanjishten.

Fusha e dytë ka të bëjë me faktin se BE-ja mbështet mbrojtjen e gjuhëve të pakicave. Shumica e shteteve anëtare, por jo të gjitha (krh. Warasin, M. 2002, f. 59-60), e kanë nënshkruar Kartën Europiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (European Charter for Regional or Minority Languages) e cila u miratua nga Këshilli i Europës në vitin 1992. Me nënshkrimin e kësaj karte shtetet anëtare detyrohen të vendosin standarde të caktuara minimale të njohjes dhe mbështetjes së atyre gjuhëve, si dhe të zbatojnë me dhjetëra masa mbrojtëse, që parashihen në këtë kartë (Council of Europe, https://(www.coe.int/en/web/european-charter-regional-or-minority-languages (21. 12. 2019).

Masat kanë të bëjnë së pari me fushën e arsimit, mediet dhe institucionet e ndryshme shtetërore. Ka pasur edhe një zyrë europiane për pakicat gjuhësore (European Bureau for Lesser-Used Languages–EBLUL) themeluar në vitin 1982 si organizatë joshtetërore, me qendër në Dublin, por është mbyllur që në vitin 2010.

Gjuhët rajonale apo minoritare në BE (mbi 60 të tilla) ndahen në pesë kategori: 1. Gjuhët që në të vërtetë janë gjuhë nacionale të vendeve anëtare të BE-së, por nuk janë gjuhë zyrtare të saj. Këtu bëjnë pjesë irlandishtja dhe luksemburgishtja; 2. Gjuhët që lidhen me një rajon, p. sh.: bretonishtja në Bretanjë të Francës, ose galishtja në Britani të Madhe; 3. Gjuhët e pakicave që gjenden në dy apo më shumë shtete të BE-së, si baskishtja në Spanjë dhe Francë, laponishtja (Sámi) në Finlandë dhe Suedi, ose oksitanishtja në Francë, Itali dhe Spanjë; 4. Gjuhët që fliten nga një pakicë në një vend anëtar të BE-së, por në një shtet tjetër fqinj janë gjuhë zyrtare, si p. sh. hungarishtja në

Sllovaki, danishtja në Gjermani, gjermanishtja në Belgjikë dhe Itali; 5) Gjuhë që nuk janë të lidhura me një territor, që fliten në disa shtete, si p. sh.: jidishtja, gjuhët sinti dhe romishtja (krh. Warasin, M. 2002, f. 54).

Masat për mbështetjen dhe mbrojtjen e pakicave në fushë të gjuhës janë qenësore. Gjuha është faktori kryesor i ekzistencës së një komuniteti gjuhësor dhe pjesë përbërëse e identitetit etnik. Në mbarë Europën, në funksion të mbështetjes dhe mbrojtjes së diversitetit gjuhësor europian që nga viti 2001, për çdo vit, më 26 shtator festohet Dita Europiane e Gjuhëve (shih më shumë për këtë në: *Europa mbështet shumëgjuhësinë* - https://dialogplus.ch/europa-mbeshtet-shumegjuhesine-133834 (26. 09. 2019).

Fusha e tretë përfshin mbështetjen e shumëgjuhësisë së qytetarëve të BE-së. Dallon programi zyrtar i mësimit të plus dy gjuhëve të tjera, përveç gjuhës amtare. Kjo nënkupton se çdo qytetar i BE-së, përveç gjuhës së tij amtare, duhet të mësojë edhe dy gjuhë të tjera. Ky program realizohet nëpërmjet sistemit arsimor shtetëror të të gjitha vendeve anëtare. Nuk janë përcaktuar se cilat nga të dy gjuhët e huaja duhet të mësohen, por qëllimi është që ato të mos jenë patjetër gjuhët me prestigj më të lartë, gjuhët "e mëdha" si anglishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja, por çdo qytetar duhet të përcaktojë vetë se cilat gjuhë do t'i mësojë dhe planifikojë se ku dhe kur do t'i duhen në jetë (shih më gjerësisht: The European Language Portfolio (ELP), https://www.coe.int/en/web/portfolio; KUADRI EUROPIAN I PËRBASHKËT I REFERENCËS PËR GJUHËT, https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/2018-KUADRI-I-PERBASHKET-EUROPIAN- pdf

(22. 11. 2019).

Në sistemin arsimor të shteteve të BE-së është bërë rregull zotërimi i dy gjuhëve të huaja krahas gjuhës amtare. Në vazhdën e globalizimit, do të përfshihen këtu edhe gjuhë të tjera joeuropiane si kinezishtja dhe arabishtja.

Me anë të programeve për shkëmbim akademik si *Erasmus, Erasmus +,* si dhe programeve për të rinj si *Leonardo da Vinci*, mbështetet zotërimi i gjuhëve dhe kompetencave ndërkulturore (https://eacea.ec.europa.eu/erasmus-plus/; https://www.eu-foerdermittel.eu/aktionsprogramme/; https://eacea.ec.europa.eu/sites/2007-2013/llp/leonardo-da-vinci-programme_en (28. 11. 2019).

Këshilli i Europës me seli në Strasburg, mbështet diversitetin gjuhësor dhe mësimin e gjuhëve në fushën e arsimit. Krahas Strasburgut, ku zhvillohen kryesisht politikat e përgjithshme gjuhësore europiane dhe politikat gjuhësore për gjuhët rajonale dhe pakicat, Këshilli i Europës ka edhe një seli në Grac të Austrisë. Këtu është qendra që merret kryesisht me politikën e mësimit modern të gjuhës e cila ka emrin ECML – European Centre for Modern Languages of the Council of Europe (https://www.ecml.at/). Kjo qendër mbështet shumëgjuhësinë dhe shumëkulturalitetin për qytetarët e Europës. ECML në Grac dhe dega tjetër në Strasburg, përpiqen të arrijnë politikat gjuhësore europiane në fushën e arsimit si në vijim: shumëgjuhësinë për gjithë europianët, barazi dhe mbështetje për shumëllojshmërinë gjuhësore, mirëkuptimin e ndërsjellë duke marrë parasysh dallimet kulturore, të drejta qytetare demokratike në shoqëritë shumëgjuhëshe dhe bashkëveprimin social me vështrim të posaçëm të barazisë së përgjithshme sociale (krh. Council of Europe Language Education Policy, 2006, f. 6). Për të mbështetur mobilitetin dhe mirëkuptimin ndërkulturor, ku mësimi i gjuhëve është një përparësi e rëndësishme, BE financon një varg programesh dhe

projektesh, pasi BE-ja e sheh shumëgjuhësinë si një element vendimtar të aftësisë konkurruese të Europës.

Politika gjuhësore zyrtare e BE-së parasheh që Komisioni Europian në kontakt me qytetarët e shteteve anëtare, të gjitha pyetjeve t'u përgjigjet në gjuhën në të cilën janë hartuar, me kusht që ajo të jetë njëra prej gjuhëve zyrtare. Ky diversitet gjuhësor kërkon një shërbim tepër voluminoz të gjuhëve. SCIC- Service Commun Interpretation Conferences (Servisi i Përgjithshëm për Interpretimin e Konferencave) është shërbimi më i madh botëror i përkthimeve. Në të gjithë gjuhët zyrtare të BE-së përkthehet vetëm gjatë takimeve në nivel kryeministrash e ministrash, si dhe për hartimin e dokumenteve zyrtare në Parlamentin Europian. Për çështje të efikasitetit dhe funksionalitetit në BE-së përdorin modelin e gjuhëve zyrtare dhe modelin e gjuhëve të punës. Vetëm anglishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja kanë statusin e gjuhës së punës në BE, megjithëse shquhet gjithmonë dominimi i përdorimit të anglishtes. Detyra e shërbimeve të përkthimit dhe interpretimit të BE-së është të mbështetet shumëgjuhësia në mbarë Bashkimin Europian dhe qytetarët të njihen më mirë me politikat e BE-së. Sfida është që të përmirësohet edhe cilësia e arsimimit të përkthyesve si dhe motivimi i përkthyesve të kualifikuar që të ushtrojnë këtë profesion në BE, si dhe të ndihmohet në përmirësimin e namit të këtij zanati.

Për domosdoshmërinë dhe sfidat e përkthimit, shih më shumë te botimet e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve..., Shkup: "*Kumtesa mbi sfidat e përkthimit*" dhe në faqen e saj të internetit: https://www.facebook.com/apjazgj/posts/711530312642539?__tn__=K-R (30. 09. 2019).

Politika terminologjike e BE-së është e lidhur ngushtë me politikën gjuhësore të saj. BE-ja të gjitha ligjet i harton si tekste origjinale në të gjitha gjuhët zyrtare, dhe gjatë kësaj duhet të sigurojë harmonizim të terminologjisë në të gjitha gjuhët. Ky fenomen, gjatë të cilit tekstet në gjuhë të ndryshme duhet të vlejnë si autentike dhe njëkohësisht janë versione juridikisht të detyrueshme, quhet si "parim i bashkëredaktimit" (princip of coredactur). Sipas këtij parimi del detyrimi i qëllimshëm i politikës terminologjike të BE-së për një krijim, zbatim dhe ruajtje të një terminologjie të harmonizuar të përbashkët juridike. Vetëm nëpërmjet kësaj do sigurohet ekuivalenca funksionale terminologjike në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së, dhe me këtë do të garantohet zbatimi i së drejtës së BE-së.

Qëllimi është që të arrihet hartimi paralel i teksteve në të gjitha gjuhët, të cilat nuk do të përkthehen nga një tekst origjinal vetëm në një gjuhë, por do të hartohen të gjitha në mënyrë autonome në çdo gjuhë. Politika terminologjike e BE-së ka ngritur disa institucione për zhvillim, normim dhe administrim të terminologjisë. Më gjerësisht shih në: The Terminology Coordination Unit of the European Parliament (TermCoord),dhe Infoterm, the International Information Centre for Terminology, http://www.infoterm.info/,

(28. 11. 2019).

"Politika" në një gjuhë të kuptueshme - si të shprehemi "politikisht"

Është e drejtë e qytetarëve të kuptojnë dhe të jenë pjesë e veprimit dhe vendimit politik. Për të hulumtuar interesin e të rinjve për politikën, për faktin se si komunikojnë

politikanët midis tyre dhe me votuesin, është zhvilluar një anketë në gjithë Gjermaninë me mbi 30.000 të rinj të moshës 16-19 vjeçare. Ata iu përgjigjën pyetjeve se si duhet të jetë gjuha e politikanëve dhe institucioneve politike, që qytetarëve të rinj do t'u mundësojë kuptimin e përmbajtjes dhe do të nxitë debatin për temat politike nga të gjithë qytetarët. Nga të rinjtë u dhanë rekomandimet në vijim:

- zëvendësimi i fjalëve të huaja me fjalë më të kuptueshme;
- gjuha profesionale të përdoret vetëm në qarqe profesionistësh;
- fjalët e zbukuruara artistike të zëvendësohen me të dhëna konkrete bindëse;
- flluskat retorike të zëvendësohen me deklarata të përgjegjshme;
- formulimi i fjalive të shkurtra e domethënëse, pa ndërlikime e stërzgjatje, etj.

(krh. rezultatet e këtij hulumtimi në: Studie "*Sprichst Du Politik*" 2011: http://www.sprichst-du-politik.de/downloads/sprichst-du-politik_Studie.pdf, 22. 11. 2019).

Shtetet e Europës e shohin si detyrë të tyren që të mbështesin gjuhën. Vendimet e politikës gjuhësore përcaktohen përmes rregullimit ligjor dhe zbatohen përmes ngritjes e themelimit të institucioneve përkatëse shtetërore: agjencive, inspektorateve, këshillave të ndryshëm, komisioneve etj.

Në disa shtete të Europës ka ligje për mbrojtjen e gjuhës, si në Belgjikë, Estoni, Finlandë, Francë, Hungari, Irlandë, Lituani, Letoni, Maqedoni, Norvegji, Poloni, Rumuni dhe Sllovaki, por jo në shtete të tilla si Spanja dhe Zvicra, që njihen për një numër të madh gjuhësh dhe etnish. Ligji francez për mbrojtjen e gjuhës, nga viti 1994 kufizon përdorimin, si publik ashtu edhe privat, të fjalëve të huaja, para së gjithash të anglicizmave, si dhe të teksteve anglisht në fushën e reklamës. Edhe ligji hungarez për mbrojtjen e gjuhës, miratuar më 2001, rregullon publikimet e reklamave dhe mbishkrimet, si dhe botimet me interes publik. Ligji detyron të gjitha sipërmarrjet, që reklamat, logot dhe informacionet e firmave të përkthehen në hungarisht, përveç markave të njohura ndërkombëtare dhe sloganeve të tyre të mbrojtura. Edhe në Rumani, firmat e huaja sipas ligjit, që nga viti 2003, duhet të përkthejnë në rumanisht, tekstet e reklamave dhe terminologjinë profesionale. Atje duhet të përkthehen edhe fjalë të tilla si: *Big Mac, Hamburger, Laptop* etj. Në Finlandë nga viti 2003 ka një ligj të ri për gjuhën, i cili bazohet në tri shtylla: 1. Është e drejta e çdo qytetari të zgjedhë gjuhën e tij amtare (përherë vetëm një); 2. Ndarja e Finlandës në rajone (bashki dhe qytete). Në çdo komunë, për çdo dhjetë vjet, përmes regjistrimit të popullsisë dihet se a do të jetë komunë njëgjuhëshe finlandisht, njëgjuhëshe suedisht, ose dygjuhëshe, me shumicë finlandeze apo suedeze. 3. Ka rregullore të detajuara për njohjen dhe nivelin e zotërimit të gjuhëve, që kërkohen të dihen prej nëpunësve shtetërorë.

* Poshtëshënimet janë hequr për shkak të natyrës së doracakut.

Xhevat Lloshi

4. LEKSIKU SHOQËROR E POLITIK

Të gjitha grupet leksikore mund të dalin në këtë fushë, madje edhe terminologjia speciale, kur e kërkon tematika. Veçantinë e përbën shtresa e leksikut shoqëror-politik. Ai ka disa karakteristika si të përbërjes, edhe të përdorimit. Kjo është shtresa, që lidhet më drejtpërdrejt me gjendjen shoqërore të një etape të caktuar, që pasqyron strukturën e shoqërisë, si dhe shtresimin e saj politik. Rrymat politike, grupimet shoqërore dhe ideologjike, marrëdhëniet ekonomike-shoqërore gjejnë shprehje edhe në përbërjen e leksikut, deri edhe vlerat e përdorimit të fjalëve të caktuara shpërndahen sipas këtyre grupimeve. Nga ana tjetër, është e padrejtë që të përfshihen këtu termat e shkencave shoqërore, që janë pronë e specialistëve. Vetëm kur, p. sh., depërton në politikë një term i filozofisë, ai e humb karakteristikën speciale dhe hyn në këtë përdorim të përgjithshëm. Është domethënëse fjala *punëtor.* Ajo ka qenë emërtim profesioni madje edhe në frëngjishten vetëm nga viti 1869 kaloi si term shoqëror-politik. Te ne në fund të viteve 1920, bashkë me *punëtoria,* nisi të merrte kuptim shoqëror dhe me Luftën e Dytë Botërore u bë term politik, por pas vitit 1990 me shpejtësi po e bjerr këtë kuptim, madje ndarja në dy kuptime e Fjalorit të vitit 1980, tashmë tingëllon jo vetëm e vjetruar, por edhe qesharake.

Nga pikëpamja tematike fondi kryesor i leksikut shoqëror-politik përfshin grupet, si:

- emërtimet për organizimin, veprimtaritë edhe jetën e partive politike e të organizatave shoqërore, si: *plenum, komitet drejtues, kongres, kuotë anëtarësie, forum, konferencë shtypi, mbledhje organizative.*

- fjalët përcaktuese të rrymave ideopolitike, që përbëjnë edhe bërthamën dalluese të tyre, si: *diktatura e proletariatit, revolucioni socialist, lufta e klasave, kooperimi* etj. për ideologjinë komuniste: *shteti ligjor, ekonomia e tregut, të drejtat e njeriut, bota e lirë, pluralizmi, privatizimi* etj. për shoqërinë paskomuniste.

- leksiku i strukturës dhe i rendeve shoqërore-ekonomike: *klasë, borgjezi, proletariat, fshatarësi, rinia, kapitalizmi, superstruktura, imperializëm republikan, demokraci, diktaturë, anarkizëm, periudhat e tranzicionit, emulacion socialist, aksionist, novator.*

- leksiku i fushatave elektorale dhe i jetës politike parlamentare: *e majta, e djathta, opozita, pozita, konsensusi, pakti social, kandidati për deputet.*

- fjalë për luftën shoqërore e politike: *revolucion, grevë, aksion, bojkotim.*

- leksiku për dukuritë shoqërore-politike: *korrupsion, nepotizëm, liberalizëm, tarafllëk, destabilizim.*

- leksiku nga fushat e tjera që futet në përdorim politik. Si shembull tërheq vëmendje fjala *plan.* Gjatë regjimit komunist ajo shndërrohet në fjalë politike nëpërmjet togut *plani i shtetit,* për shkak të identifikimit të vetëdijshëm të tij me orientimet politike, që i jepte një kongres partie dhe sepse realisht mishëronte një politikë e jo aq nevojat ekonomike. Që këtej u bë e mundur të thuhej: *plan mobilizues, plani i ardhshëm, e tejkaloj planin.* Me rënien e regjimit togje të tilla bien menjëherë nga përdorimi. Po kështu ka ndodhur me *pushtet* pasi ka marrë kuptimin e togut *pushteti popullor* dhe fitoi aftësinë për të hyrë në lidhje, si: *zyrat e pushtetit, lidhjet e pushtetit me popullin, armiqtë e pushtetit, na ndihmoi pushteti.*

Duke përmendur parimin drejtues, do të vëmë në dukje se një pjesë e mirë e këtij fondi përbëhet nga togfjalësha: *partneriteti për paqe, aksion me goditje të përqendruara, reformat demokratike, të përndjekurit politikë, mbështetja në forcat e veta, bashkekzistenca paqësore, refugjat politik, bota e tretë, lufta e ftohtë.*

Ky leksik ka veçantinë e tij si sistem shkrimi. Këtu nuk është kurdoherë e domosdoshme, që sendet e dukuritë të emërtohen ne mënyre analitike dhe me terma të rreptë. Mjaftojnë edhe disa tregues të përgjithshëm, duke iu referuar nocioneve më të gjera, që shoqërohen me elementin bartës të qëndrimit, domethënë një fjalë me vëllim të gjerë kuptimor e shoqëruar me diçka vlerësuese.

Për çdo rrymë ose shoqëri veçohet një grup nocionesh që janë themelore për të, këto përbëjnë fjalët kyç për një politikë ose drejtim shoqëror. Fjalët e togjet kyç shndërrohen në simbole të një botëkuptimi ose mendësie, madje rreth tyre përqendrohet lufta politike. Nga ana tjetër, ndeshjet me armë dhe ndeshjet politike-shoqërore shpesh shoqërohen edhe nga ndeshja me fjalë. Vërehen këto zgjidhje të mundshme: e para, rrymat kundërshtare e përjashtojnë një nocion bashkë me mjetet përkatëse të gjuhës, p. sh. "raca ariane'' nuk pranohet nga kundërshtarët e nazizmit. E dyta, për të njëjtën dukuri ndërtohen paralelisht mjete të ndryshme gjuhësore.

Ndikimi i gjuhës shoqërore e politike shpjegohet me gjerësinë e depërtimit të saj. Këtu, për shkak të një përdorimi të jashtëzakonshëm nga përmasat e gjuhës së shkruar e të folur, aktualizohet më shpejt dhe me intensitet më të madh çdo dukuri gjuhësore; aktualiteti i përmbajtjes shndërrohet në aktualitet gjuhësor. Bashkë me këtë dalin në mënyrë të zmadhuar të metat, që e shoqërojnë detyrimisht parimin stilistik të ndërtimit të teksteve. Stereotipat, frazeologjia karakteristike dhe ndërtimet me blloqe të parafabrikuara kanë shkaktuar konotacion negativ, që bart nganjëherë thënien "gjuhë gazete''. Prirja që e kemi theksuar tashmë për t'u afruar me gjuhën e përditshme, bashkë me rënien e censurës dhe të pasojave të saj në ngurtësinë e shprehjes së mendimeve, kanë sjellë një përsëritje të gjuhës së shtypit. Megjithatë shablonet e kësaj gjuhe vijojnë të ndihen sidomos në shkollë, duke dëmtuar nocionin për vlerat artistike të shprehjes.

Të metat e tjera lidhen me rënien e kulturës qytetare dhe gjuhësore në një pjesë të shtypit e të veprimtarive politike, domethënë janë diçka e jashtme për vetë stilin. Ndikimi i hapur nga jeta politike e shoqërore e vendeve të tjera është gjithashtu i dyanshëm; nga njëra anë, i ka zgjeruar mundësitë për të përfituar nga mjeshtëria e të shkuarit, por nga ana tjetër ka sjellë një vërshim të panevojshëm të huazimeve. Përgjegjësia e kësaj fushe është shumë e madhe për kulturën gjuhësore në përgjithësi të kombit dhe, nuk ka dyshim, edhe në këtë fushë do të kapërcehet tranzicioni për të vijuar në traditën e kulturës e të lëvrimit të fjalës publike, që nuk mungon edhe për shqipen.

Xhemi Hajredini

5. KOMUNIKIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE ME QYTETARËT

Akti i komunikimit ka një aspekt të përmbajtjes dhe një të marrëdhënies. Gjatë një komunikimi me qytetarët, me mediet, me organizmat shtetërorë a shoqërorë nuk mjafton vetëm përkufizimi i përmbajtjes dhe shkëmbimit të informacionit, por edhe përkufizimi i marrëdhënieve me qytetarët dhe institucionet. Për një institucion shtetëror është shumë me rëndësi kultura organizative. Komunikimi, institucional dhe ndërinstitucional, nëse është i hapur dhe i drejtpërdrejtë do të mbajë të informuar vazhdimisht qytetarin. Ky lloj bashkëbisedimi dhe kjo vëmendje ndaj tij krijon kushte për një komunikim shumë të thjeshtë.

Që nga miratimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe themelimi i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve, përkatësisht me përdorimin e gjuhës shqipe dhe Ligjit për Inspektoratin e Përdorimit të Gjuhëve në Maqedoninë e Veriut, është bërë detyrim i çdo qytetari shqipfolës, punonjës në ndonjë institucion qendror apo lokal, ta zotërojë mirë gjuhën amtare dhe t'i njohë rregullat e drejtshkrimit.

Komunikimi verbal, e veçanërisht ai me shkrim, i një nëpunësi administrativ, është pasqyra e institucionit.

Auditorët e synuar të komunikimit publik të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës janë:

- institucionet publike shtetërore,
- zyrtarët e institucioneve qendrore dhe lokale,
- administrata publike qendrore dhe lokale,
- mjetet e informimit,
- shoqëria civile,
- qytetarët.

Gjithsecili ka të drejtë të informohet, pa kurrfarë kufizimesh, në përputhje me "Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut".

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës Shqipe i ka marrë të gjitha masat për një komunikim të ngushtë ndërinstitucional dhe komunikim të vazhdueshëm me qytetarët për të vënë në vendin e duhur përdorimin edhe zbatimin e ligjit për përdorimin e drejtë të gjuhëve.

Secili institucion ka detyrim dhe përgjegjësi ligjore për të zbatuar barazinë gjuhësore. Të gjitha organet shtetërore dhe lokale duhet të synojnë aftësimin dhe trajnimin e nëpunësve administrativë, duke ndërtuar një strukturë funksionale për zbatimin korrekt të rregullave ligjore dhe gjuhësore.

Nëse çdo institucion, nëpërmjet burimeve njerëzore të specializuara, përvetëson teknikat e të shkruarit institucional, krijon dosje të sistemuar të dokumenteve, formularëve dhe akteve të tjera në të dyja gjuhët zyrtare, do të kishim një komunikim profesional efektiv. Kjo punë e sistemuar e komunikimit të vazhdueshëm publik do të krijonte rregulla, të cilat do t'u ndihmonin hartuesve të teksteve, zëdhënësve apo përgjegjësve të ardhshëm të institucioneve.

Gjatë komunikimit me qytetarët, që mesazhi të kuptohet lehtësisht, gjuha e

përdorur nga institucionet duhet të jetë e kuptueshme, e qartë dhe e thjeshtë. Edhe gjatë komunikimit ndërinstitucional shkresat duhet të jenë të qarta, pa ngarkesa dhe pa shprehje metaforike. Zakonisht aktet bazohen në ligje dhe rregullore dhe si të tilla nuk duhet të ndërlikohen dhe të ngarkohen me shprehje letrare.

Asnjë shkresë, asnjë akt i përgatitur nga një institucion nuk duhet të ngjallë hamendësime dhe mëdyshje. Ky komunikim njerëzor e zyrtar, me rregullat e lartpërmendura, duhet të zbatohet edhe nga nëpunësit nëpër sportelet e të gjitha institucioneve, pa paragjykime nëse duhet të përdorin njërën apo tjetrën gjuhë.

Qëllimi i organeve shtetërore dhe lokale duhet të jetë shërbimi efikas i qytetarëve. Në asnjë mënyrë nuk duhet krijuar distancë gjatë shërbimeve dhe komunikimit publik.

Të shkruarit dhe të komunikuarit institucional nënkupton një komunikim të pagabueshëm, të qartë, pa fjalë të huaja e të pakuptueshme, pa zhargone. Të gjithë duhet të përdorin gjuhën standarde. Të gjitha institucionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut e kanë për detyrë t'i përgjigjen qytetarit në gjuhët zyrtare, që tanimë dihet se janë gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe. Ky komunikim me qytetarët mund të bëhet edhe nëpërmjet ueb-faqeve ku të gjitha informacionet kërkohet të jenë në të dyja gjuhët zyrtare.

Institucionet e pushtetit lokal kanë një përparësi nga ato të pushtetit qendror pasi prej disa vitesh me radhë kanë zbatuar dygjuhësinë dhe telashet gjuhësore pothuajse i kanë tejkaluar. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se komunat dhe ndërmarrjet publike komunale nuk duhet t'i përditësojnë informacionet e tyre, duke i ndrequr gabimet dhe të metat gjuhësore.

Komunikimi ndërinstitucional sipas hierarkisë nevojitet të jetë i qartë dhe i vazhdueshëm, duke respektuar gjithsecili përgjegjësinë dhe detyrimet e gjithsecilit. Ftesat zyrtare, materialet e ndryshme, njoftimet, formularët, konferencat për shtyp, interpretimet simultane duhet të jenë në harmoni me ligjin, pra të respektohet dygjuhësia, përkatësisht zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në RMV. Kultura e shërbimit publik është parësore për çdo institucion. Që nëpunësit administrativë, mediet e të tjerë, të jenë të përgatitur dhe të aftë për komunikim ndërinstitucional dhe komunikim me qytetarët, me shkrim apo me gojë, lypsen trajnime të vazhdueshme për t'u formuar si njohës të mirë të drejtshkrimit dhe të folurit qartë e bukur. Vetëm nëpërmjet këtyre burimeve të formuara njerëzore, institucionet kundruall publikut do të ishin më të hapura dhe sigurisht më të respektuara.

Komunikimi dhe informimi duhet të bëhet nga ekspertët e gjuhës dhe të ligjit. Të parët janë për t'i mënjanuar gabimet drejtshkrimore dhe përmbajtjesore, ndërkaq të dytët për t'i korrigjuar dhe hartuar sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në RMV.

Proceduarat më të rëndësishme, si në çdo institucion edhe tek Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, janë marrja, përpunimi dhe dhënia e informacionit. Klima e komunikimit mbështetet në dy dimensione: komunikimi i brendshëm dhe ai i jashtëm. I pari nënkupton komunikim mes drejtorive dhe institucioneve të ndryshme dhe i dyti është përcjellja e mesazhit tek opinioni publik.

Komunikimi ndërinstitucional dhe komunikimi me publikun nga institucionet bëhet në mënyra të ndryshme. Disa shembuj përfshijnë deklaratat dhe konferencat për

shtypin, për mediet sociale, nëpërmjet telefonit, memorandumeve dhe letrave, postës së evidentuar dhe e-maileve. Po ashtu materialet informuese, fletëpalosjet, broshurat, doracakët, fletushkat, ftesat për propozime, njoftimet dhe ueb-faqet, kërkohet të jenë të shkruara dhe të publikuara në gjuhët zyrtare.

Përgjegjësia institucionale për komunikimin ndërinstitucional dhe për komunikimin me publikun

- Institucionet janë përgjegjëse për të siguruar respektimin e barazisë gjuhësore.
- Institucioni është përgjegjës për përkthimin e të gjitha dokumenteve institucionale, në gjuhët zyrtare (p. sh. raportet, formularët e vlerësimit, kërkesat dhe materialet e tjera të punës etj.). Institucioni është përgjegjës për të ofruar informacionin në gjuhët zyrtare dhe shpërndarjen e tij në të njëjtën kohë.
- Komunikimi ndërinstitucional duhet të bëhet në gjuhët zyrtare. Të gjitha shkresat, kërkesat apo ankesat gjatë komunikimit ndërinstitucional duhet të jenë në gjuhët zyrtare. Institucionet duhet të përgjigjen në gjuhën në të cilën është shkruar letra, kërkesa apo ankesa përkatëse.
- Shpalljet e vendeve të lira të punës, njoftimet e tjera dhe ftesat për propozime është e detyrueshme të publikohen në gjuhët zyrtare. Tërë informacioni shpjegues duhet të ofrohet dhe publikohet në gjuhët zyrtare.
- Ueb-faqet e institucioneve duhet të jenë në gjuhët zyrtare. Përmbajtja dhe përditësimi i tyre duhet të bazohet në trajtimin e barabartë të gjuhëve zyrtare.
- Në nivel lokal, institucionet janë të detyruara të publikojnë informacione në gjuhët zyrtare të komunës. Ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbime të ndryshme për qytetarët nevojitet të përmbushin këtë detyrim.
- Institucionet publike kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha informatat t'i paraqiten dhe t'i komunikohen publikut në gjuhët zyrtare.
- Ftesat për mediet dhe deklaratat për shtypin duhet të dërgohen dhe të publikohen në gjuhët zyrtare.
- Gjatë konferencave, institucionet duhet t'i ofrojnë auditorit dhe gazetarëve interpretim simultan apo konsekutiv.
- Gjatë tryezave të rrumbullakëta dhe punëtorive duhet të ofrohet interpretim simultan ose konsekutiv (varësisht nga grupi).
- Gjatë konferencave të shtypit duhet të ofrohet interpretim simultan për gazetarët.
- Përmbajtjet për mediet e shtypura, virtuale dhe ato transmetuese (tv dhe radio), duhet të jenë në gjuhët zyrtare.
- Materialet informuese, fletëpalosjet, broshurat, doracakët, fletushkat, ftesat për

propozime, njoftimet dhe ueb-faqet e arrijnë qëllimin kur janë të shkruara dhe të publikuara në gjuhët zyrtare.

Përgjegjësia institucionale

- Institucionet publike janë përgjegjëse për të siguruar zbatimin e barazisë gjuhësore.
- Institucionet publike janë të detyruara të sigurojnë që të gjitha informatat e ofruara dhe të shpallura për publikun, të jenë në gjuhët zyrtare.
- Institucionet janë përgjegjëse për të ofruar informata ndërinstitucionale në gjuhët zyrtare dhe për t'i shpërndarë ato në të njëjtën kohë.
- Institucioni është përgjegjës për përkthimin e të gjitha dokumenteve gjatë procedurës së planifikimit, rekrutimit dhe përzgjedhjes, në mënyrë që ato të jenë në dispozicion që nga faza e hershme.
- Atëherë kur është e nevojshme, institucionet janë përgjegjëse për sigurimin e disponueshmërisë së interpretimit simultan në gjuhët zyrtare.

Sa i përket komunikimit me qytetarët dhe për t'i pasqyruar më së miri objektivat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (gjuhëve), do të praktikohet botimi i broshurave informuese ose botime periodike (mujore ose tremujore) sipas tematikave që ngjallin debat dhe interes në publik. Gjatë këtij komunikimi të jashtëm, sidomos në botimet periodike, sigurisht një vend të merituar do të zënë shkrimet dhe rekomandimet e njohësve të mirë të gjuhëve, profesorëve, juristëve, ekonomistëve dhe të gjithë atyre që merren me rolin e komunikimit publik.

Një ndihmesë tjetër për komunikimin me qytetarët dhe shoqërinë civile do të kishin qenë punëtoritë dhe seminaret. Qëllimet e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës janë vetëm ligjore dhe gjuhësore. Sa më mirë t'i njohim rregullat drejtshkrimore, sa më mirë ta njohim Ligjin për Zbatimin e Gjuhëve dhe, në fund, sa më transparentë të jemi përballë institucioneve të tjera dhe qytetarëve, aq më lehtë do të arrihen synimet e Agjencisë.

Faqja zyrtare dhe takimet e drejtpërdrejta me qytetarët janë mundësi të tjera për të komunikuar dhe për të promovuar një imazh të mirë dhe transparent të Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Si te faqja zyrtare, ashtu edhe te takimet e drejtpërdrejta, do të përhapej përvoja e shteteve të zhvilluara, ku në përdorim zyrtar janë dy a më shumë gjuhë.

Informacioni i duhur në dispozicion të publikut, ky është qëllimi kryesor i Agjencisë. Vendosja e dialogut të vërtetë mes administratës, autoriteteve dhe institucioneve. Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve, si institucion i ri në vend, do t'i ndërmarrë të gjitha masat, përfshirë edhe fushatat informuese, që Ligji për Përdorimin e Gjuhës të respektohet, pa mëdyshje, nga të gjitha institucionet e vendit. Komunikimi nuk duhet të jetë refuzues.

Misioni i komunikimit ndërinstitucional dhe komunikimit me qytetarët është ndërgjegjësimi i të gjithëve për t'iu shmangur komunikimit me ngjyrim politik dhe për

të respektuar ligjet e miratuara.

Një tjetër mision është dëshira për të ndryshuar sjelljen kolektive të qytetarëve përballë diversitetit gjuhësor.

Në fund, komunikimi i vazhdueshëm i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës ka për qëllim informimin dhe promovimin e shërbimeve dhe misionin e saj në rrethanat e reja të vendit.

PJESA E DYTË

Ajten Hajdari–Qamili / Asllan Hamiti / Bashkim Selmani / Ismail Hamiti

1. KOMUNIKIMI SHKRIMOR-ADMINISTRATIV

Duke krijuar një proces të qartë, procedurat administrative sqarojnë dhe mbrojnë të drejtat e të gjithë qytetarëve nga veprimet e ndërmarra nga institucionet. Ato rregullojnë procedurat administrative dhe ofrimin e shërbimeve efektive të administratës publike për të gjithë qytetarët, pa diskriminim. Këto ligje krijojnë bazën për transparencë, llogaridhënie dhe konsistencë të veprimeve administrative, duke zbatuar procedura të barabarta në raport me përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të kryhen dhe komunikohen qartë procedurat administrative në lidhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në mënyrë që ato të mund të kontribuojnë në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shumicë që jetojnë në RMV.

Përgjegjësitë për temat/fushat specifike

- Procedurat administrative duhet të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe objektive për pjesëtarët e komuniteteve mbi 20% dhe t'u kumtohen atyre në gjuhët zyrtare. Kjo duhet të përfshijë komunikimin verbal dhe me shkrim të procedurave administrative në gjuhët zyrtare, në mënyrë që veprimet procedurale të ndërmarra dhe/ose të kërkuara të kuptohen nga pjesëtarët e komuniteteve shumicë në vend.

- Procedurat administrative duhet të zbatohen në lidhje me parimet e publicitetit dhe transparencës, sipas të cilave pjesëtarët e komuniteteve mbi 20% duhet të kenë mundësi të marrin informacionin e nevojshëm në gjuhët zyrtare, në përputhje me të drejtat e tyre kushtetuese dhe Ligjin për Qasje në Dokumentet me Karakter Publik . Të dhënat publike duhet të ruhen në gjuhët zyrtare, në mënyrë që të gjithë pjesëtarët e komuniteteve të mund t'u qasen atyre.
- Të gjitha fazat e procedurës administrative, duke përfshirë njoftimin e veprimeve administrative, nxjerrjen e aktit administrativ, mjetet për ankesë administrative dhe mosmarrëveshjet duhet të komunikohen në mënyrë të qartë në gjuhët zyrtare, pa bërë dallim mes anëtarëve të komunitetit. Duhet të sigurohet përkthim cilësor pa kompromet uar qartësinë ligjore dhe shpërndarjen në kohë të vendimit.
- Format e aplikimit, regjistrimit dhe/ose ankesës duhet të jenë në dispozicion në gjuhët zyrtare. Pjesëtarët e të gjitha komuniteteve do të mund t'i plotësojnë ato dhe të marrin përgjigje në gjuhët zyrtare për të kuptuar zhvillimin e procedurave dhe veprimeve të nevojshme procedurale.

Si duhet të shkruhen dokumentet shtetërore?

Dokumentet shtetërore, duke filluar nga kushtetuta, ligjet, rregulloret, statutet, vendimet, lutjet, kërkesat, ankesat, procesverbalet, raportet e deri te formularët më të thjeshtë postarë, shkruhen në stilin shtetëror-administrativ. Ka disa lloje tekstesh që shkruhen në këtë stil: *tekste ligjore* (ligj, vendim, urdhëresë, udhëzim, rregullore); *shkresa* (vërtetim, deklaratë, autorizim, kërkesë, përgjigje, fletë qarkore, letër administrative, procesverbal); *akte ekonomike-tregtare* (kontratë, marrëveshje, raport); *formularët; aktet diplomatike* (notë, letër, mesazh, protestë, peticion) etj.

Kërkesë e këtij stili është që paraqitja gjuhësore duhet të bëhet jo vetëm me përpikëri, por edhe të përfshijë të gjitha rastet e mundshme, imtësitë e rrethanat, me qëllim që të mos marrin interpretim të gabuar. Tekstet ligjore shkruhen duke u kujdesur më shumë që të mos keqkuptohen, sesa që të kuptohen. Po kështu, synohet që tekstet të mos ndryshohen brenda periudhave të shkurtra kohore, prandaj ky mund të quhet stil konservator.

Tekstet ndërtohen në mënyrë stereotipe, pra shkresat bëhen sipas modeleve. Fletë të kësaj natyre për zyrat shtypen dhe modelet jepen të gatshme (tashmë edhe me kompjuterë). Në formularët parashkruhet pjesa më e madhe e teksteve, që duhet vetëm të plotësohen sipas kërkesave. Shumë dokumente përdorin kolonat.

Leksiku terminologjik varet nga nënstili, përkatësisht fusha e veprimtarisë, siç janë drejtësia, ushtria, ekonomia, si: *juridiksion, hetuesi, kundërvajtje, fletarrest, fletanketë, fletëdalje, fletëdorëzim, ratifikim, padi, aktakuzë, fletëdetyrim, fletëpagesë, fletëthirrje* etj.

Pjesën më karakteristike të fjalëve në stilin shtetëror-administrativ e përbën emërtesa. Kjo është mënyrë e veçantë e emërtimit të sendeve, të dukurive, të proceseve, të detyrave e të njerëzve, d.m.th. emërtim sipas përshkrimit, paraqitja në mënyrë të hollësishme e sendeve dhe e njerëzve. P. sh. njeriu quhet *individ:* i përmendet emri, emri i babait e mbiemri, si kërkesë shtetërore. Tiparet e emërtesës shihen më së miri në emërtimet e proceseve të punës, të prodhimeve dhe kur përshkruhet inventari.

Në komunikimin me shkrim me administratën dhe personat juridikë dallojmë shumë forma, ndër të cilat më të shpeshta janë: **lutja, kërkesa, ankesa, padia, vendimi, aktvendimi, kontrata, marrëveshja, autorizimi, procesverbali** etj.

1.1. LUTJA

Lutja është shkresë administrative zyrtare nëpërmjet së cilës u drejtohemi organeve a institucioneve përkatëse për të na plotësuar ndonjë kërkesë a nevojë. Përmbajtja e lutjes mund të jetë e ndryshme, varësisht se kujt dhe për çka i drejtohemi. Struktura e lutjes është fikse, pra ka një model të caktuar, të cilin duhet ta përdorim: Fleta duhet të jetë në formatin A4.

Së pari, në anën e majtë, në krye të fletës duhet të qëndrojë adresati (marrësi), pra emri i plotë i institucionit të cilit i drejtohemi. Adresati duhet të shkruhet në **rasën dhanore** dhe **jo** me strukturat *deri tek:* ose *deri:* ose *për:* të cilat janë kalke nga maqedonishtja. Pastaj në mes të fletës me shkronja të mëdha dhe të nxira (bold) duhet të shkruhet emri i shkresës, pra në këtë rast **LUTJE**, pastaj në rreshtat në vijim fillohet me: Unë, emri dhe mbiemri ynë, pastaj të dhënat e tjera që përkojnë me lutjen dhe adresatin. Pastaj shkruajmë kërkesën tonë dhe arsyetimin.

Teksti i lutjes nuk duhet të jetë i gjatë, por duhet të jetë i shkurtër, i qartë,

konkret dhe të përmbajë të dhënat e rëndësishme për të përmbushur kërkesën a nevojën tonë. Në fund tregojmë mirësjelljen tonë, përmes falënderimit. Pasi mbarojmë lutjen, në anën e majtë në fund të fletës shkruajmë datën dhe vendin, kurse në anën e djathtë, në fund të fletës shkruajmë Lutësi ose Lutësja: emrin dhe mbiemrin tonë, si dhe nënshkrimin.

Duhet ta kemi parasysh se lutja është shkresë që jo gjithmonë na takon ligjërisht, prandaj ajo mund të mos na plotësohet nga institucioni, të cilit i jemi drejtuar.

Ja disa shembuj se si duhet të duket një lutje:

Drejtorisë së Shkollës së Mesme "Arseni Jovkov" Shkup L U T J E Unë, Ilir Bashkimi, nxënës i vitit IV në Shkollën e Mesme "Arseni Jovkov" në Shkup lus institucionin e lartpërmendur të më lirojë nga orët mësimore më datë 15. 10. 2020 (e premte) për shkak të pjesëmarrjes sime me ekipin "Rinia", në garën që kemi në po të njëjtën ditë në turneun e futbollit "Flakadani i Lirisë" që e ka organizuar Komuna e "Çairit" – Shkup. Lutjes i bashkëngjis (të fotokopjuara): 1. librezën e futbollistit; 2. ftesën për pjesëmarrje në turneun e futbollit; 3. orarin e ndeshjeve të ekipeve të futbollit. Me shpresë se kjo lutje do të shqyrtohet dhe do të marrë përgjigje pozitive, paraprakisht Ju falënderoj! 11.10. 2020 Lutësi: / Shkup / Скопје Ilir	До: Раководството на Средното училиште „Арсени Јовков" Скопје М О Л Б А Јас, Илир Башкими, ученик од IV-та година во средното училиште „Арсени Јовков" во Скопје, ја молам горенаведената институција да ме ослободи од часовите на 15.10.2020 (петок) поради мое учество со екипата „Ринија" во натпреварувањето што го имаме истиот ден на турнирот за фудбал „Флакадани и лирис" организан од општина „Чаир"– Скопје. Во прилог на молбата (фотокопирани): 1. книшка на фудбалерот; 2. покана за учество на турнир во фудбал; 3. распоред на фудбалските тимови. Надевајќи се дека оваа молба ќе се разгледа и ќе добијам позитивен одговор, однапред Ви благодарам! Молител: Bashkimi

Meqë të gjitha shkresat duhet të jetë në dy gjuhë, atëherë shkruhet në dy kolona, në anën e majtë maqedonisht, kurse në anën e djathtë shqip. Por, kur shkresat janë në mënyrë tabelore, atëherë teksti radhitet në mënyrë horizontale. Në fund të tekstit, emri dhe vula e zyrtarit jepet vetëm një herë në gjuhën amtare të zyrtarit dhe në mes të shkresës. P. sh.:

До: Шефот на студентски прашања на "Универзитет во Тетово"

Тетово

Тетово/ Tetovë

Shefit të Administratës Studentore të Universitetit të Tetovës

Tetovë

МОЛБА

Јас, Дрита Рамадани, студент на втора година на Правниот факултет при Универзитет во Тетово, со број на индекс 51281, го молам горенаведениот наслов да ми издаде извештај за оцена на предметот Римско право.

Надевајќи се дека мојава молба ќе биде разгледана и прифатена, однапред Ви се заблагодарувам!

LUTJE

Unë, Drita Ramadani, studente e vitit të dytë e Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, me numër indeksi 51281, lus institucionin e lartpërmendur të më lëshojë vërtetimin e notës nga lënda e së drejtës romake.

Me shpresë se kjo lutje do të shqyrtohet dhe pranohet, paraprakisht Ju falënderoj!

13. 12. 2020 г.

Молител: / Lutësja:

Drita Ramadani

1.2. KËRKESA

Kërkesa është shkresë administrative zyrtare përmes së cilës u drejtohemi instancave më të larta për të na plotësuar një nevojë tonën, e cila na takon ligjërisht dhe duhet të na pranohet. Përmbajtja e kërkesës mund të jetë e ndryshme, varësisht se kujt dhe për çka i drejtohemi. Struktura e kërkesës është fikse, pra ka një model të caktuar, të cilin duhet ta përdorim: së pari në anën e majtë, në krye të fletës duhet të qëndrojë adresati (marrësi), pra emri i plotë i institucionit të cilit i drejtohemi. Adresati duhet të shkruhet në **rasën dhanore** dhe jo me strukturat *deri tek:* ose *deri:* ose *për:* të cilat janë kalke nga maqedonishtja, por është bërë praktikë që të përdoret fjala ***drejtuar:***. Pastaj në mes të fletës me shkronja të mëdha më të trasha dhe të nxira (bold) duhet të shkruhet emri i shkresës, pra në këtë rast **KËRKESË**, pastaj në rreshtat në vijim fillohet me: Unë, emri dhe mbiemri ynë, më tej shkruhen të dhënat e tjera që përkojnë me kërkesën dhe adresatin. Më pas shkruajmë kërkesën dhe arsyetimin tonë. Teksti i kërkesës nuk duhet të jetë i gjatë, por duhet të jetë i shkurtër, i qartë, konkret dhe të përmbajë të dhënat tona që nevojiten. Pasi mbarojmë hartimin e kërkesës, në anën e majtë, në fund të fletës shkruajmë datën dhe vendin, kurse në anën e djathtë në fund të fletës shkruajmë - Parashtruesi i kërkesës: si dhe emrin dhe mbiemrin tonë dhe e nënshkruajmë (firmosim) fletën.

Ja disa shembuj se si duhet të duket një kërkesë:

Ministrisë së Punëve të Brendshme të RMV-së
Zyrës së gjendjes civile
Shkup

До: Министерството за внатрешни работи на РСМ,
Канцеларија за матична служба
Скопје

KËRKESË
për lëshim pasaporte

БАРАЊЕ
за издавање на патна исправа

Emri:	Kaltrina	Име:	Калтрина
Mbiemri:	Iseni	Презиме:	Исени
Datëlindja:	08. 06. 1977	Датум на раѓање:	08. 06. 1977
Numri amzë:	08067700245786	ЕМБГ	08067700245786
Vendbanimi:	Shkup-Veri nr. 15/7	Место на живеење:	Скопје- Север бр. 15/7
Shtetësia: Veriut	e Republikës së Maqedonisë së	Државјанство: Македонија	Република Северна

10. 12. 2019
Shkup / Скопје

Parashtruesja e kërkesës: / Подносител:

Kaltrina Iseni

До: Министерството за внатрешни работи
На РСМ, Скопје
Канцеларија за матична служба

Ministrisë së Punëve të Brendshme të RMV-së, Shkup
Zyrës së gjendjes civile

БАРАЊЕ
за издавање на патна исправа

Јас, Калтрина Исени, родена на 08.06.1977 во Скопје, со адреса на живеење Скопје- Север, бр. 15/7, со матичен број 0806977024578, државјанка на Република Северна Македонија, барам од горенаведениот орган да ми издава патна исправа.

KËRKESË
për lëshim pasaporte


Unë, Kaltrina Iseni, e lindur më 08. 06. 1977 në Shkup, me adresë banimi Shkup-Veri, nr. 15/7, me numrin amzë 0806977024578, shtetase e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kërkoj nga organi i lartpërmendur që të më lëshojë pasaportën.

10. 12. 2019
Скопје / Shkup

Подносител:/Parashtruesja e kërkesës:

Kaltrina Iseni

Meqë të gjitha shkresat duhet të jetë në dy gjuhë, atëherë shkruhet në dy kolona, në anën e majtë maqedonisht, kurse në anën e djathtë shqip. Por, kur shkresat janë në mënyrë tabelore, atëherë teksti radhitet në mënyrë horizontale. Në fund të tekstit, emri dhe vula e zyrtarit jepet vetëm një herë në gjuhën amtare të zyrtarit dhe në mes të shkresës. P. sh.:



Образец бр.2
Formulari nr.2

ДО: МИНИСТЕРСТВО ЗА ВНАТРЕШНИ РАБОТИ
DERI TE: MINISTRIA PËR PUNË TË BRENDSHME

БАРАЊЕ ЗА ИЗДАВАЊЕ НА ЛИЧНА КАРТА / KËRKESË PËR DHËNIE TË LETËRNJOFTIMIT

ТИП - Б / LLOJI-B

1. Причина за барање (се одбира еден од основите) / Arsyeja për kërkesë (të rrethohet njëra nga arsyet)
   1.1. прв пат / për herë të parë ☐
   1.2. редовна замена / ndërrim i rregulltë ☐
   1.3. промена на податоци (лични податоци, адреса и живеалиште) / ndryshim i të dhënave (të dhënave personale, adresës dhë vendbanimit) ☐
   1.4. дупликат лична карта (изгубена или украдена) / letërnjoftim dupllikat(i humbur ose i vjedhur) ☐
   1.5. предвремена замена заради оштетеност на личната карта / ndërrim i parakohshëm për shkak të dëmtimit të letërnjoftimit ☐
   1.6. издавање на лична карта со ограничена важност / dhënie e letërnjoftimit me vlefshmëri të kufizuar ☐

2. ПОДАТОЦИ ЗА ПОДНОСИТЕЛОТ НА БАРАЊЕТО / TË DHËNA PËR PARASHTRUESIN E KËRKESËS

1.ИМЕ / EMRI	2. ПРЕЗИМЕ / MBIEMRI
1. македонски јазик / gjuhë maqedonase	1. македонски јазик / gjuhë maqedonase
2. албански јазик / gjuhë shqipe	2. албански јазик / gjuhë shqipe

ЗА ОМАЖЕНИ - ОЖЕНЕТИ (презиме пред склучување на бракот) _____
PËR TË MARTUARAT (mbiemri i vajzërisë) _____

ДЕН, МЕСЕЦ И ГОДИНА НА РАЃАЊЕ _____
DATA, MUAJI DHE VITI I LINDJES _____

МЕСТО НА РАЃАЊЕ (лице родено во странство ја запишува и државата) _____
VENDI I LINDJES (personi i lindur jashtë vendit e shënon edhe shtetin) _____

ЕДИНСТВЕН МАТИЧЕН БРОЈ НА ГРАЃАНИНОТ / NUMRI AMË I QYTETARIT _____

ПОЛ машки ☐ женски ☐ НАЦИОНАЛНА ПРИПАДНОСТ
GJINIA mashkullore ☐ femërore ☐ PËRKATËSIA NACIONALE

ЖИВЕАЛИШТЕ И АДРЕСА _____
VENDBANIMI DHË ADRËSA _____

ДРЖАВЈАНСТВО / SHTETËSIA _____

ИМЕ И ПРЕЗИМЕ ЗА РОДИТЕЛИТЕ / EMRI DHE MBIEMRI I PRINDËRVE

Татко _____ Мајка _____
Babai _____ Nëna _____

3. СОГЛАСНОСТ ОД РОДИТЕЛИТЕ - СТАРАТЕЛОТ ЗА ИЗДАВАЊЕ НА ЛИЧНА КАРТА НА ЛИЦЕ ОД 15-18 ГОДИНИ
PAJTUESHMËRI E PRINDËRVE - KUJDESTARIT PËR DHËNIEN E LETËRNJOFTIMIT PERSONIT PREJ 15-18 VJET

	Име и презиме / Emri dhe mbiemri	Единствен матичен број на граѓанинот / Numri Amë i qytetarit	Сродство / Farefisnia	Потпис / Nënshkrimi
1.	_____ (а. мај) _____ (а. жн.)		_____ (а. мај) _____ (а. жн.)	
2.	_____ (а. мај) _____ (а. жн.)		_____ (а. мај) _____ (а. жн.)	

4. ПОДАТОЦИ ЗА ПРЕТХОДЕН ДОКУМЕНТ НА ПОДНОСИТЕЛОТ / TË DHËNA MBI DOKUMËNTIN E MËPARSHËM TË PARASHTRUESIT

БРОЈ НА ЛИЧНА КАРТА / NUMRI I LETËRNJOFTIMIT

ОРГАН КОЈ ЈА ИЗДАЛ / ORGANI I CILI E KA LËSHUAR

Потпис на подносителот
Nënshkrimi i parashtruesit
_____

Датум и место на потпишување
Data dhe vendi i parashtrimit
____ ____20__ _____


Податоци за контакт
Të dhëna për kontakt _____

Потпис на службеното лице кое го примило барањето
Nënshkrimi i personit zyrtar i cili e ka pranuar kërkesën _____

Në kërkesën e mësipërme për lëshimin e pasaportës do të ishte mirë të bëhen disa

përmirësime gjuhësore, si:

1. Nuk duhet: DERI TE: por DREJTUAR: (ose asgjë)
2. Jo MINISTRIA PËR PUNË TË BRENDSHME, por MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME (patjetër adresati duhet me rasën dhanore)
3. Jo KËRKESË PËR DHËNIE TË PASAPORTËS, por KËRKESË PËR LËSHIM TË PASAPORTËS ose KËRKESË PËR LËSHIM PASAPORTE etj.
4. Jo parashtruësin, por parashtruesin.



ДО: МИНИСТЕРСТВО ЗА ВНАТРЕШНИ РАБОТИ
DERI TE: MINISTRIA PËR PUNË TË BRENDSHME


БАРАЊЕ ЗА ИЗДАВАЊЕ НА ЛИЧНА КАРТА /

ТИП - Б / LLOJI-B

1. Причина за барање (се одбира еден од основите) / Arsy
   - 1.1. прв пат / për herë të parë ☐
   - 1.2. редовна замена / ndërrim i rregullt ☐
   - 1.3. промена на податоци (лични податоци, адреса personale, adresës dhë vendbanimit) ☐
   - 1.4. дупликат лична карта (изгубена или украдена)
   - 1.5. предвремена замена заради оштетеност на ли lëtërnjoftimit ☐
   - 1.6. издавање на лична карта со ограничена важно

2. ПОДАТОЦИ ЗА ПОДНОСИТЕЛОТ НА БАРАЊЕТО / TË DHËNA PËR PARASHTRUËSIN Ë KËRKESËS

1.ИМЕ / EMRI
1. македонски јазик / gjuhë maqedonase
2. албански јазик / gjuhë shqipe



ДО: МИНИСТЕРСТВО ЗА ВНАТРЕШНИ РАБОТИ
DERI TE: MINISTRIA PËR PUNË TË BRENDSHME

БАРАЊЕ ЗА ИЗДАВАЊЕ НА ЛИЧНА КАРТА / KËRKESË PËR DHËNIE TË LETËRNJOFTIMIT

ТИП - Б / LLOJI-B

1. Причина за барање (се одбира само од основите) / Arsyeja për kërkesë (të mirëhuhet vetëm nga njëra)
1.1. прв пат / për herë të parë ☐
1.2. редовна замена / zëvendësim i rregullt ☐
1.3. промена на податоци (лични податоци, адреса и живеалиште) / ndryshim i të dhënave (të dhënave personale, adresës dhe vendbanimit) ☐
1.4. дупликат лична карта (загубена или украдена) / letërnjoftim duplikat (humbur ose i vjedhur) ☐
1.5. предвремена замена заради оштетеност на личната карта / zëvendësim i parakohshëm për shkak të dëmtimit të letërnjoftimit ☐
1.6. издавање на лична карта со ограничена важност / dhënie e letërnjoftimit me vlefshmëri të kufizuar ☐

2. ПОДАТОЦИ ЗА ПОДНОСИТЕЛОТ НА БАРАЊЕТО / TË DHËNA PËR PARAQITUESIN E KËRKESËS

1. ИМЕ / EMRI	2. ПРЕЗИМЕ / MBIEMRI
1. македонски јазик / gjuhë maqedonase	1. македонски јазик / gjuhë maqedonase
2. албански јазик / gjuhë shqipe	2. албански јазик / gjuhë shqipe

ЗА ОМАЖЕНИ - ОНЕНЕТИ (презиме пред склучување на бракот) / PËR TË MARTUARAT (mbiemri i vajzërisë)
ДЕН, МЕСЕЦ И ГОДИНА НА РАЃАЊЕ / DATA, MUAJI DHE VITI I LINDJES
МЕСТО НА РАЃАЊЕ (лице родено во странство да напишува и државата) / VENDI I LINDJES (personi i lindur jashtë vendit e shënon edhe shtetin)
ЕДИНСТВЕН МАТИЧЕН БРОЈ НА ГРАЃАНИНОТ / NUMRI AMË I QYTETARIT
ПОЛ: машки ☐ женски ☐ / GJINIA: mashkullore ☐ femërore ☐
НАЦИОНАЛНА ПРИПАДНОСТ / PËRKATËSIA NACIONALE
ЖИВЕАЛИШТЕ И АДРЕСА / VENDBANIMI DHE ADRESA
ДРЖАВЈАНСТВО / QYTETËSIA

ИМЕ И ПРЕЗИМЕ ЗА РОДИТЕЛИТЕ / EMRI DHE MBIEMRI I PRINDËRVE

Татко / Babai	Мајка / Nëna

3. СОГЛАСНОСТ ОД РОДИТЕЛИТЕ - СТАРАТЕЛОТ ЗА ИЗДАВАЊЕ НА ЛИЧНА КАРТА НА ЛИЦЕ ОД 15-18 ГОДИНИ / PAJTUESHMËRI E PRINDËRVE - KUJDESTARIT PËR DHËNIEN E LETËRNJOFTIMIT PERSONIT PREJ 15-18 VJET

	Име и презиме / Emri dhe mbiemri	Единствен матичен број на граѓанинот / Numri Amë i qytetarit	Сродство / Farëdhënia	Потпис / Nënshkrimi
1.				
2.				

4. ПОДАТОЦИ ЗА ПРЕТХОДЕН ДОКУМЕНТ НА ПОДНОСИТЕЛОТ / TË DHËNA MBI DOKUMENTIN E MËPARSHËM TË PARAQITUESIT

БРОЈ НА ЛИЧНА КАРТА / NUMRI I LETËRNJOFTIMIT
ОРГАН КОЈ ЈА ИЗДАЛ / ORGANI I CILI E KA LËSHUAR

Потпис на подносителот / Nënshkrimi i parashtruesit
Датум и место на поднесувањето / Data dhe vendi i parashtrimit ____.____.20__

Податоци за контакт / Të dhëna për kontakt
Потпис на службеното лице кое го примило барањето / Nënshkrimi i personit zyrtar i cili e ka pranuar kërkesën

Të gjitha shkresat që janë në dy gjuhë, parapëlqehet të shkruhen në dy kolona, dhe në fund të secilës prej tyre duhet të shënohet emri i përpiluesit, që të dihet cila është gjuha origjinale (e cila merret për bazë), pastaj përkthyesi, lektori, kontrolluesi dhe miratuesi. Të gjitha këto shkruhen në fund të shkresës në anën e majtë, fjalët të radhitura një pas një, si p. sh:

Изработил / Përpiloi: Flutura Abazi
Контролирал / Kontrolloi: Besa Gashi
Преведувал / Përktheu: Дарко Илиевски
Лекторирал / Lekturoi: Маја Цветковска
Одобрил / Miratoi: Sefer Iljazi


Emri dhe mbiemri i secilit shkruhet në gjuhën amtare dhe me alfabetin e saj, pastaj nënshkruhet secili pas emrit të vet. Edhe emri i kryesuesit të institucionit (drejtori, shefi, ministri, kryetari etj.) shkruhet me alfabetin e gjuhës amtare të tij dhe

vendoset në mes të dy kolonave, ku edhe vuloset, p. sh.:

Директор: / Drejtori:

Dritan Abazi

Për ilustrim keni shembujt në vijim:



Почитувани,

Во прилог на овој допис, Ви испраќаме анкетен прашалник.

Ве молиме да одговорите на поставените прашања и да ни ги доставите на нашата адреса „Кеј Димитар Влахов" бр. 4, кат 4, 1000 Скопје.

Со почит / Me respekt,

Прилог / Shtojcë: Анкетен прашалник / Pyetësor anketues

Изработил / Përgatiti: д-р
Преведувал / Përktheu:
Контролирал / Kontrolloi:
Лектурирал / Lekturoi:
Одобрил / Miratoi:

1

До Регулаторна комисија за енергетика на Република Северна Македонија	Drejtuar: Komisionit Rregullator të Energjetikës të Republikës së Maqedonisë së Veriut
ул. „Димитрие Чуповски" бр. 2, 1000 Скопје	Rr. "Dimitrie Çupovski" nr. 2, 1000 Shkup
Предмет: Доставa на анкетен прашалник	Lënda: Dorëzim të pyetësorit anketues
Почитувани,	Të nderuar,
Во прилог на овој допис, Ви испраќаме анкетен прашалник.	Lidhur me këtë shkresë, Ju dorëzojmë pyetësor anketues
Ве молиме да одговорите на поставените прашања и да ни ги доставите на нашата адреса „Кеј Димитар Влахов" бр. 4, кат 4, 1000 Скопје	Ju lutemi të përgjigjeni në pyetjet e parashtruara dhe të na i dorëzoni në adresën tonë "Moli Dimitar Vllahov" nr. 4, kati i 4-t, 1000 Shkup.

Со почит / Me respekt.


Директор / Drejtori

Прилог / Shtojcë: Анкетен прашалник / Pyetësor anketues

Изработил / Përgatiti: д-р
Превеле / Përkthen:
Контролирал / Kontrolloi:
Лектурирал / Lektoroi:
Одобрил / Miratoi:

1.3. NJOFTIMI

Njoftimi është kumtim a lajm që na jepet për diçka, ajo që na njoftohet; të dhëna që na bëhen të njohura. *Njoftime të përditshme. Vijnë njoftime. Japin njoftime me radio. Iu drejtua për njoftime më të hollësishme.*



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./ Nr. 08-2/ 1921
4.12.2019 год./viti

ДО ПРАТЕНИЦИТЕ НА СОБРАНИЕТО НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
DREJTUAR DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ве известувам дека врз основа на член 137, а во врска со член 188 од Деловникот на Собранието на Република Македонија Ви е доставен во електронска форма Предлогот на законот за ратификација на Договорот помеѓу Република Северна Македонија и Република Казахстан за меѓусебна правна помош во кривичната материја.

Ju njoftoj se në bazë të nenit 137, në lidhje me nenin 188 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Ju është dërguar në formë elektronike Propozim-ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kazakistanit për ndihmë të ndërsjellë juridike në materien penale.

ПРЕТСЕДАТЕЛ/KRYETARI
mr. Talat Xhaferi

Изработил/ : Илмије Јашари
Përgatiti: Ilmije Jashari
Контролирал/Kontrolloi:
Одобрил/ Miratoi:
Согласен/ Pëlqim:

Превел/Përktheu:
Контролирал превод/
Kontrolloi përkthimi:

Страна 1 од 1

До: Г-дин Петре Шилегов, градоначалник на Град Скопје

Drejtuar: z. Petre Shilegov, kryetar i Qytetit të Shkupit

Предмет: Известување

Lënda: Njoftim

Почитуван г-дине Шилегов,

Дозволете ми, во оваа прилика, од име на Агенцијата за примена на јазикот и од мое лично име, да Ви изразам највисоко почитување.

Причина за моето обраќање до Вас е да Ве информирам дека во рамките на редовните работни средби кои ги остварувам со раководни лица од органите на централната и локалната власт, на 01.10.2012 година со писмени дописи, а претходно и телефонски, побарав работни средби и со директорите на јавните претпријатија Водовод и Канализација, Улици и Патишта, ЈСП - Скопје и Градски паркинг - Скопје.

I nderuar z. Shilegov,

Më lejoni që me këtë rast, në emër të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës dhe në emrin tim personal, t'Ju shpreh nderimet e mia më të larta.

Arsyeja e letrës sime drejtuar Juve është që t'Ju informoj se në suazat e takimeve të rregullta të punës që i realizoj me persona udhëheqës të organeve të pushtetit qendror dhe lokal, më 01.10.2012 me shkresë, ndërsa më parë, edhe përmes telefonit, kërkova takim pune edhe me drejtorët e ndërmarrjeve publike "Ujësjellësi dhe Kanalizimi", "Rrugë dhe Rrugica", "NQP – Shkup" dhe "Parkingjet e Qytetit – Shkup".

Со почит,

Me respekt,

Контакт лице за работна средба:

Дритан Исени
Тел. за контакт: 070 ххх ххх
E-mail: хххххххх@apj.gov.mk

Personi kontaktues për takimin e punës:

Dritan Iseni
Tel. për kontakt: 070 xxx xxxx
E-mail: xxxxxxxx@apj.gov.mk

Ве молам уште еднаш, почитуван г-дине Шилегов, примете ги изразите на моето највисоко почитување.

Ju lutem edhe një herë, i nderuari z. Shilegov, t'i pranoni nderimet e mia më të larta.

Директор / Drejtori

Filan Fisteku

vula dhe nënshkrimi

Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./ Nr. 08-2/ 1420
04.12.2019 год./viti

ДО: ПРАТЕНИЦИТЕ НА СОБРАНИЕТО НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

DREJTUAR: DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ве известувам дека врз основа на член 137 од Деловникот на Собранието на Република Македонија и член 18 од Деловникот за изменување и дополнување на Деловникот на Собранието на Република Македонија Ви е доставен во електронска форма Предлогот на законот за изменување и дополнување на Законот за државната ревизија - I читање.

Ju njoftoj se në bazë të nenit 137 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe nenit 18 të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Ju është dërguar në formë elektronike Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për revizion shtetëror-leximi I.

ПРЕТСЕДАТЕЛ/KRYETARI

mr. Talat Xhaferi

Изработил/ Përgatiti: Милан Стефаноски
Контролирал/Kontrolloi:
Одобрил/ Miratoi:
Согласен/ Pëlqim:

Превел/Përktheu:
Контролирал превод/
Kontrolloi përkthimi:

Страна 1 од **1**

1.4. PROCESVERBALI

Procesverbali është një shkresë administrative-zyrtare, në të cilën shkruhet gjithçka që thuhet, vendoset dhe diskutohet në një mbledhje të një kolegjiumi të ndonjë institucioni ose shoqate, grupi njerëzish, me qëllim që të mbetet si dëshmi e gjithçkaje që është trajtuar, debatuar dhe vendosur në atë mbledhje. Procesverbali u dërgohet të gjithë anëtarëve të kolegjiumit për ta lexuar dhe për ta konstatuar vërtetësinë e gjërave që janë shkruar apo nëse janë bërë lëshime, sepse vendimet e shkruara në procesverbal janë detyrim që duhet të zbatohen. Pastaj në mbledhjen e radhës votohet miratimi i procesverbalit.

Dallojmë edhe kategori të veçanta të procesverbaleve të seancave gjyqësore dhe të konferencave diplomatike, që ndryshe quhen protokolle.

Zakonisht, procesverbalin e shkruan sekretari i institucionit që e mban mbledhjen, por mund të zgjidhet edhe para mbledhjes njëri nga anëtarët e kolegjiumit. Kushtet që duhet të plotësojë procesverbalisti janë: të njohë drejtshkrimin e gjuhës në të cilën shkruhet procesverbali, të jetë i aftë dhe i shkathtë që fjalimet dhe mendimet që thuhen në mbledhje të mund t'i përzgjedhë, t'i sintetizojë, të ruajë kontekstin e mendimeve dhe t'i shkruajë qartë ato, sepse ky dokument ka rëndësi të madhe e, natyrisht, edhe përgjegjësia është e madhe.

Të dhënat që duhet të ketë procesverbali janë: emri i institucionit dhe logoja, titulli i dokumentit (pra, PROCESVERBAL), përsëritet institucioni që mban mbledhjen, data, dita, ora, vendi ku mbahet mbledhja, kush është i pranishëm e kush mungon, rendi i ditës, hapja e mbledhjes, pastaj diskutimet dhe vendimet për të gjitha pikat e rendit të ditës dhe, në fund, ora kur mbaron mbledhja dhe nënshkruhet nga procesverbalisti dhe kryesuesi (drejtori, shefi, kryetari, dekani, rektori, ministri etj.) i institucionit. Procesverbali duhet edhe të vuloset.

Po japim një shembull se si duket procesverbali:

Универзитет „Мајка Тереза" во Скопје
Факултет за Социјални Науки
Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup
Fakulteti i Shkencave Sociale
Бр./Nr. _____
Од/Prej _____

12 Ударна бригада
2а/7-ми спрат,
1000 Скопје,
Република Македонија
+389 2 3161 004
www.mit.edu.mk

12 Udarna Brigada
2a/ kati i 7-të,
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë
së Veriut
+389 2 3161 004
www.mit.edu.mk

Procesverbal

Nga mbledhja e 11-të e Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Sociale pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup të mbajtur me datë 24.12.2019

Mbledhja u mbajt në objektin e Sh.F. "Kongresi i Manastirit", në zyrën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale.
Në mbledhje të pranishëm ishin profesoret dhe asistentet: Su[illegible]fa Ibraimi, [illegible], Argëtim Xhiu, Dhurtë [illegible] Aleksandar Petkovski, El[illegible]
Mbledhja filloi ne ora 10:00 dhe me ate kryesoi Dekani i Fakultetit Prof.dr.Sun[illegible]ai.
Dekani për punën e mbledhjes propozoi këtë

REND DITE

1.Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja 10-të e Këshillit mësimor-shkencor e mbajtur me datë 04.12.2019.

2.Shqyrtim i Referatit të Komisionit recenzues për përzgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore shkencore M[illegible] sociale dhe Tjetër.

3.Propozim-Vendim për përzgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore docent nga fusha e Met[illegible]ës sociale dhe Tjetër.

4.Vendim për numrin dhe përbërjen e anëtarëve të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Sociale.

5.Propozim Vendime për përzgjedhjen e Prodekanit për arsim dhe Prodekanit për shkencë.

6.Të ndryshme.

Pika 1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e 10-të e Këshillit mësimor shkencor.

Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale prof.dr.Sun[illegible] hapi debat per Procesverbalin nga mbledhja e 10-të e Këshillit mësimor shkencor.
Profesoresha Di[illegible]e Isl[illegible]ili kerkoi qe pjesa ku ajo ka elaboruar rreth programit Erasmus ne piken te ndryshme, ne mbledhjen e 10-te, te futet ne procesverbal.
Procesverbali u miratu me 13 vota "Per"

Pika 2 Shqyrtim i Referatit të Komisionit recenzues për përzgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore shkencore Met[illegible]ka e [illegible]sociale dhe Tjetër.

Dekani i fakultetit Prof.dr. S[illegible]i hapi diskutimin për këtë pike të rendit të ditës dhe tha se Komisioni recenzues me në kry[illegible]oc.dr T[illegible]ski ka dorëzuar referatin i cili është shpallur në Buletinin e universitetit dhe sipas gjith rregullativës dhe propozimit në

UNIVERSITETI "NËNË TEREZA" NË SHKUP
УНИВЕРЗИТЕТ "МАЈКА ТЕРЕЗА" ВО СКОПЈЕ
"MOTHER TERESA" UNIVERSITY IN SKOPJE

Универзитет „Мајка Тереза" во Скопје
Факултет за Општествени Науки
Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup
Fakulteti i Shkencave Sociale
Бр./Nr. _____
Од/Prej _____

12 Ударна бригада
2а/7-ми спрат,
1000 Скопје,
Република Северна
Македонија
+389 2 3161 004
www.unt.edu.mk

12 Udarna Brigada
2a/ kati i 7-të,
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë
së Veriut
+389 2 3161 004
www.unt.edu.mk

Ne piken te ndryshme Dekani informoi te pranishmit per ceshtjet e diksutuara ne mbledhjen e fundit te Keshillit te rekoratit si dhe u shyrtuan kerkesat e studenteve te cilat jane dorezuar gjate muajit te fundit.

Pas perfundimit te diskutimeve mbledhja perfundoi ne ora 11:00.

Fakulteti i Shkencave Sociale
Dekan
Prof.dr.Sunaj [redacted]

Sekretar i Fakultetit te Shkencave Sociale
[redacted]

Logoja dhe emri i plotë i institucionit vihen këtu

Република Македонија	Republika e Maqedonisë
Влада на Република Македонија	Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Државен инспекторат за техничка инспекција	Inspektorati Shtetëror i Inspektimit Teknik
ИП1 Број - _____	PI1 Numri- _____
Датум _____	Data _____
Даночен број на субјектот	Numri tatimor i subjektit
_____	
ЕМБС на субјектот	NVAS i subjektit
_____	_____
Жиро сметка на субјектот	Llogaria bankare e subjektit
_____	
Депонент	Deponent
_____	_____
Телефон и факс на субјектот	Telefoni dhe faksi i subjektit
_____	_____

ЗАПИСНИК

од извршен инспекциски надзор

Инспекцискиот надзор е извршен врз основа на _____

(Членот од материјалниот закон)

_____

_____ составен во

_____

_____

_____

со адреса на _____

PROCESVERBAL

i inspektimit mbikëqyrës të kryer

Inspektimi mbikëqyrës është kryer në bazë të _____

(Neni i ligjit material)

_____

_____ i përpiluar ___

_____

_____

_____

në adresë _____

_____

_____ _____ на ден _____ _____год. во _____часот, во предметот (Место на вршење на дејството) ___ _____инспекциски надзор во рамките на овластувањата утврдени со Законот за техничка инспекција (Службен весник на РМ број 88/2008, 119/2010, 36/2011 и 136/2011 год.) и Закон за _____ _____ _____ _____

_____ në ditën e vitit _____ në orën _____, në lëndën (Vendi i kryerjes së veprimit) _____ _____mbikëqyrje inspektuese në kuadër të autorizimeve të vërtetuara me Ligjin për Inspektimin Teknik (Gazeta Zyrtare e RM-së numër 88/2008, 119/2010, 36/2011 dhe 136/2011) dhe Ligjin për _____ _____ _____ _____ _____

Прегледот го изврши Државен технички инспектор/и:

_____ _____ _____ во присуство на:

_____ _____

_____ _____ _____.

Одговорно лице во правното лице е: _____ _____со ЕМБГ _____ и стан на улица _____ во _____

Kontrollin e kreu Inspektori Shtetëror Teknik:

_____ _____ _____ në prani të: _____ _____ _____

_____ _____ _____.

Personi përgjegjës në subjektin juridik është: _____ me NVAQ _____dhe banim në rrugën _____ në _____

Наод на утврдената фактичка состојба:

_____ _____ _____

Konstatim i gjendjes së vërtetuar faktike:

_____ _____ _____

Забелешки на лицата што учествуваат во вршењето на дејствијата по читањето на записникот

Vërejtje të personave pjesëmarrës në kryerjen e veprimeve pas leximit të procesverbalit

1._____

2. _____

Потпис на присутни лица

1. _____

2. _____

Nënshkrimi i personave të pranishëm

1. _____	1. _____
2. _____	2._____
(Потпис на инспектор/и)	(Nënshkrimi i inspektorit/ve)

1.5. FTESA

Ftesa është shkresë nëpërmjet së cilës ftojmë dikë në ndonjë rast solemn, shfaqje teatrore, përurim libri, ekspozitë, dasmë, fejesë, ditëlindje, mbledhje, këshill, seancë gjyqësore etj. Ftesa mund të jetë zyrtare dhe të dërgohet nga një institucion shtetëror apo privat; dhe jozyrtare, e cila mund të dërgohet nga secili individ në mënyrë private (për dasmë, fejesë, ditëlindje etj.). Ftesat në dy gjuhë, zakonisht bëhen në dy faqet e fletës, në njërën anë shqip dhe në anën tjetër maqedonisht. Nëse është ftesë elektronike, atëherë bëhet njëherë në njërën gjuhë e pastaj në gjuhën tjetër, pra nuk shkruhet në dy kolona.

Република Северна Македонија
Агенција за примена на јазикот на РСМ



Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia për Zbatimin e Gjuhës së RMV-së

Ftesë

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV- së, ka nderin t'Ju ftojë të merrni pjesë në hapjen solemne të Konferencës Shkencore "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV" për nder të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, e cila do të mbahet në hotelin "Holiday Inn" në Shkup, më datë 20.2.2020 (e enjte) në orën 17:00.

Pjesëmarrja Juaj do të na nderojë.

Me respekt,
Ganimete Hasi
Drejtoreshë e AZGJ-së

Покана

Агенцијата за примена на јазикот на РСМ, има чест да Ве покани на свеченото орварање на Научната конференција "Мултилингвализмот и предизвиците на спроведувањето на Законот за јазиците во РСМ" по повод одбележувањето на Меѓународниот ден на мајчиниот јазик, што ќе се одржи во хотел "Holiday Inn", Скопје, на 20.2.2020 год. (четврток) со почеток во 17:00 часот.

Вашето присуство ни претставува особена чест!

Со почит,
Ганимете Хаси
Директор на АПЈ



Република Северна Македонија

Агенција за примена на јазикот што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните на Република Северна Македонија

Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia për Zbatimin e Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare

20-23 shkurt 2020

Konferencë Shkencore Ndërkombëtare

Tema: "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të ligjit të gjuhës në RMV"

Ftesë

Kemi kënaqësinë t'Ju ftojmë të merrni pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare që organizon Agjencia për Zbatimin e Gjuhës Shqipe, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, që do të mbahet nga data **20 shkurt deri më 23 shkurt 2020**, në sallën e konferencave të hotelit "Stone Bridge", Shkup.

Në vijim, Ju paraqesim nëntemat e konferencës:

- *Shumëgjuhësia në RMV;*
- *Sfidat e zbatimit të ligjit të gjuhës në RMV;*
- *Modelet evropiane të politikave gjuhësore;*
- *Rëndësia e përkthimeve cilësore dhe fjalorët terminologjikë;*
- *Efektet e shumëgjuhësisë në aktet juridike.*

Afati për dërgimin e abstrakteve është deri më **15 janar 2020**, në adresat elektronike: nerxhi.kuci@apj.gov.mk ose ajtene.qamili@apj.gov.mk

Programi i konferencës do t'Ju dërgohet deri më **5 shkurt 2020**.

Me respekt,
Prof.dr. Ylber Sela
Drejtor i AZGJ-së

1.6. KONTRATA

Kontrata është një lloj marrëveshjeje me shkrim ndërmjet dy ndërmarrjeve a dy palëve, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të tyre; dokumenti që përmban këtë marrëveshje. Themi: *Kontratë vjetore; Kontratë kolektive; Kontrata e punës; Kontrata e furnizimit (e grumbullimit të prodhimeve bujqësore); Kontrata e qirasë. Bëj (lidh, nënshkruaj) kontratën. Zbatoj (shkel, prish, zgjidh, shkëput) kontratën.* P. sh.:

ДОГОВОР НА ДЕЛО

Склучен помеѓу:

1. Агенцијата за примена на јазикот кој го зборуваат најмалку 20% од граѓаните на Република Северна Македонија, со седиште ул. Булевар „Илинден“ бр. 2/ Кула 6 / Канцеларија 410, Центар, Скопје, застапувано од директорот XXX XXX (во натамошниот текст: Нарачател); и

2. xxxxxxxx со матичен број xxxxxxxx со живеалиште во Куманово Ул. “Крсте Мисирков” бр. 26 дипломиран професор по англиски јазик и литература (во понатамошен текст како: Извршител)

Член 1

Нарачувачот согласно со одредбите од член 619 од Законот за облигациони односи, го ангажира Извршителот за вршење на работи и задачи за потребите на директорот во својство на лице кое изработува анализи, информации, стручни мислења како и учествува во извршување на работите во писмен и симултан предвод, подршка на институциите во остварувањето на обврските од Законот за употреба на јазиците, вклучувајќи превод на документи и обезбедување подрќка за превод на други институции, и други задачи по потреба на директорот.

KONTRATË NË VEPËR

E lidhur ndërmjet:

1. Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me seli në rr. Bulevardi “Ilinden” nr. 2 / Kulla 6/ Zyra 410, Qendër, Shkup, e përfaqësuar nga drejtori XXX XXX (në tekstin e mëtutjeshëm: Porositës);

dhe

2. xxxxxxxx me numrin amzë xxxxxx me vendbanim në Kumanovë, Rr. “Krste Misirkov” nr. 26 Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë angleze (në tekstin e mëtutjeshëm: Realizues)

Neni 1

Porositësi në pajtim me dispozitat e nenit 619 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e angazhon Realizuesin për kryerjen e punëve dhe detyrave për nevojat e drejtorit, në cilësinë e personit që përpunon analiza, informacione, mendime profesionale, si dhe merr pjesë në kryerjen e punëve në përkthimin me shkrim dhe simultan, në mbështetjen e institucioneve në realizimin e detyrimeve nga Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, duke përfshirë përkthimin e dokumenteve dhe siguron mbështetje për përkthim në institucionet e tjera dhe detyra të tjera sipas nevojës së drejtorit.

Член 2

Договорните обврски Извршителот ќе ги извршува почнувајќи од 2.9.2019 година до 31.12.2019 година.

Neni 2

Detyrimet kontraktuese Realizuesi do t'i realizojë duke filluar nga data 2.9.2019 deri në datën 31.12.2019.

Член 3

Извршителот се обврзува работите и задачите да ги врши квалитетно, навремено, уредно и во согласност со прописите кои важат за работењето во органите на државната управа, во работните денови и во деновите кога тоа е потребно или ќе се побара од него.

Neni 3

Realizuesi detyrohet që punët dhe detyrat t'i kryejë me cilësi, në kohë dhe në mënyrë të rregullt, në përputhje me normat të cilat vlejnë për punën në organe të administratës shtetërore, gjatë ditëve të punës dhe në ditët, në të cilat është e nevojshme ose do të kërkohet prej tij.

Член 4

За извршувањето на договорните обврски Нарачателот се обврзува на извршителот месечно да му исплати надоместок во нето износ од ххххх денари.

Исплатата ќе се врши преку Агенцијата за примена на јазикот кој го зборуваат најмалку 20% од граѓаните на сметка на Извршителот.

Neni 4

Për realizimin e detyrimeve kontraktuese, porositësi obligohet që realizuesi në muaj t'i paguajë kompensim mujor në vlerë neto prej xxxxx denarësh.

Pagesa do të bëhet nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin 20% e Qytetarëve në llogari të Realizuesit.

Член 5

Извршителот е должен еднаш месечно да доставува извештај за извршените работи, до директорот на Агенцијата.

Neni 5

Realizuesi është i detyruar që një herë në muaj t'i dorëzojë drejtorit të Agjencisë, raport për punët e kryera.

Член 6

Договорните страни се согласни Агенцијата за примена на јазикот, со едностране известување, да може да го раскине договорот.

Neni 6

Palët kontraktuese janë pajtuar që Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, me njoftim të njëanshëm, mund ta ndërpresë kontratën.

Neni 7

Член 7

Овој договор е составен во 4 примероци од кои еден (1) за Извршителот и три (3) за Нарачателот.

Kjo kontratë është përpiluar në 4 kopje, nga të cilat një (1) për Realizuesin dhe tri (3) për Porositësin.

Нарачател / Porositës

Ashim Loki

Извршител / Realizuesi

Бошко Милески

1.7. ANKESA

Ankesa është shkresë që i drejtohet një organi zyrtar për të shprehur kundërshtimin për një veprim të padrejtë e të paligjshëm të një njeriu, grupi a të një institucioni. Të gjithë qytetarët mund të paraqesin ankesë ndaj vendimit administrativ, nëse ai ose ajo mendon se me atë vendim i janë shkelur ose i janë cenuar të drejtat atij ose asaj. Të drejtë ankimi ka pala e pakënaqur me vendimin e ndonjë organi.

Ankesa është edhe mjet i rregullt juridik i palës kundër aktvendimeve të marra nga ndonjë institucion. Afati i përgjithshëm për paraqitjen e ankesës është 15 ditë nga dita kur i është dorëzuar palës aktvendimi. Ky afat mund të jetë më i shkurtër ose më i gjatë, varësisht se si vendos organi.

Përmbajtjen e ankimit e përcakton ligji se cilat elemente janë të nevojshme me rastin e paraqitjes së ankesës. Këto elemente janë:

1. Data dhe numri i aktvendimit që ankimohet;
2. Emri i organit që e ka sjellë aktvendimin;
3. Në çfarë pikëpamje pala është e pakënaqur me atë vendim.

Përveç këtyre elementeve, ankesa duhet të jetë e qartë, e kuptueshme dhe duhet të nënshkruhet nga parashtruesi i ankesës. P. sh.:

Kryetarit të Komunës së Çairit

Zotëri, Visar Ganiu

Shkup

A N K E S Ë

Unë, Bardhyl Bislimi, banor në komunën e Çairit, në rrugën "Ferid Murati", Fushë Topanë, i ankohem Komunës së Çairit për marrjen e masave të nevojshme për ndalimin e muzikës me zë të lartë në dy kafenetë e lagjes sonë. Zëri i lartë i muzikës, si dhe zhurma e madhe deri në mëngjes na shqetëson të gjithëve, prish qetësinë e rehatinë e banorëve përreth, aq sa nuk mund të pushojmë si duhet e as të flemë. Ankesa me gojë kanë shprehur edhe shumë banorë të kësaj lagjeje, prandaj shpresoj dhe këmbëngul që ta zgjidhni këtë problem tanimë disamujor. Nëse nuk do të merren masat e nevojshme, atëherë do të protestojmë derisa të zgjidhet problemi.

Shkup, më 14. 10. 2019

Ankuesi:
Bardhyl Bislimi

2. ADMINISTRATORËT PUBLIKË

Një administratë publike që funksionon mirë, është një nga gurthemelet e shoqërisë demokratike. Shërbimi civil, në nivelin qendror apo lokal të administratës publike është ofruesi kryesor i shërbimeve publike për qytetarët dhe efektiviteti i tij ndikon drejtpërdrejt në mundësinë e banorëve për të pasur qasje në të drejtat e tyre themelore. Prandaj, është e rëndësisë jetike të garantohet respektimi i barazisë gjuhësore brenda administratës dhe të sigurohet një administratë efektive, ku qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të mund të marrin shërbime në gjuhët zyrtare, siç kërkohet me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Përgjegjësitë ndaj temës/ fushës specifike

- Njoftimet për vendet e lira të punës duhet të shpallen në të gjitha gjuhët zyrtare.
- Testi me shkrim duhet të jetë në dispozicion në njërën nga gjuhët zyrtare.
- Në varësi të përshkrimit të punës, testi me gojë për kandidatët, që e kanë kaluar fazën e parë të testimit, duhet të jetë në dispozicion në njërën nga gjuhët zyrtare.
- Rezultatet e procedurës së rekrutimit publikohen në të njëjtën kohë në të gjitha gjuhët zyrtare.
- Administratorët publikë janë të detyruar të ofrojnë shërbime në gjuhët zyrtare ose nëpërmjet përkthyesit.
- Çdo dokument i lëshuar nga ana e administratorëve publikë, duhet të jetë në gjuhët zyrtare.
- Gjatë punës së tyre të përditshme, Administratorët publikë duhet të sigurojnë respektimin e dispozitave ligjore dhe të politikave që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve, duke përfshirë mosdiskriminimin e asnjërit në bazë të gjuhës.

Përgjegjësia institucionale

- Institucionet janë përgjegjëse për të siguruar respektimin e barazisë gjuhësore.
- Institucionet janë përgjegjëse për të siguruar që të gjitha dokumentet e kërkuara nga qytetarët të lëshohen në gjuhët zyrtare dhe që shërbimet të ofrohen në gjuhët zyrtare.
- Institucionet janë përgjegjëse për të siguruar dhënien e të gjitha informatave në gjuhët zyrtare.
- Institucionet janë përgjegjëse për shpërndarjen e informacionit në të njëjtën kohë në gjuhët zyrtare.
- Institucionet janë përgjegjëse për të siguruar se komunikimi ndërinstitucional është në dispozicion në gjuhët zyrtare.
- Institucionet janë përgjegjëse për përkthimin e të gjitha dokumenteve institucionale (d.m.th. vendet e lira të punës, testet me shkrim, raportet, format e vlerësimit, kërkesat dhe materialet e tjera të punës) në gjuhët zyrtare.
- Institucioni është përgjegjës për të siguruar disponueshmërinë e përkthimit simultan në gjuhët zyrtare, në çdo trajnim për nëpunësit civilë, në varësi të diversitetit të grupit.

■ Në planifikimin dhe organizimin e punës dhe aktiviteteve, institucioni është përgjegjës për të siguruar që nëpunësit civilë nga komunitetet gjuhësore të jenë të përfshirë në të gjitha fazat e punës, nga fazat e hershme deri në fazën e fundit të aktiviteteve të ndryshme. Po ashtu atyre u duhet ofruar që në gjuhët zyrtare të marrin udhëzimet, materialet e shkruara, projektversionet e dokumenteve dhe mundësinë për të marrë pjesë në diskutime që lidhen me punën etj. Për më tepër, shpërndarja e informatave dhe e materialeve për takimet zyrtare dhe atyre të personelit duhet të bëhet në gjuhët zyrtare, duke siguruar përkthim në takime/ngjarje, si dhe përkthimi dhe shpërndarja e procesverbaleve të takimeve të bëhet në gjuhët zyrtare.

■ Institucioni është përgjegjës të publikojë vendet e lira të punës në gjuhët zyrtare. Vlerësimi i performancës, si me shkrim, ashtu edhe me gojë, duhet të bëhet në gjuhët zyrtare.

3. PËRDORIMI NË GJYKATË

Procesi i zbatimit të gjuhës shqipe ka filluar me Ligjin e vitit 2008. Pra, qytetarët kanë të drejtë të bëjnë parashtresa, padi, ankesa etj. në gjuhën shqipe, dhe gjykata ka qenë e detyruar ndaj palëve që kanë bërë parashtresa në gjuhë shqipe, t'u përgjigjet në këtë gjuhë. Me Ligjin e vitit 2008, në fakt, fillon edhe zbatimi i Amendamentit V të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, baza e të cilit buron nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit.

Duke marrë parasysh atë që u tha më sipër, vlerësojmë se zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në gjykata nënkupton krijimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të kuadrit dhe të teknikës, proces në të cilin është dashur të punohet, jo tani në vitin 2019 apo 2020, por shumë më herët.

Nëse do të ishte punuar në vazhdimësi për krijimin dhe ndërtimin e kapaciteteve në gjykata, gjatë hyrjes në fuqi të ligjit të vitit 2008 dhe ndryshimeve të vitit 2011, nuk do të paraqitej nevoja e tanishme dhe mospërgatitja e mjaftueshme për zbatimin e nenit 9 të ligjit të ri të vitit 2019, i cili e rregullon zbatimin e gjuhës shqipe në gjykata. Ndërtimi dhe krijimi i kapaciteteve nënkupton krijimin e kuadrit dhe të infrastrukturës teknike.

Për t'u zbatuar ligji në gjykata, duhet të punësohen jo më shumë sesa është dashur të bëhet deri më tani me ligjin e vjetër, pra me ligjin e vitit 2008 dhe të vitit 2011. Nëse do të ishte punuar me përpikëri sipas ligjit, nuk do të kishte aspak probleme financiare.

Deri më tani ka shembuj të mirë, të cilët mund të shërbejnë si motivim për të tjerët, por ka edhe shembuj të këqij. Ekziston mungesë e balancës në këtë çështje, në lidhje me atë që një numër shumë i vogël i organeve të sistemit gjyqësor e zbatojnë ligjin me përpikëri dhe plotësisht. Po ashtu, ka edhe gjykata të cilat nuk e kanë zbatuar fare ligjin nga viti 2008 deri në sjelljen e ligjit të ri, çështje për të cilën nuk ka përgjegjësi juridike, por ka përgjegjësi morale para qytetarëve. Kush i ka penguar që procedura të zhvillohet në pajtim me ligjin kur gjykatësi ka qenë shqiptar, palët kanë qenë shqiptarë, avokati ka qenë shqiptar, prokurori është shqiptar dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë qenë shqiptarë?!

Zbatimi i ligjit në gjyqësi, kur thuhet se, po qe se çdokush nga pjesëmarrësit flet në gjuhën që e flasin 20 % e qytetarëve, ka të drejtë të përdorë atë në procedurë, nuk

është risi, pasi edhe më herët në ligjet e vjetra është paraparë kjo e drejtë, nga neni 5 deri në nenin 19 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve që e flasin 20 % e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 101/08 dhe 100/11).

Nëse gjykatësi është shqiptar, kurse paditësi dhe të padituri janë maqedonas, a do ta kryesojë ai gjykatës procesin dhe a do të gjykojë në gjuhën shqipe?

Neni 9, paragrafi 2 i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, e rregullon çështjen kur thotë: "(2) Të gjitha procedurat e paragrafit (1) të këtij neni mbahen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20 % e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj, nëse gjykatësi, prokurori publik, palët ose një pjesëmarrës tjetër në procedurë është person që flet gjuhën që e flasin së paku 20 % e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë".

- Aktet administrative duhet të nxirren në gjuhët zyrtare. Duhet të zbatohet përkthim cilësor për të siguruar qartësi ligjore.

- Emrat e palëve që u përkasin komuniteteve shumicë në vend duhet të formulohen në bazë të drejtshkrimit që përdoret në gjuhën zyrtare.

Përgjegjësia institucionale

- Institucionet publike duhet të veprojnë në përputhje me parimet e paanshmërisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit dhe të sigurojnë respektimin e barazisë gjuhësore.

- Institucionet janë përgjegjëse për të garantuar që anëtarët e komuniteteve shumicë të jenë të informuar për ecurinë e procedurës administrative, të kenë qasje në dosjet e tyre dhe të njoftohen për veprimet e organit publik në gjuhët zyrtare.

- Institucionet janë përgjegjëse për të kryer procedurat administrative, të vendosin për rastin, të nënshkruajnë vendimin dhe ta njoftojnë palën për vendimin në gjuhët zyrtare. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në përgatitjen e një raporti me shkrim, duke përmbledhur rrjedhën e procedurës dhe prezantimin e tij, së bashku me një koncept-akt administrativ apo kontratë administrative në gjuhët zyrtare.

- Institucionet janë përgjegjëse për të ofruar informacione dhe mbështetje aktive për palën në gjuhët zyrtare. Kjo përfshin informacione mbi procedurat administrative, mjetet juridike ndaj një mosmarrëveshjeje, apo mënyrat dhe kushtet për qasje në regjistra dhe në bazat e të dhënave publike.

- Institucionet janë përgjegjëse të lëshojnë dokumente, njoftime për veprime dhe akte administrative në gjuhët zyrtare. Institucionet janë përgjegjëse për t'u siguruar që emrat e palëve janë formuluar sipas drejtshkrimit zyrtar.

- Institucionet janë përgjegjëse për t'u siguruar që format administrative janë në dispozicion në gjuhët zyrtare dhe se komunikimi me palët zhvillohet në gjuhën e tyre të preferuar zyrtare.

- Institucionet janë përgjegjëse për të vepruar në përputhje me parimin e transparencës dhe të ruajnë të dhënat publike në gjuhët zyrtare, në mënyrë që ato të mund të qasen nga pjesëtarët e komuniteteve shumicë.

- Institucionet janë përgjegjëse të ofrojnë informacione në gjuhët zyrtare pa

kompromet uar shpërndarjen e tyre në kohë dhe/ose qartësi ligjore.

■ Institucionet janë përgjegjëse për të siguruar përkthimin gjatë komunikimit me palët dhe komunikimit të brendshëm, nëse ka nevojë.

■ Institucionet janë përgjegjëse të sigurojnë qartësi ligjore në të gjitha versionet gjuhësore të dokumenteve administrative të shkruara në gjuhët zyrtare.

3.1. VENDOSJA DHE VENDIMET GJYQËSORE NË PROCEDURËN KONTESTIMORE

Vendosja është një operacion mendor dhe logjik me të cilin gjendja faktike e konstatuar gjatë procedurës vihet në një normë të caktuar. Vendimin e formulon dhe e shqipton gjyqtari individual apo kryetari i trupit gjykues, në emër të trupit gjykues.

Vendimet gjyqësore klasifikohen duke përdorur kritere të ndryshme. Duke marrë parasysh përmbajtjen e mbrojtjes juridike që jepet me to, vendimet mund të jenë:

- **detyruese,**
- **dënuese,**
- **ndëshkuese,**
- **konstitutive apo deklarative.**

I natyrës ndëshkuese është p. sh., vendimi me të cilin pranohet a refuzohet kërkesa për pagimin e një shume të hollash. Duke marrë parasysh faktin nëse jepet vendimi në bazë të normës materiale *substanciale* apo të asaj procedurale, vendimet mund të ndahen në ato të natyrës **materiale-juridike** dhe në vendime të natyrës **procedurale-juridike**.

Mandej, varësisht nga fakti nëse jepet vendimi në procesin e iniciuar me padi apo me ankesë, vendimi mund të jetë **i shkallës së parë** ose **i shkallës së dytë**. Duke marrë parasysh formën në të cilën jepen ato, vendimet ndahen në:

- **aktgjykime dhe**
- **aktvendime**

Me **aktgjykim** gjykata gjithmonë vendos për **kërkesë-padinë,** domethënë për objektin e kontestit, kurse me **aktvendim** gjykata vendos për **çështje të tjera.** Gjykata vetëm përjashtimisht vendos për kërkesë-padinë me aktvendim dhe në procedurë sipas padisë për shkak të pengim-posedimit dhe në procedurën mandatore, në të cilën kërkesë-padia pranohet me anë të urdhërpagesës, e cila konsiderohet si një lloj i aktvendimit.

Dhënia e vendimeve: Trupi gjykues vendos me anë të votimit, që bëhet pas këshillimit të kryer lidhur me çështjen për të cilën duhet vendosur. Mirëpo, nëse anëtarët e trupit gjykues, që nga fillimi i këshillimit, janë dakord lidhur me përmbajtjen e vendimit që duhet dhënë, atëherë këshillimi përfundon me anë të deklarimit të pajtimit me propozimin e parashtruar së pari.

Të votosh në procedurën kontestimore domethënë të vendosësh për një çështje me anë të deklarimit për ose kundër propozim-vendimit. Kur duhet vendosur për

çështjet më pak të rëndësishme dhe jo të komplikuara, trupi gjykues mund të japë vendim në lokalin në të cilin është duke u zhvilluar gjykimi, në praninë e palëve dhe të personave të tjerë.

Në rastet e tjera vendimi jepet në seancën e posaçme për këshillim dhe votim. Për dhënien e çdo vendimi nevojitet shumica absolute e votave të anëtarëve të trupit gjykues. Që nga momenti në të cilin kryetari i trupit gjykues deklaron se ka përfunduar votimi, moralisht çdo anëtar i tij është i lidhur për votën e dhënë.

Kjo vlen edhe për vendimin e dhënë, por vetëm deri në momentin e shpalljes së tij, e nëse nuk është bërë shpallja, atëherë deri në momentin e dërgimit të tij me shkrim palëve. Pas këtij momenti gjykata nuk mund ta ndryshojë më vendimin e saj. Mirëpo, duhet theksuar se ky rregull nuk vlen për aktvendimet me të cilat gjykata e drejton procesin e as me vendimet përfundimtare.

Veprimet drejtuese të gjykatës: Gjatë procesit kontestimor gjykata kryen një varg veprimesh, të cilat i shërbejnë drejtimit të procedurës. Veprimet drejtuese në të shumtën e rasteve kanë formën e aktvendimeve. Herë-herë ato kryhen edhe në forma të tjera, si p. sh., në formë pyetjesh, udhëzimesh, vërejtjesh etj. Procesin kontestimor e drejton gjykata. Veprimtarinë drejtuese e përbëjnë veprimet procedurale, me të cilat përgatitet zgjidhja përfundimtare e kontestit, duke u grumbulluar, formuar dhe verifikuar materiali, në bazë të të cilit jepet vendimi final (përfundimtar). Të gjitha veprimet në fjalë kryhen *ex officio.* Gjykata ato mund t'i ndryshojë dhe t'i revokojë në çdo kohë. Edhe zbatimi i tyre bëhet *ex officio.* Aktvendimet drejtuese mund të kundërshtohen vetëm me ankesën që paraqitet kundër vendimit me të cilin përfundon procedura.

Procesverbalet: Procesverbali gjyqësor është dokument publik, të cilin e përpilon gjykata për veprimet procedurale të kryera gojarisht, në seancë a jashtë seancës, nga palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë.

Nga procesverbali, në të cilin janë protokolluar veprimet procedurale, shihet se cilat veprime janë kryer dhe si janë kryer ato. Procesverbali ka përmbajtjen e tij në kuptimin formal dhe në kuptimin material. Përmbajtjen e procesverbalit, në kuptimin formal e përbëjnë *pjesët përbërëse*:

- **pjesa hyrëse;**
- **përshkrimi i veprimeve të kryera dhe**
- **nënshkrimi.**

Në pjesën hyrëse duhet të tregohet se në cilën çështje juridike mbahet ai, mandej se në cilën gjykatë është zhvilluar aktiviteti lidhur me të cilin përpilohet ai, cilët persona dhe me cilën cilësi kanë marrë pjesë në aktivitetin e zhvilluar dhe, së fundi, në këtë pjesë të procesverbalit duhet të tregohet kur është kryer aktiviteti i caktuar dhe në cilin vend.

Në pjesën ku përshkruhen veprimet e kryera tregohet si është zhvilluar dhe cili është rezultati i aktivitetit që shënohet në procesverbal.

Në fund të procesverbalit nënshkruhet gjykatësi që e ka përpiluar, procesmbajtësi që e ka shkruar atë, palët e pranishme dhe personat e tjerë të pranishëm që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprimeve procedurale.

Përmbajtjen e procesverbalit, në kuptimin material, e përbën përshkrimi i

veprimeve procedurale të kryera në seanca gjyqësore dhe e tërë ajo që ka ndodhur me atë rast. Në këtë aspekt dallojmë:

- **procesverbalin e shqyrtimit të çështjes;**
- **procesverbalin e marrjes së provës jashtë shqyrtimit kryesor;**
- **procesverbalin me të cilin zëvendësohet parashtresa e palës dhe**
- **procesverbalin e këshillimit dhe votimit.**

Komunikimi, dërgimi i shkresave: Parimi i kontradiktoritetit mund të realizohet në tërësi vetëm nëse palëve u jepet mundësia, që të njihen me përmbajtjen e veprimeve procedurale të shkruara, me kohën dhe vendin e caktuar për kryerjen e veprimeve procedurale. Realizimit të kësaj detyre i shërben Instituti i Komunikimit. Veprimet shkresore të palës kundërshtare, vendimet gjyqësore, urdhëresat, kumtesat dhe thirrjet në formë shkresore barten dhe i dorëzohen personit të cilit i janë dedikuar ato – adresatit *(marrësit).* **Ky veprim i gjykatës quhet komunikim**.

Komunikimi i kryer protokollohet me një lloj të posaçëm procesverbali, të cilin e quajmë ***dëftesë komunikimi***. Dërgimin e shkresave e bën gjykata sipas detyrës zyrtare, nëpërmjet postës, me anë të nëpunësit gjyqësor, apo nëpërmjet organit shtetëror të komunës.

Në disa raste ***adresati*** dhe ***marrësi i shkresës*** nuk është i njëjti person. Kur pala vepron në procedurë nëpërmjet përfaqësuesit, shkresat nuk i dorëzohen palës, edhe pse ajo është adresat, por përfaqësuesit të saj ligjor apo me prokurë. Vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj, komunikimi i bëhet drejtpërdrejt palës e jo përfaqësuesit të saj.

Kur përfaqësuesi i palës është avokat, komunikimi quhet i rregullt si atëherë kur shkresa i dorëzohet atij personalisht, ashtu edhe kur i dorëzohet nëpunësit në zyrën e tij. Kur pala është person juridik, shkresa i dorëzohet punonjësit të autorizuar për pranimin e postës apo punonjësit që gjendet në lokalin e punës së adresatit. Kur shkresa duhet t'i dorëzohet avokatit publik apo prokurorit publik, dorëzimi i saj bëhet në zyrën/arkivin e tij. Ushtarakëve dhe punonjësve të policisë komunikimi i letërthirrjeve u bëhet nëpërmjet komandës së tyre ose eprorit të drejtpërdrejtë.

Institucioneve dhe personave fizikë jashtë shtetit komunikimi u bëhet në rrugë diplomatike. Palën që ndodhet jashtë shtetit e që nuk ka përfaqësues në shtetin tonë, gjykata mund ta thërrasë që ta caktojë atë me qëllim që t'i dorëzohen shkresat. Nëse pala nuk e bën një gjë të tillë, atëherë gjykata ia cakton atë. Me ligj është përcaktuar që shkresa, për të cilën nuk është parashikuar dorëzimi personalisht adresatit, mund t'i dorëzohet një personi tjetër apo të lihet në vendin e caktuar me efekt sikur ajo t'i ishte dorëzuar vetë adresatit. Kur adresati nuk gjendet në banesën e tij, me ligj është përcaktuar që shkresa mund t'i dorëzohet çdo anëtari të familjes së tij që është i moshës madhore. Nëse në banesën e adresatit nuk ndodhet asnjë person i tillë, shkresa mund t'i dorëzohet fqinjit apo administratorit të ndërtesës, por vetëm nëse pajtohen me një gjë të tillë.

Vendi dhe koha e komunikimit: Komunikimi bëhet në ditë pune dhe gjatë ditës. Komunikimi me anë të postës bëhet edhe në ditë feste. Si vend komunikimi ligji e përmend banesën e adresatit, lokalin e punës ose lokalin gjyqësor, në rast se ai ndodhet

në të.

Dëftesa e komunikimit është dokument publik, që shërben si provë për komunikimin e kryer. Ajo përpilohet si atëherë kur komunikimi është kryer, ashtu edhe kur nuk ka mundur të kryhet me sukses. Në të shënohen:

- shkresa që është dorëzuar,
- adresati,
- raporti midis adresatit
- marrësit si dhe data e komunikimit *me numra dhe shkronja* dhe, në fund,
- nënshkrimi i marrësit dhe komunikuesit.

Në qoftë se refuzohet pranimi i shkresës, në dëftesën e komunikimit, komunikuesi duhet të shënojë shkakun e refuzimit dhe të tregojë se ç'ka ndodhur me shkresën.

Dhënia e ndihmës juridike: Në procedurën kontestimore dhënia e ndihmës juridike përbëhet nga kryerja e veprimeve procedurale nga një gjykatë në procesin që është në zhvillim e sipër në gjykatën tjetër, të cilën e quajmë gjykatë e çështjes. Në të shumtën e rasteve, objekt i ndihmës juridike është marrja e provave, p. sh., këqyrja direkte e provës së paluajtshme, marrja në pyetje e dëshmitarit etj. Dhënia e ndihmës në fjalë bëhet vetëm sipas lutjes apo porosisë së gjykatës së çështjes. Kompetente në pikëpamje funksionale për dhënien e ndihmës juridike është gjykata, kurse në pikëpamje territoriale, gjykata, në territorin e së cilës duhet marrë prova. Gjykata kompetente është e detyruar që ta kryejë veprimin e kërkuar dhe procesverbalin e përpiluar t'ia dërgojë gjykatës së çështjes. Nëse konstaton se nuk është kompetente, gjykata e porositur ia dërgon lutjen asaj gjykate për të cilën mendon se është kompetente dhe për këtë e njofton gjykatën e çështjes.

Ndihma juridike ndërkombëtare: Gjykatat tona janë të detyruara që t'u japin ndihmë juridike edhe gjykatave të huaja, në rast se një gjë e tillë është parashikuar me kontratë ndërkombëtare, si dhe kur ekziston reciprociteti në këtë aspekt. Objekt i dhënies së ndihmës juridike mund të jetë, përveç marrjes së provës, komunikimi i shkresës. Lutja dërgohet në rrugë diplomatike. Ajo duhet të përpilohet në gjuhën zyrtare të gjykatës e cila duhet të kryejë veprimin ose origjinalit i bashkëngjitet përkthimi në atë gjuhë. Nëse gjykata jonë i jep ndihmë juridike gjykatës së huaj, ajo jepet në mënyrën e parashikuar me ligjin tonë sipas parimit *locus regit actum, lex fori*.

Kompetente për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare është gjykata themelore.

Në vijim po japim disa nga formularët e sipërshënuar, si: padia, ankesa, aktvendimi dhe propozimi.

1. <u>Padia për kompensimin e dëmit (dëmshpërblim)</u>	**1.Тужба за надоместок на штета (обесштетување)**
L._____ nr._____viti_____	Од._____бр. _____ _____год.

GJYKATËS THEMELORE_____	ОСНОВЕН СУД_____
Paditësi: _____ nga _____, rruga _____, nr._____.	Тужител:_____од _____, Улица_____, бр.____.
I padituri: Shoqëria e sigurimit _____ në_____, rruga_____, nr._____	Тужениот: осигурително друштво _____ во _____, Улица _____,бр. _____.
P A D I	**Т У Ж Б А**
Objekt kontesti: Dëmshpërblimi Vlera e kontestit _____den	Предмет на спор: Обесштетување, вредноста на спорот _____мкд
Më _____, paditësi ka pësuar lëndim trupor të rëndë, ngaqë është goditur në këmbën e majtë me veturën tip _____ , me targa_____ , pronësi e_____nga _____, i cili e ngiste automjetin në momentin e aksidentit. Pronari i automjetit është shpallur fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni_____, par._____ në lidhje me nen. _____, par.___dhe___ të Kodit Penal dhe është dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore_____, P. nr._____	На _____, тужителот претрпел тешка физичка повреда, при што е погоден во левата нога од кола на типот _____, со регистарски ознаки _____, сопственост на _____ од _____, кој го возеше возилото во моментот на несреќата. Сопственикот на автомобилот е прогласен за виновен за кривичното дело предвидено он член_____, став____согласно член ._____, став____ и ___ на Кривичниот Законик и е осуден со пресуда на Основниот Суд _____, П. Бр._____,
Prova: Dosja e lëndës e Gjykatës Themelore_____, P. nr._____/19.	**Доказ:** Досието на предметот на Основниот Суд_____, П. бр. _____/19 година.
Automjeti me të cilin është lënduar paditësi ka qenë i siguruar në momentin e aksidentit tek e paditura shoqëria e sigurimeve _____. Prova: Polica e sigurimit nr._____	Автомобилот со кој е повреден тужителот во моментот на несреќата бил осигуруван од туженото осигурително

	друштво_____. Доказ: Осигурителната полиса бр. _____.
Për lëndimin e pësuar, paditësi është mjekuar në Klinikën e Kirurgjisë në_____ nga data _____ e deri më _____ të vitit_____. Edhe pas qëndrimit në spital, paditësi është mjekuar në shtëpinë e tij edhe për një muaj . Prova: Certifikata e Klinikës Kirurgjike në_____ , nr._____. Të datës _____. Si pasojë e aksidentit në fjalë, paditësi ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë të një intensiteti të fortë, zvogëlim të aktivitetit jetësor për 25%, kurse këmba e lënduar i është shkurtuar për 3 cm. Prova: ekspertiza mjekoligjore. Paditësi propozon që kjo Gjykatë ta caktojë shqyrtimin kryesor të çështjes, t'i shfrytëzojë informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe pastaj të japë këtë:	За претрпената повреда, тужителот се лекувал во Клиниката за Хирургија во _____ од _____ до _____ год. И по престојот во болница, тужителот е лекуван во неговиот дом и за месец дена. Доказ: извештај од Клиниката за хирургија во _____, бр. _____. На датум _____. Како последица од предметната несреќа, тужителот претрпел телесна болест и страв на силен интензитет, намалување на животните активности за 25% додека ногата му е повредена и му е скратена за 3 см. Доказ: експертиза од судската медицина. Тужителот предлага овој Суд да го одреди главното разгледување на предметот, да ги употреби потребните информации од доказните средства предложени и потоа да издаде :
A K T GJ Y K I M	**П Р Е С У Д А**
Detyrohet shoqëria e sigurimit_____ në_____, si palë e paditur, që paditësit _____ nga _____ t'ia kompensojë dëmin, të cilin e ka pësuar si pasojë e lëndimit të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor më _____ duke i paguar: 1) shumën prej_____den , për shkak të dhembjeve fizike, 2) shumën prej _____ , për shkak të frikës, 3) shumën prej _____ , për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor,	Се обврзува Осигурителното друштво _____ во _____, како тужена странка, на тужителот _____ од _____ да му ја надомести штетата, која ја претрпел како последица од сообраќајната несреќа на _____ плаќајќи му : 1) износ од _____ мкд, поради телесни болки, 2) износ од _____, поради стравот,

4) shumën prej_____ , për shkak të deformimit fizik - të gjitha këto shuma me kamatë 1,5% të llogaritur që nga dita e ngritjes së padisë e deri në ditën e pagimit të tyre, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita në të cilën i dorëzohet aktgjykimi, me kërcënim të ekzekutimit me forcë.	3) износ од _____, поради намалување на општите животни активности, 4) износ од_____ , физичка деформација –сите овие износи со 1,5% каматна стапка пресметани од денот на поднесувањето на тужбата и до денот на нивната исплата ,како и трошоците од спорната постапка, во рок од 15 дена од денот на кој е доставена пресудата, со закана од присилно извршување.
Në _____ Paditësi _____ më_____	Во _____ Тужителот _____ на _____

2. Ankesa kundër aktgjykimit	**2.Жалба против пресудата**
Lënda. nr. _____viti_____	Предмет бр. _____ _____ година.
GJYKATËS SË _____	Судот на _____
Paditësi: _____ nga_____, rruga_____ nr._____	Тужителот:_____ од _____, улица_____ бр. _____.
I padituri:_____, nga _____, rruga _____ nr.____, për shpërblimin e dëmit në vlerë prej _____den.	Туженият: _____, од_____, улица_____ бр. _____, за надомест на штетата во износ _____ мкд.
ANKESA E TË PADITURIT	**ЖАЛБА НА ТУЖЕНИОТ**
Kundër aktgjykimit të Gjykatës _____, K. nr._____ të dhënë më _____	Против пресудата на Судот _____, К. Бр. _____ доставен од _____
Me aktgjykimin e Gjykatës _____, K.	Со пресудата од Судот _____, К бр.

nr._____ të dhënë më _____, jam detyruar që paditësit t'i paguajë shumën prej _____den., si shpërblimit të dëmit, dhe shumën prej _____den. për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore. Kërkesa e paditësit në shumën mbi _____den, është refuzuar. Aktgjykimin e ankimoj në pjesën me të cilën jam detyruar që ta paguaj shumën e të hollave prej _____ për shkak të:	_____ доставен од _____, сум должен на тужителот да му наплатам износ од _____мкд, во врска со надоместокот на штетата, и износ од _____ мкд. во врска со судските трошоци. Барањето на тужителот во износ над _____ мкд, е одбиено. Пресудата ја обжалувам во делот со кој сум должен да го плаќам износот од _____ поради:
1) shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore,	1) суштинско кршење на одредбите на оспорената постапка,
2) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe	2) погрешно и нецелосно утврдување на фактичката состојба, и
3) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.	3) неправилна примена на материјалното право.
Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore përbëhet nga fakti se gjyqtari i cili ka marrë pjesë në procedimin e çështjes juridike, është në ~~gjini~~ lidhje gjaku me palën paditëse në vijë horizontale të gradës së tretë, gjë që përbën shkak për përjashtimin *ex lege* të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes. Konstatimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike qëndron në rrethanën se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes juridike nuk i ka konstatuar fare faktet e rëndësishme për zgjidhjen e kontestit.	Суштинското кршење на одредбите на оспорената постапка се состои од фактот дека во постапувањето на правното прашање учествувал судија, кој е роднина на тужителот, што е причина за исклучувањето ex lege на судијата од пресудата на случајот. Погрешното и нецелосното утврдување на фактичката состојба лежи во околноста дека судот за време на разгледувањето на правниот случај ги нема утврдено фактите кои се релевантни за решавање на спорот.
Një nga faktet e tilla është ai se të paditurve ua kam paguar _____ den., të borxhit, ndërsa gjykata këtë fakt fare nuk e ka përmendur në aktgjykim. Zbatimi i gabuar i së drejtës materiale qëndron në..... (tregohet gabimi i bërë).	Еден од таквите факти е дека на тужителите им исплатив _____ мкд., од долгот, а судот воопшто не го спомна овој факт во пресудата. Погрешната примена на материјалното право е ..... (се посочува направената грешка).

Në bazë të gjithë asaj që u tha më lart në ankesë, propozoj që gjykata e shkallës së dytë ta anulojë aktgjykimin e goditur dhe ta kthejë çështjen për procedim të ri ose ta ndryshojë atë dhe ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit. Kërkoj që paditësi të m'i rimbursojë shpenzimet procedurale lidhur me ankesën.	Врз основа на горенаведеното во жалбата, предлагам судот од втор степен да ја укине жалбената пресуда и да го врати случајот за нова постапка или да ја измени и да го одбие барањето за тужба на тужителот. Барам тужителот да ми ги надомести процедуралните трошоци поврзани со жалбата.
Në _____ I padituri më_____ A. A._____	Во _____ тужителот на _____ А.А._____

3. <u>Aktvendimi për pezullimin e procedurës</u>	**3. <u>Пресуда за одлагање на постапката</u>**
K. nr._____	К. Бр. _____
Gjykata _____, sipas gjyqtarit _____, në çështjen juridike kontestimore të paditësit _____ nga _____, kundër të padituri _____ nga _____, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi me prokurë, _____ nga _____, rruga _____, nr. ____, për dëmshpërblim, më _____, në bazë të nen.___ dhe nenit___ të Ligjit të Procedurës Kontestimore dha këtë:	Судот _____, според судијата_____, во спорниот правен случај на тужителот _____ од _____, го претставува овластениот претставник _____ од _____, улица _____, бр. ____, за надоместок на _____, врз основа на член _____ и член _____ од Законот за оспорена постапка предвидува:
V E N D I M	**О Д Л У К А**
Konstatohet se në këtë çështje juridike **PEZULLOHET** procedura më _____. Gjatë kohës së qëndrimit pezull të procedurës, afatet e caktuara me ligj nuk ndalen së ecuri. Vazhdimin	Констатирано е дека во овој правен случај постапката се ОДЛАГА на _____. За време на постапката во тек, роковите пропишани со закон

e procedurës së pezulluar palët mund ta kërkojnë pas kalimit të 3 *(tre)* muajve, nga dita në të cilën është shkaktuar pezullimi. Po qe se asnjëra nga palët, brenda afatit gjashtëmujor, nga dita kur është shkaktuar pezullimi, nuk bën propozim për vazhdimin e procedurës, do të konsiderohet se padia është tërhequr.	не престануваат. Странките можат да побараат продолжување на одложената постапка по истекот на три месеци од датумот на кој е одложена постапката. Ако ниту една од странките, во рок од шест месеци од датумот за кој е определено одлагањето, не предлага да продолжи постапката, ќе се смета дека тужбата е повлечена.
Gjykata _____ më _____	Судот _____ на _____
Gjyqtari _____	Судијата _____
Udhëzimi lidhur me ankimin: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi në Gjykatën e _____, brenda afatit 15-ditor, nga dita e dorëzimit të tij. Ankesa i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.	**Упатство поврзано со жалба: Против оваа пресуда, е дозволено жалба до _____ Суд во рок од 15 дена од денот на доставувањето. Жалбата се поднесува до овој Основен суд.**

4. Propozimi për heqjen e së drejtës prindërore	**Предлог за отстранување на родителското право**
L_____Nr._____viti_____	Л. _____ бр. _____ _____ година
GJYKATËS _____	СУДИЈА _____
Propozuesi: _____ nga _____, rruga_____ nr._____.	Предлагач: _____ од _____, улица_____ бр. ____.
Vendi _____	Место _____
P R O P O Z I M	**П Р Е Д Л О Г**
për heqjen e së drejtës prindërore ndaj _____	**за одземање на родителското право на _____**

Me _____ jam në martesë që nga viti _____ dhe gjatë kësaj kohe, më _____, na ka lindur vajza e quajtur _____.	Со _____ сум во брак од _____ година и за ова време, на _____, ни се роди ќерката која се вика _____.
P r o v a: Certifikata e lindjes nga libri i të lindurve të komunës së _____	Доказ: Извод од матичната книга на родените на општина _____
_____ para dy vjetësh më ka lënë mua dhe vajzën e mitur, _____, dhe ka shkuar në _____qytet, ku jeton me një burrë tjetër. Që nga atëherë nuk lajmërohet fare, nuk kujdeset për vajzën e mitur dhe nuk kontribuon për ruajtjen, edukimin dhe ushqimin e saj.	_____ пред две години нѐ остави мене и мојата малолетна ќерка, _____ и отиде во градот _____, каде живее со друг маж. Оттогаш воопшто не се јавува, не се грижи за малолетничката девојка и не придонесува за нејзино чување, едукација и хранење.
Prova: dëshmitari _____ nga _____, rruga _____ nr ____.	**Доказ**: сведокот _____ од _____, улица _____бр. _____.
Meqenëse _____ qe disa vjet është duke lënë pas dore detyrën e prindit ndaj vajzës së vet, _____-, janë plotësuar të gjitha kushtet që të privohet nga të drejtat prindërore, andaj propozoj që gjykata, pas shqyrtimit të çështjes, të japë këtë:	Бидејќи _____ веќе неколку години ја запоставува должноста на родителот кон нејзината ќерка, _____, сите услови се исполнети за да ѝ се одземе родителското право, затоа предлагам судот, по разгледувањето на случајот, да:

Република Северна Македонија

ДРЖАВЕН ИНСПЕКТОРАТ

ЗА ШУМАРСТВО И ЛОВСТВО

Бр. 04-04/30

15.11.2019 година

Скопје

Republika e Maqedonisë së Veriut

INSPEKTORATI SHTETËROR I

PYLLTARISË DHE I GJUETISË

Nr. 04-04/30

15.11.2019

Shkup

Врз основа на член 49 став 2, член 55 став 2 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на РСМ„ бр. 58/00 , 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11), член 52 став 6, а во врска со членовите 22, 25, 27, член 30 став 1 алинеа 2 и член 85 став 1, член 86 став 1 алинеа 1 и член 87 од Законот за административни службеници („Службен весник на РСМ„ бр. 27/14, 199/14, 48/15 , 154/15,05/16, 142/16 и 11/18), член 14 став 1 од Законот за вработените од јавниот сектор („Службен весник на РСМ„ бр.27/14, 199/14, 27/16, 35/18) а во согласност со одлуката бр.04-47/27 од 07.06.2019 г. Правилникот за систематизација на работните места во Државниот инспекторат за шумарство и ловство бр. 01-223/12 од 24.07.2018 година, Директорот на Државниот инспекторат за шумарство и ловство го донесе следното:	Në bazë të nenit 49 paragrafi (2), neni 55 paragrafi (2) të Ligjit të Organizimit dhe Punës së Organeve të Administratës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), nenit 52 paragrafi (6), dhe në lidhje me nenet 22, 25, 27, nenin 30 paragrafi (1) pika 2 dhe neni 85 paragrafi (1), neni 86 paragrafi (1) pika 1 dhe neni 87 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 05/16, 142/16 dhe 11/18), nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit të të Punësuarve në Sektorin Publik ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18), ndërsa në përputhje me Vendimin nr. 04-47/27 datë 7.6.2019, Rregulloren për Sistematizim e Vendeve të Punës në Inspektoratin Shtetëror të Pylltarisë dhe Gjuetisë nr. 01-223/12 të datës 24.7.2018, Drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Pylltarisë dhe Gjuetisë mori:
Р Е Ш Е Н И Е	**AKTVENDIM**
за унапредување, распоредување и определување на плата на административен службеник	***për avancimin, klasifikimin dhe përcaktimin e pagës së nëpunësit administrativ***
1. Административниот службеник **XXXX XXXX** се унапредува и се распоредува на работно место ***Виш соработник за административна подршка - Одделение за правни и административни работи -Сектор за правни и административни работи и управување со човечки ресурси***, со звање **Виш соработник**, на ниво **B2,** сметано од	**1.** Nëpunësi administrativ **XXXX XXXX** avancohet dhe klasifikohet në vendin e punës ***Bashkëpunëtor i Lartë për Mbështetje Administrative – Seksioni për Punë Juridike dhe Administrative – Sektori për Punë Juridike dhe Administrative si dhe Udhëheqje me Burime Njerëzore,*** me titull **Bashkëpunëtor i Lartë,** në nivelin **B2,** e llogaritur nga data

15.11.2019 година.	**15.11.2019.**
2. За работното место на кое се распоредува, на административниот службеник му се утврдува плата и тоа:	**2.** Për vendin e punës në të cilin klasifikohet, nëpunësit administrativ i përcaktohet paga si më poshtë:
Основна компонента на плата:	Komponenti bazë i pagës:
-Дел на плата за степен на образование 200 бодови	***- Pjesë nga paga për shkallën e arsimit 200 pikë***
-Дел на плата за ниво 246 бодови	***- Pjesë nga paga për nivelin 246 pikë***
Вкупно 446 бодови	***- Gjithsej 446 pikë***
- Дел на плата за работен стаж во износ од 0,5% од деловите на платата за степен на образование и за ниво, за секоја навршена година работен стаж, а најмногу до 20%.	- Pjesë nga paga për stazhin e punës në shumën prej 0.5% nga pjesa e pagës për shkallën e arsimit dhe për nivelin, për secilin vit të mbaruar të stazhit të punës, ndërsa më së shumti deri më 20%.
3. Ова Решение влегува во сила со денот на донесувањето.	3. Ky Aktvendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.
О б р а з л о ж е н и е	***Arsyetim***
Согласно објавениот Интерен оглас бр. 02/2019 на веб страната на Министерството за земјоделство, шумарство и водостопанство и на веб страната на Агенцијата за администрација, Комисијата за унапредување на административен службеник ја спроведе постапката за унапредување на извршител за работното место ***Виш соработник за административна подршка - Одделение за правни и административни работи -Сектор за правни и административни работи и управување со човечки ресурси***,со звање **Виш соработник**, на ниво **В2**	Në përputhje me shpalljen e brendshme nr. 02/2019 në ueb faqen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe në ueb faqen e Agjencisë së Administratës, Komisioni për Avancimin e Nëpunësit Administrativ, realizoi procedurën për avancimin e realizuesit për vendin e punës ***Bashkëpunëtor i Lartë për Mbështetje Administrative – Seksioni për Punë Juridike dhe Administrative – Sektori për Punë Juridike dhe Administrative si dhe Udhëheqje të Burimeve Njerëzore,*** me titull **Bashkëpunëtor i Lartë,** në nivelin **B2**
Врз основа на предложената Финална ранг листа Директорот на Државниот инспекторат за шумарство и ловство донесе Одлука бр.04-294/11 од 14.11.2019 година, за избор на **XXXX XXXX** за извршител на работното место од точка 1 од ова решение.	Në bazë të listës përfundimtare të rangimit të propozuar, drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Pylltarisë dhe Gjuetisë, solli vendimin nr. 04-294/11 të datës 14.11.2019, për përzgjedhjen e **XXXX XXXX** për realizues në vendin e punës nga pika 1 të këtij Aktvendimi.

Имајќи предвид дека Одлуката за избор на кандидат по пат на Интерен оглас бр. 02-2019 за пополнување на работно место со унапредување бр.04-294/11 од 14.11.2019 г. е конечна, а административниот службеник ги исполнува општите и посебните услови утврдени во Законот за административни службеници и Правилникот за за систематизација на работните места во Државниот инспекторат за шумарство и ловство истиот се распоредува на работното место од точка еден од ова Решение.	Duke marrë parasysh se vendimi për përzgjedhjen e kandidatit sipas shpalljes së brendshme nr. 02-2019 për plotësimin e vendit të punës me avancim nr. 04-294/11 të datës 14.11.2019 është përfundimtar, ndërsa nëpunësi shtetëror i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta në Ligjin e Nëpunësve Administrativë dhe Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin Shtetëror të Pylltarisë dhe Gjuetisë, i njëjti klasifikohet në vendin e punës nga pika 1 e këtij Aktvendimi.
Врз основа на Законот за администативни службеници, за пресметување на месечен износ на плата, на работно место на кое се распоредува, на именованиот се утврдуваат вкупно **446 бодови**, зголемени за делот на плата за работен стаж во износ во износ од 0,5% од деловите на платата за степен на образование и за ниво, за секоја навршена година работен стаж, а најмногу до 20%.	Në bazë të Ligjit të Nëpunësve Administrativë, për llogaritje të shumës mujore të pagës, për vendin e punës që klasifikohet, të emëruarit i përcaktohen gjithsej **446 pikë**, të rritura në pjesën e pagës për stazh pune në shumë prej 0,5 % nga pjesa e pagës për shkallën e arsimit dhe për nivelin, për secilin vit të mbaruar të stazhit të punës, ndërsa më së shumti deri më 20%.
Поради напред изнесеното се одлучи како во диспозитивот на ова решение.	Për shkak të asaj që u theksua, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.
ПРАВНА ПОУКА: Против ова решение може да се поднесе жалба преку Државниот инспекторат за шумарство и ловство до Агенцијата за администрација – Комисија за одлучување по жалби и приговори на административни службеници во втор степен, во рок од 15 дена сметано од денот на приемот на решението.	**KËSHILLË JURIDIKE**: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë përmes Inspektoratit Shtetëror të Pylltarisë dhe Gjuetisë te Agjencia e Administratës – Komisioni për Vendimmarrje të Ankesave dhe Prapësimeve të Nëpunësve Administrativë në shkallë të dytë, në afat prej 15 ditësh, duke llogaritur ditën e pranimit të aktvendimit.

ДОСТАВЕНО ДО: / DORËZUAR:
- Именуваниот/ I emëruari
- Архива / Arkivi

ДИРЕКТОР/ DREJTORI
Qenan Mislimi

4. DREJTIMI DHE MENAXHIMI

Menaxhimi i diversitetit në vendin e punës përfshin inkurajimin, nxitjen dhe trajtimin e diversitetit si një avantazh konkurrues. Diversiteti gjuhësor nuk është një përjashtim, por ashtu si llojet e tjera të diversitetit, menaxhimi i çështjeve që ndërlidhen me gjuhën në vendin e punës, mund të jetë i komplikuar dhe kërkon nga drejtuesit dhe menaxherët të jenë të vetëdijshëm për detyrimet ligjore dhe të jenë këmbëngulës në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Sa i përket drejtimit dhe menaxhimit të organizatës, është me rëndësi të veçantë që informacioni t'u komunikohet të gjithë të punësuarve në të gjitha rastet, në gjuhët zyrtare.

Përgjegjësitë për temat/fushat specifike

■ Drejtuesi ose menaxheri është përgjegjës për të komunikuar informacionin (qoftë me shkrim ose me gojë), në gjuhët zyrtare, sipas nevojës.

■ Drejtuesi duhet të jetë i hapur dhe të respektojë diversitetin në vendin e punës. Respekti për diversitetin nuk nënkupton vetëm përfshirjen e grupeve të ndryshme etnike në ekip/vend të punës, por shkon përtej, duke u dhënë atyre mundësinë për të kontribuar në të gjitha proceset brenda organizatës, duke siguruar se materialet e punës janë dorëzuar në gjuhët zyrtare, ashtu siç rregullohet me ligj.

■ Drejtuesit janë përgjegjës për të siguruar kushtet e nevojshme (siç është përkthimi simultan) në gjuhët zyrtare, në mënyrë që punonjësit të pranojnë dhe të jenë në gjendje të komunikojnë informacionin. Duke bërë kësisoj, drejtuesit jo vetëm që plotësojnë kërkesat ligjore që dalin nga ligji, por gjithashtu ata krijojnë një marrëdhënie konstruktive me të punësuarit dhe i përfshijnë ata në procesin e mësimit, menaxhimit dhe punës ekipore, e cila shpie në arritjen e qëllimeve institucionale, krijon besim në drejtuesin/institucionin dhe nxit një atmosferë të një bashkëpunimi të hapur.

Përgjegjësia institucionale

■ Institucionet janë përgjegjëse për të siguruar respektimin e barazisë gjuhësore.

■ Institucionet janë përgjegjëse për të ofruar informacionin në gjuhët zyrtare dhe për të shpërndarë informacionin në të njëjtën kohë.

■ Institucioni është përgjegjës për të siguruar që komunikimi ndërinstitucional të jetë në dispozicion në gjuhët zyrtare.

■ Institucioni është përgjegjës për përkthimin e të gjitha dokumenteve institucionale (d.m.th. raportet, formularët e vlerësimit, kërkesat dhe materialet e tjera të punës) në gjuhë zyrtare.

■ Institucioni është përgjegjës për të siguruar interpretimin simultan në gjuhët zyrtare.

■ Në vazhdën e përmbushjes së funksioneve të tyre të menaxhimit, Administratorët publikë duhet të sigurohen se gjatë punës së tyre të përditshme, respektohen dispozitat ligjore dhe politikat në lidhje me përdorimin e gjuhëve, duke përfshirë edhe faktin se asnjë nga punonjësit e institucioneve nuk diskriminohet në

baza gjuhësore.

- Në planifikimin dhe organizimin e punës dhe të aktiviteteve, stafi udhëheqës i institucioneve publike duhet të sigurohet që nëpunësit civilë nga të gjitha komunitetet gjuhësore përfshihen në të gjitha fazat e punës, që nga fazat e hershme e deri në fazën e fundit të aktiviteteve të ndryshme. Sipas nevojës duhet të ofrohen udhëzimet, materialet e shkruara, të gjitha koncept-versionet e dokumenteve, mundësitë për të marrë pjesë në diskutime, që lidhen me punën etj., në gjuhët zyrtare, që fliten në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për më tepër, shpërndarja e informatave dhe materialeve për mbledhjet zyrtare dhe të stafit, duhet të kryhet me kohë edhe në gjuhët zyrtare, duke siguruar përkthimin gjatë mbledhjeve/ngjarjeve, si dhe përkthimin dhe shpërndarjen e procesverbaleve të mbledhjeve në gjuhët zyrtare/gjuhët në përdorim zyrtar.

- Përveç kësaj, Administratorët publikë duhet të sigurojnë që vendimet e stafit drejtues, si dhe të gjitha dokumentet dhe raportet e tjera zyrtare, publike dhe të brendshme janë lëshuar në gjuhët zyrtare. Gjithashtu, shenjat në dyer, njoftimet në zyrë dhe në zonat e përdorimit të përbashkët duhet të shfaqen në gjuhët zyrtare.

- Menaxhmenti i institucioneve publike duhet, po ashtu, të sigurojë që konkurset e institucioneve përkatëse të publikohen në gjuhët zyrtare. Vlerësimi i performancës, me shkrim dhe verbal, i realizuesve civilë duhet të bëhet në gjuhët zyrtare, apo në gjuhët në përdorim zyrtar, sipas nevojës.

- Administratorët publikë në nivel menaxherial duhet të drejtojnë ekipet e tyre të shërbimit drejt zhvillimit të kulturës organizative, duke respektuar dhe përqafuar diversitetin, përfshirë shumëgjuhësinë. Administratorët publikë duhet të nxiten nga menaxhmenti i tyre që të mësojnë gjuhët e komuniteteve të tjera dhe shumëgjuhësia duhet të promovohet si një vlerë në shërbimin civil.

5. MENAXHIMI I ARKIVAVE PUBLIKE

Në pajtim me Ligjin për Arkivat Shtetërore, të gjitha institucionet publike të RMV-së në nivel qendror dhe lokal, kanë detyrim ligjor që të përdorin, krijojnë dhe mirëmbajnë arkivat. Të gjitha dokumentet, të dhënat dhe regjistrat ligjorë të krijuar gjatë punës së institucioneve publike, kontrollohen nga niveli qendror, përkatësisht nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të RMV-së. Ky institucion, gjithashtu është përgjegjës për pranimin, identifikimin, mirëmbajtjen, publikimin dhe arkivimin e materialit të të gjitha institucioneve publike, i cili nuk është më në përdorim dhe të cilit i kalon afati i ruajtjes së vetarkivimit në institucionin përkatës. Materiali arkivor pastaj ruhet dhe përdoret për arsim, kërkime shkencore dhe kulturore, si dhe për informata për përdorim profesional dhe civil. Hulumtimi dhe shfrytëzimi i materialit arkivor është një nga të drejtat themelore të të gjithë qytetarëve për qasje të lirë në informata dhe, duke qenë kështu, qasja në materialet arkivore duhet të jetë e garantuar për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve, pa diskriminim në asnjë bazë. Prandaj, është me rëndësi të madhe që institucionet publike, si dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e RMV-së, të sigurojë respektimin e barazisë gjuhësore të garantuar me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Përgjegjësitë ndaj temës/fushës specifike

- Materiali i cili vetarkivohet nga institucionet publike ose i cili ofrohet për Agjencinë Shtetërore të Arkivave të RMV-së për arkivim afatgjatë në regjistrin e arkivave publike, duhet të përshkruhet në gjuhët zyrtare, së bashku me dëshmitë e të dhënave dhe të gjithë informacionin korrespondues, për të siguruar kuptim të qartë të informacionit dhe përdorimit të tij efektiv nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve.
- Të gjitha ndryshimet në përshkrimin e të dhënave të arkivuara duhet të përditësohen me kohë në gjuhët zyrtare.
- Të gjitha materialet elektronike që i nënshtrohen aktualizimit të vazhdueshëm duhet të dorëzohen, ruhen, përshkruhen dhe të përditësohen në të gjitha versionet e gjuhëve zyrtare.
- Kushtet dhe procedurat për përdorimin, qasjen, kopjimin dhe riprodhimin e materialit të arkivuar, duhet të formulohen në gjuhët zyrtare, për të siguruar qasje të barabartë për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve.
- Sistemet e teknologjisë së informacionit, të cilat përdoren për të menaxhuar regjistrin e arkivave publike, duhet të jenë funksionale edhe në versionet e gjuhëve zyrtare.
- Ueb-faqja e Agjencisë së Arkivave Shtetërore të RMV-së duhet të jetë funksionale në versionet e gjuhëve zyrtare.
- Regjistri arkivor publik duhet të përditësohet në ueb-faqen e internetit në gjuhët zyrtare dhe pa komprometuar ngarkimin në kohë të ndonjërit prej versioneve të gjuhëve.
- Komunikimi ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Arkivave të RMV-së dhe institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal, duhet të mundësohet në gjuhët zyrtare.

Përgjegjësia institucionale

- Agjencia Shtetërore e Arkivave e RMV-së është përgjegjëse për të vepruar në përputhje me qëllimin për të siguruar qasje të barabartë në materialet arkivore për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve.
- Agjencia Shtetërore e Arkivave e RMV-së duhet të sigurojë respektimin e barazisë gjuhësore në regjistrimin, përshkrimin, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e materialit arkivor.
- Agjencia Shtetërore e Arkivave e RMV-së duhet të sigurojë respektimin e barazisë gjuhësore në komunikimin me institucionet publike, që dorëzojnë material për t'u arkivuar, si dhe me përdoruesit e arkivave.
- Agjencia Shtetërore e Arkivave e RMV-së duhet të sigurojë respektimin e barazisë gjuhësore gjatë organizimit dhe ofrimit të ligjëratave të trajnimit dhe kurseve profesionale për stafin arkivor në nivelin qendror dhe lokal në RMV.
- Agjencia Shtetërore e Arkivave e RMV-së duhet të sigurojë që Rrjeti Arkivor i RMV-së, i cili i ndërlidh të gjitha institucionet arkivore në RMV, është themeluar dhe funksionon duke respektuar barazinë gjuhësore.
- Agjencia Shtetërore e Arkivave e RMV-së duhet të sigurojë respektimin e barazisë gjuhësore në lëshimin e të gjitha dokumenteve në versionet e gjuhëve zyrtare.

6. FINANCAT PUBLIKE

Me qëllim të realizimit më të saktë, gjithëpërfshirës dhe transparent të proceseve që ndërlidhen me menaxhimin e financave publike, është me rëndësi të veçantë që të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të respektojnë dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Përgjegjësitë ndaj temës/fushës specifike

- Të gjitha dokumentet ligjore dhe politike, si dhe raportet e ndërlidhura me zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duhet të nxirren në gjuhët zyrtare të RMV-së në të gjitha fazat e hartimit, duke përfshirë publikimin e versioneve përfundimtare të miratuara.
- Të dhënat e korrespondencës mes institucioneve për çështjet e ndërlidhura me buxhetin dhe obligime duhet të ruhen në gjuhët zyrtare.
- Të gjitha konsultimet publike dhe dëgjesat publike lidhur me zhvillimin e buxhetit duhet të bëhen në gjuhët zyrtare, si dhe në gjuhët me status zyrtar në nivel komunal. Kjo përfshin kontaktimin e komunitetit në gjuhët zyrtare, zhvillimin e koncept-propozimeve buxhetore në gjuhët zyrtare si dhe zhvillimin e procesit të konsultimit në gjuhët zyrtare.

Përgjegjësia institucionale

- Në të gjitha aspektet e planifikimit dhe zhvillimit të buxhetit, institucionet duhet të punojnë në gjuhët zyrtare.
- Dokumentet dhe raportet përfundimtare të buxhetit duhet të publikohen në ueb-faqet zyrtare nga institucionet, në gjuhët zyrtare.

7. STEMAT DHE SHENJAT IDENTIFIKUESE (LOGOT)

Të gjitha institucionet janë të detyruara që në stemat dhe në shenjat e tyre identifikuese (logot) të respektojnë gjuhët zyrtare, bazuar në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

8. VULAT

Të gjitha institucionet janë të detyruara të respektojnë barazinë gjuhësore në vulat e tyre. Teksti i vulës së institucionit duhet të shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit, me madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të RMV-së.

9. TABELAT DHE MBISHKRIMET



Çdo institucion ose organ publik ka për detyrë që tabelat dhe mbishkrimet t'i shkruajë në gjuhët zyrtare, me kusht që madhësia e shkronjave, forma, fondi dhe ngjyra të jenë të njëjta.

Çdo institucion në nivel lokal dhe qendror është i detyruar që shenjat topografike të cilat shënojnë dhe përfshijnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve, rrugicave, si dhe vendeve të tjera të hapësirave publike, t'i vendosë në gjuhët zyrtare.

Te ne, në tabela dhe mbishkrime shpeshherë hetohen gabime të natyrave të ndryshme. Shpresojmë se në të ardhmen gabimet e tilla do të mënjanohen. P. sh. *Стопанска банка* propozojmë në versionin shqip me: *Banka Ekonomike*, *Комерцијална банка* në shqip të jetë: *Banka Tregtare.*

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

81'272:340.132(497.7)(035)
342.725(497.7)(035)
81'272:[005.57:35.075(497.7)(035)

DORACAK i nëpunësve administrativë lidhur me zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve / [autorë Xhevat Lloshi ... и др.]. - Shkup : Agjencia për zbatimin e gjuhës e RMV-së, 2020. - 88 стр. ; 30 см

Други автори: Ajten Hajdari-Qamili, Izer Maksuti, Asllan Hamiti, Bashkim Selmani, Jusuf Zejneli, Zeqirija Ibrahimi, Ismail Hamiti, Xhemi Hajredini

ISBN 978-608-66482-5-1

1. Lloshi, Xhevat [автор] 2. Hajrdari-Qamili, Ajten [автор] 3. Maksuti, Izer [автор] 4. Hamiti, Asllan [автор] 5. Selmani, Bashkim [автор] 6. Zejneli, Jusuf [автор] 7. Ibrahimi, Zeqirija [автор] 8. Hamiti, Ismail [автор] 9. Hajredini, Xhemi [автор]
а) Закон за употреба на јазиците - Употреба - Македонија - Прирачници б) Употреба на јазици - Административна комуникација - Македонија - Прирачници

COBISS.MK-ID 112440586

E drejta e autorit është e drejtë ekskluzive e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës

Adresa: Shëtitorja "Dimitar Vllahov" nr. 4, kati IV, 1000 Shkup

Tel: +389 2 312 1731

e-mail: info@apj.gov.mk

www.apj.gov.mk

www.azgj.gov.mk

ISBN 978-608-66482-5-1